

PAKETA E LIGJEVE FISKALE

- Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008
"Për procedurat tatimore" (i ndryshuar) faqe 2
- Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998
Për tatimin mbi të ardhurat (i ndryshuar) faqe 58
- Ligji Nr.7928, datë 27.04.1995
Për tatimin mbi vlerën e shtuar (i ndryshuar) faqe 83
- Ligji Nr.8976, datë 12.12.2002
Për akcizat" (i ndryshuar) faqe 106
- Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008
Për taksat kombëtare (i ndryshuar) faqe 136
- Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006
Për sistemin e taksave vendore (i ndryshuar) faqe 149

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.9920, datë 19.5.2008

**PËR PROCEDURAT TATIMORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Ky ligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha llojet e tatimeve dhe të detyrimeve tatimore, me përjashtim të rasteve kur me ligje të veçanta është parashikuar ndryshe.

Neni 2

Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për:

a) tatimpaguesit, administratën tatimore, agjentët tatimorë, agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjerë, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor;

b) personat e ngarkuar për të paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

c) personat që paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa u përket pagesës dhe mbledhjes së kontributeve;

ç) sistemin e tatimeve dhe të taksave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Neni 3

Legjislacioni tatimor

Legjislacioni tatimor përbëhet nga:

- a) marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi;
- b) ligjet tatimore;
- c) aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.

Neni 4

Llojet e tatimeve dhe të taksave

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.
2. Në tatimet dhe taksat kombëtare përfshihen:
 - a) tatimi mbi vlerën e shtuar;
 - b) tatimi mbi të ardhurat;
 - c) akciza;
 - ç) tatimi për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet;
 - d) taksat kombëtare;
 - dh) tatime të tjera, të cilat janë përcaktuar të tilla me ligj të veçantë.
3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.
4. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përcaktohen në ligjin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 5

Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Administratë tatimore” përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; **me përjashtim të akcizës. Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.**

b) “Agjent tatimor” është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat;

c) “Agjent i mbajtjes së tatimit në burim” është personi, të cilit, sipas legjislacionit tatimor, i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe t’i transferojë këto tatime në Buxhetin e Shtetit;

ç) “Kontribut” është detyrimi monetar i detyrueshëm për t’u paguar si shpërblim për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve;

d) “Libra dhe regjistrime” janë regjistrimet tregtare, dokumentacioni kontabël, llogaritë vjetore dhe raportet financiare, si dhe të gjitha dokumentet e tjera, që kanë të bëjnë me subjektin tatimpagues, korrespondencën e biznesit, faturat dhe dokumentet përkatëse, që duhen krijuar dhe mbajtur për përcaktimin e shumave të tatimeve, që duhen paguar nga tatimpaguesi;

dh) “Periudhë tatimore” është periudha e njëjtë me vitin kalendarik, me përjashtim të rasteve kur ky ligj ose ligje të tjera tatimore parashikojnë ndryshe;

e) “Përfaqësues i tatimpaguesit” është personi i autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar tatimpaguesin në çështje tatimore;

ë) “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;

f) “Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji për tatimet dhe detyrimet tatimore zbatohen njëjloj edhe për taksat;

g) “Tatimpagues” është personi apo individi, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim;

gj) “Vend kryesor i biznesit” është vendi i administrimit efektiv të biznesit;

h) “Person i lidhur” me tatimpaguesin, sipas rastit, janë:

i) personat, me të cilët është/janë lidhur një/shumë marrëveshje biznesi;

ii) kontrolluesi apo i kontrolluari prej tij;

iii) individët, që kanë lidhje gjaku deri në shkallën e dytë në rastin e individit tregtar;

iv) individët, që ushtrojnë detyra drejtuese në organizimin e më shumë se një tregtari;

v) individët, që kanë marrëdhënie punësimi edhe me tatimpagues të tjerë.

Neni 6

Detyrimi tatimor

1. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.

2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përlllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie.

3. Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj.

4. Detyrimi tatimor për individë të vdekur ose shoqëri të likuiduara përcaktohet si më poshtë:

a) në rastin e një personi të vdekur, detyrimi tatimor pushon në datën e vdekjes dhe trashëgimtarët ligjorë janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimeve të këtij personi;

b) në rastin e një personi juridik të likuiduar, detyrimi tatimor pushon në datën e likuidimit dhe likuidatori ose përfaqësuesi, i caktuar ligjërisht, është përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimit të këtij personi.

5. Detyrimet tatimore llogariten dhe paguhen në monedhë kombëtare, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit

1. Me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe, agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues.

2. Agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe këto detyra plotësuese:

a) të llogarisë saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues;

b) të paguajë tatimin në burim në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj;

c) të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura në burim të të gjithë tatimpaguesve dhe të pagesave, të transferuara në Buxhetin e Shtetit;

ç) t'i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur, të përcaktuar në ligj;

d) të kryejë të gjitha detyrat e tjera, të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 8

Tatimpaguesi rezident dhe jorezident

1. Tatimpagues rezident është:

a) individi, i cili:

i) ka një vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;

ii) ka nënshtetësi shqiptare dhe është funksionar diplomatik ose kryen një funksion të ngjashëm, në emër të Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj;

iii) në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë më tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh;

b) personi juridik, i cili:

i) është regjistruar si person juridik shqiptar;

ii) e ka vendin e administrimit efektiv të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;

c) personi fizik, i cili është regjistruar në organin kompetent me këtë cilësi, në bazë të legjislacionit shqiptar.

2. Tatimpaguesi, që nuk plotëson të paktën njërën nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, është tatimpagues jorezident.

Neni 9

Caktimi i përfaqësuesi tatimor të personave jorezidentë

1. Tatimpaguesi jorezident emëron një përfaqësues tatimor rezident dhe regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Tatimpaguesi jorezident mund të mos emërojë përfaqësues tatimor, në njërën nga rastet kur:

a) të gjitha të ardhurat, me burim në Shqipëri, janë objekt i tatimit përfundimtar, të mbajtur në burim;

b) tatimpaguesi e dorëzon vetë deklaratën tatimore.

Neni 10

Udhëzimet teknike

1. Ministri i Financave nxjerr udhëzim të përgjithshëm në zbatim të këtij ligji.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesë të tatimpaguesit, dhe, kur është e nevojshme, nxjerr vendim për qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit. Vendimi është detyrues për administratën dhe tatimpaguesin, që ka bërë kërkesën dhe publikohet brenda 5 ditëve kalendarike, duke ruajtur të drejtën e konfidencialitetit të të dhënave të biznesit të tatimpaguesit. Vendimi bëhet detyrues për tatimpaguesin në datën që merr njoftim për të, në njërën nga format e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatohet njëjloj edhe për raste të tjera, të ngjashme.

Neni 11

Negocimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Ministria e Financave është, sipas rastit, autoritet nënshkrues apo palë në negociatat, që zhvillohen për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, me efekte tatimore.

2. Autoriteti nënshkrues dhe miratues i këtyre marrëveshjeve vepron në përputhje me ligjin “Për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare”.

KREU II

PARIMET, ORGANIZIMI DHE PERSONELI I ADMINISTRATËS TATIMORE

Neni 12

Parimet e administrimit tatimor

Në administrimin e sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë administrata tatimore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore;

b) vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;

c) nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore;

ç) hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;

d) bashkëpunimi me organet tatimore vendase dhe ndërkombëtare, në funksion të globalizimit të ekonomive botërore;

dh) ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;

e) nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor;

ë) rekrutimi, trajnimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve tatimorë, të ndershëm, të sjellshëm dhe të drejtë dhe që, për çdo rast, zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet, në bazë të fakteve objektive.

Neni 13

Organizimi i administratës tatimore

1. Administrata tatimore përbëhet nga:

a) administrata tatimore qendrore, ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj;

b) administrata tatimore vendore, ku përfshihen zyrat tatimore, nën autoritetin e qeverisjes vendore.

2. Administrata tatimore qendrore është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Financave.

Neni 14

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve, siç parashikohet në nenin 4 të këtij ligji.

2. Drejtoria rajonale varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

3. Drejtoria rajonale drejtohet nga drejtori i drejtorisë rajonale.

Neni 15

Zyrat tatimore të qeverisjes vendore

Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore.

Neni 16

Struktura e administratës tatimore qendrore

1. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.

2. Organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

3. Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori, sipas funksioneve të mëposhtme:

a) shërbimi dhe edukimi i tatimpaguesve;

b) kontrolli tatimor;

c) apelimi;

ç) mbledhja e detyrimeve tatimore dhe zbatimi i masave shtrënguese;

d) hetimi tatimor;

dh) funksionet mbështetëse, përfshirë financën dhe statistikat, teknologjinë e informacionit dhe kontrollin e brendshëm, shërbimet ligjore, administratën e burimet njerëzore dhe hartimin e rregullave teknike.

e) **investigimi i brendshëm antikorrupsion.**

ë) **Avokati i Tatimpaguesve**

4. Drejtoria e apelit është një njësi e pavarur brenda administratës tatimore qendrore.

5. Funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtorive rajonale, të secilës drejtori, si dhe të njërive të tjera të administratës tatimore qendrore përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.

6. Ministri i Financave mund të vendosë që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të nënkontraktohen subjekte private, të specializuara, për realizimin e funksioneve të parashikuara në pikën 3 shkronja “dh të këtij neni.

Neni 17

Emërimi i Drejtorit dhe i Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve

1. Organ drejtues i administratës tatimore qendrore është Drejtori i Përgjithshëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave.

3. Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të Tatimeve emërohen nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 18

Drejtoria e apelit tatimor

Drejtoria e apelimit tatimor është në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe është e pavarur në vendimmarrje. Drejtori i drejtorisë së apelimit tatimor emërohet nga Ministri i Financave.

Neni 19

Emërimi i personelit

1. Për nëpunësit e administratës tatimore qendrore zbatohet legjislacioni i nëpunësit civil për institucionet e pavarura, përveç se kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Për procedurat e rekrutimit të tyre zbatohet legjislacioni i nëpunësit civil për institucionet e pavarura.

3. Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e administratës tatimore, që nuk kanë statusin e nëpunësit civil, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 20

Punësimi dhe kategoritë e punësimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore, për rekrutimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve dhe punonjësve të tjerë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në drejtoritë rajonale.

2. Në organikë, personeli ndahet sipas detyrave, në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues, të kategorizuar në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

3. Nivelet e pagave për çdo kategori, si dhe procedurat e afatet e kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.

Neni 21

Shpërblimet e personelit

1. Personelit të administratës tatimore qendrore u jepen shpërblime stimuluese, për:
 - a) efektivitetin e shërbimit të kryer në organet tatimore;
 - b) kryerjen e një shërbimi me rrezikshmëri të veçantë.
2. Shpërblimet stimuluese jepen nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
3. Ministri i Financave miraton udhëzimin për rregullat, që ndjek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në dhënien e shpërblimeve.

Neni 22

Procedura disiplinore

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve shqyrton rastet e shkeljeve, të evidentuara nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të administratës tatimore qendrore dhe miraton masat disiplinore, në cilësinë e eprorit direkt.

2. Procedurat disiplinore fillojnë:

- a) pas kërkesës, me shkrim, të eprorit, nëpunësit apo punonjësit të administratës tatimore;
- b) pas kërkesës me shkrim, të bërë nga tatimpaguesi;
- c) me nismën e Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Masat disiplinore, që zbatohen për nëpunësit civilë të administratës tatimore, janë në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

KREU III

DISPOZITA ADMINISTRATIVE TË PËRGJITHSHME

Neni 23

Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin

1. Administrata tatimore mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve të veçantë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave. Kur nuk kërkohet formular, çdo komunikim, i kërkuar sipas legjislacionit tatimor, dërgohet në mënyrë elektronike ose dorëzohet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomandë.

3. Afati i marrjes dijeni për aktet dhe korrespondencën tjetër, që i dërgohet tatimpaguesit, është shtatë ditë kalendarike pas datës së dërgimit. Data e dërgimit është data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar.

4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve.

5. Ministri i Financave, në zbatim të këtij neni, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, miraton llojet e dokumentacionit, të dhënat, që duhet të përfshihen në informacion, si dhe procedurat e dërgimit pranë administratës tatimore.

Neni 24

Dhënia e informacionit tatimor nga administrata tatimore

Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;

c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;

ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;

d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;

dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;

e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

Neni 25

Konfidencialiteti

1. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo pikë nuk zbatohet për detyrimet tatimore, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë.

2. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi nëpunësi apo punonjësi nuk është më i punësuar pranë administratës tatimore.

3. Informacioni i lidhur me tatimpaguesin përdoret brenda administratës tatimore, vetëm në masën e kërkuar për administrimin e tatimeve.

4. Kushti i ruajtjes së konfidencialitetit përfundon në rastet kur tatimpaguesi heq dorë, me shkrim, nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për aq sa është e lejuar në deklarin e bërë nga tatimpaguesi.

5. Shkëmbimi i informacionit, i bërë në ekzekutim të marrëveshjeve të lidhura nga administrata tatimore, bëhet me kushtin e ruajtjes së konfidencialitetit për institucionet dhe individët, që marrin dijeni për të dhënat tatimore.

Neni 26

Shmangia e konfliktit të interesit

1. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore zbatojnë, në mënyrë të drejtë e të paanshme, ligjet tatimore dhe nuk administrojnë, ndikojnë apo orientojnë tatimpaguesin në veprimtarinë e tij, si dhe deklarojnë paraprakisht rastet, kur kanë lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthortë me tatimpaguesin.

2. Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të kontrollojnë apo vlerësojnë tatimet e veta apo të personave të lidhur me ta, me përjashtim të rasteve të vetëvlerësimit.

3. Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të punësohen, me kohë të pjesshme apo të plotë, në veprimtari të tjera me pagesë, me përjashtim të veprimtarisë së mësimdhënies.

Neni 27

Publikimi i informacionit tatimor

1. Administrata tatimore mund ta publikojë informacionin e mbledhur gjatë veprimtarisë së saj, me qëllim përdorimin e të dhënave tatimore në hartimin e statistikave.

2. Publikimi bëhet në mënyrë dhe formë, që nuk lejon identifikimin e tatimpaguesit specifik.

Neni 28

Informimi i publikut

1. Administrata tatimore ka për detyrë që, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike, të informojë publikun për përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatimor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon materiale sqaruese, komantarë dhe materiale të tjera shpjeguese, në lidhje me legjislacionin tatimor.

2. Për qëllime të informimit të publikut, për ligjet e reja tatimore, ndryshimet e bëra për legjislacionin tatimor dhe për aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, bëhet publikimi i akteve nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike, si dhe përmes faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, jo më vonë se 15 ditë nga data e hyrjes në fuqi të tyre.

Neni 29

Dosja e detyrimeve tatimore

1. Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

2. Forma, mënyra dhe afati i ruajtjes së të dhënave të dosjes përcaktohen me rregullore, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

3. Administrata tatimore vë në dispozicion dhe garanton, në rrugë elektronike, aksesin e tatimpaguesit në dosjen e tij. Në rastet kur tatimpaguesi nuk mund të përdorë rrugën elektronike të marrjes së të dhënave, administrata tatimore vë në dispozicion kopje të dokumenteve të dosjes, sipas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit.

KREU IV

TË DREJTAT E TATIMPAGUESIT

Neni 30

E drejta për informim dhe asistencë

1. Çdo tatimpagues ka të drejtë që, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërbim nga administrata tatimore. Brenda strukturës së administratës tatimore krijohen strukturat përgjegjëse për shërbimin e tatimpaguesve.

2. Çdo tatimpagues ka të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga administrata tatimore, për çështje, që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore.

Neni 31

E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

1. Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.
2. E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta.

Neni 32

E drejta për njoftim

Çdo tatimpagues ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes së njoftimit, tatimpaguesi ta transferonte pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor.

Neni 33

E drejta për kontrolle të arsyeshme

Tatimpaguesi ka të drejtë t'i sigurohen kontrolle të arsyeshme, të cilat të kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 34

E drejta për informim

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje për vlerësimin tatimor, të bërë nga administrata tatimore tatimpaguesi ka të drejtë të marrë përgjigje me shkrim, në lidhje me arsyet dhe mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë.
2. Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vërtetim për të ardhurat e tatueshme, për detyrimet tatimore të mbetura, si dhe për pagesat e kryera nga tatimpaguesi.

Neni 35

E drejta për përfaqësim

1. Tatimpaguesi ka të drejtë të emërojë një përfaqësues, me prokurë, i cili përfaqëson atë në raport me administratën tatimore.
2. Tatimpaguesi mbetet personalisht përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve tatimore edhe në rastin e emërimit të përfaqësuesit me prokurë.

Neni 36

E drejta për të kërkuar evidenca me shkrim apo në rrugë elektronike

Tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë nga administrata tatimore, në rrugë elektronike apo me shkrim, kopje të njësuara me origjinalin, për çdo dokument, që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo të kërkojë kopje të printuara dhe të certifikuara të të dhënave elektronike, të lidhura me të.

Neni 37

E drejta për t'u dëgjuar

Tatimpaguesi, përpara marrjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtën të dëgjohet nga administrata tatimore.

Neni 38

E drejta për t'u ankuar

Tatimpaguesi gëzon të drejtën e ankimit dhe të sigurimit për një shqyrtim të pavarur administrativ të çështjeve të lidhura me të.

Neni 38/1

Këshilli Tatimor si organ këshillimor

1. Pranë Ministrit të Financave krijohet Këshilli Tatimor, si organ këshillimor.
2. Këshilli Tatimor është forum teknik këshillimi dhe bashkëpunimi për dhe ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe tatimpaguesve.
3. Këshilli Tatimor ka për qëllim diskutimin e problematikave dhe propozimin e masave, që do të bënin të mundur zbatimin e legjislacionit tatimor me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit.
4. Këshilli tatimor ka keto funksione:
 - a) shqyrtimin e procedurave të deklarimit e të pagimit të tatimeve, me synim përmirësimin dhe lehtësimin e tyre;
 - b) shqyrtimin e vështirësive, që hasin tatimpaguesit në plotësimin e të drejtave që parashikohen nga legjislacioni tatimor;
 - c) propozimin e masave për të garantuar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve;
 - ç) propozimin e ndryshimeve të procedurave, për të mundësuar plotësimin vullnetar të

detyrimeve tatimore me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit;

d) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për masat që mund të merren për përmirësimin e procedurave të deklarimit e të pagimit vullnetar të tatimeve;

dh) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për plane konkrete bashkëpunimi, ndërmjet shoqatave profesionale tatimore, shoqatave të biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me informimin dhe edukimin e tatimpaguesve;

e) organizimin e seminareve e të trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e administratës tatimore dhe të organizatave profesionale tatimore të tatimpaguesve.

5. Këshilli Tatimor mund t'i propozojë Ministrin të Financave ndryshime në dispozitat ligjore e nënligjore tatimore, që lidhen me objektin e vet të veprimtarisë.

6. Burimet e financimit të Këshillit Tatimor janë:

a) Buxheti i Shtetit;

b) kontributi i anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit;

c) burime të tjera të ligjshme financiare, të dhëna në formë donacioni nga institucione apo nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare, për financimin e veprimtarive që lidhen me objektin e vet.

7. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Tatimor, si dhe kontributet financiare të anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit në të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

DETYRIMI I TATIMPAGUESIT PËR REGJISTRIM

Neni 39

Regjistri i individëve

1. Si numër identifikimi për qëllime tatimore, për tatimpaguesin që është individ, shërben numri personal i identifikimit, i marrë në përputhje me legjislacionin e fushës.

2. Administrata tatimore qendrore mban regjistër të veçantë të individëve.

Neni 40

Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

1. Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.

3. Afati për dorëzimin e aplikimit, formati i aplikimit dhe mënyrat e dorëzimit të aplikimit përcaktohen në ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Dokumentet e kërkuara, si pjesë e aplikimit për qëllime tatimore, përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

4. Regjistrimi, në përputhje me ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” shërben njëkohësisht si regjistrim në skemat e sigurimit, shoqëror dhe shëndetësor në inspektoratet e punës dhe organet doganore. **Për personat, “të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant” dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie”, regjistrimi për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose çregjistrimi i tyre kryhet nga organet tatimore, sipas një procedure të veçantë, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.**

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

Neni 41

Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar

1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, atyre u mbyllet veprimtaria dhe u konfiskohen të gjitha materialet, sipas nenit 121 të këtij ligji.

2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKR, përveç konfiskimit të materialeve, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencave/autorizimeve për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.

Neni 42

Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës.

2. Administrata tatimore mban një regjistër elektronik të veçantë për organizatat jofitimprurëse.

3. Në regjistrin e organizatave jofitimprurëse regjistrohen këto të dhëna:

- a) emri;
- b) kohëzgjatja, nëse kjo është e përcaktuar;
- c) objekti i veprimtarisë;
- ç) vendi i ushtrimit të veprimtarisë;
- d) të dhënat vetjake të drejtuesit dhe të përfaqësuesit ligjor të organizatës;
- dh) dokumenti, që vërteton kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimeve të tyre;
- e) specimenë të përfaqësuesve të organizatës, në raport me të tretët;

ë) numri i të punësuarve.

4. Regjistrimi në administratën tatimore të organizatave jofitimprurëse bëhet pas depozitimit në administratën tatimore të formularit të kërkesës, së bashku me dokumentacionin, që i bashkëlidhet formularit. Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i kërkuar, si pjesë e kërkesës, publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshëm të Tatimeve mund të merret pa pagesë, në çdo sportel të njësive të shërbimit ndaj tatimpaguesit.

5. Administrata tatimore, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së formularit të plotë dhe të saktë të aplikimit, përpunon kërkesën për regjistrim tatimor dhe e pajis kërkuuesin me numër identifikimi.

6. Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim nuk e çliron organizatën jofitimprurëse nga pagesa e detyrimeve tatimore.

Neni 43

Përditësimi i të dhënave të regjistrimit

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore përkatëse, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll, i kryer nga administrata tatimore, qendrore ose vendore, administrata që kryen kontrollin njofton administratën tjetër, brenda 10 ditëve kalendarike pas këtij ndryshimi.

3. Organizatat jofitimprurëse duhet të njoftojnë administratën tatimore për ndryshimet që vijnë, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të ndryshimeve:

- a) ndryshimi i emrit;
- b) ndryshimi i adresës së veprimtarisë ose kontaktit;
- c) ndryshimi i statusit ligjor;
- ç) krijimi/mbyllja e degëve, sektorëve ose njësive të reja;
- d) ndryshimi i llojit të veprimtarisë ekonomike;
- dh) ndryshimi i numrit të punonjësve;
- e) çdo ndryshim tjetër, i parashikuar në aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji.

Neni 44

Kalimi në regjistrin pasiv

1. Administrata tatimore, kur zotëron prova se tatimpaguesi, për një periudhë tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm:

- a) nuk ushtron më veprimtari tregtare;
- b) nuk dorëzon deklaratën tatimore;
- c) deklaron pezullim veprimtarie tregtare, transferon regjistrimin e një tatimpaguesi nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore.

2. Në rastin e shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, për transferimin kërkohet miratimi me shkrim i tatimpaguesit. Në këtë rast, për të gjithë periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv nuk llogariten gjoba për mosdeklarim tatimor.

3. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e transferimit të regjistrimit në regjistrin pasiv, njofton tatimpaguesin me shkrim.

4. Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues dhe nuk e ndalon administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor, pas transferimit në regjistrin pasiv.

5. Administrata tatimore, automatikisht, transferon regjistrimin nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv, kur tatimpaguesi rifillon veprimtarinë, dorëzon të gjitha deklaratat tatimore dhe kryen të gjitha pagesat e kërkuara.

6. Të gjithë tatimpaguesit, që rezultojnë mosdeklarues për më shumë se 5 vite kalendarike, duke filluar nga muaji janar i vitit pasardhës të vitit në të cilin tatimpaguesi është mosdeklarues, transferohen automatikisht nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv.

Neni 45

Çregjistrimi tatimor

1. Personat e regjistruar në organin tatimor mund të çregjistrohen në rastet që vijojnë:
a) personat fizikë dhe juridikë, sipas dispozitave të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

b) organizatat jofitimprurëse, në bazë të vendimit të gjykatës.

2. Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ose gjykatës çregjistrohen pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të personit fizik.

Organi tatimor kompetent, brenda 30 ditëve nga data e këtij njoftimi, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve deri në çastin e aplikimit për çregjistrim në QKR (në rastin e personave fizikë) ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë (në rastin e personave juridikë) dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti.

4. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se, brenda 30 ditëve, administrata tatimore e kundërshton, me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit.

5. Nëse pas 30 ditëve nga data e njoftimit, organi tatimor kompetent nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, apo kundërshtimi nuk përmban shumën e detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të papaguara, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata kryejnë menjëherë çregjistrimin e subjektit.

6. Pasi subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, gjobat dhe interesat e papaguara deri në datën e hapjes së procedurave të likuidimit apo të kërkesës për çregjistrim, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

7. Nëse, brenda 30 ditëve, tatimpaguesi shlyen detyrimin tatimor, administrata tatimore e tërheq kundërshtimin menjëherë dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit e çregjistron tatimpaguesin brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes së kundërshtimit nga administrata tatimore, ose pasi tatimpaguesi paraqet një dokument, që vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve tatimore.

8. Nëse pavarësisht shlyerjes, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti mund t'i paraqesë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dokumentin, që vërteton shlyerjen e shumës totale të detyrimeve tatimore, të gjobave dhe interesave të përcaktuara në kundërshtimin për çregjistrim. Në këtë rast Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton organin tatimor kompetent.

9. Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore, pas revokimit të regjistrimit.

KREU VI

MBAJTJA E TË DHËNAVE

Seksioni I

Detyrimi për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore

Neni 46

Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit, subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit

1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku regjistrohen:

- a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
- b) veprimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;
- c) veprimet e patatueshme;
- ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit.

Neni 47

Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit e klasifikuar “biznes i vogël”

Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit “Për taksën vendore të biznesit të vogël”, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe

lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apo kupona tatimorë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe dispozitat e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Neni 48

Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të të dhënave tatimore

1. Regjistrat, librat dhe informacioni financiar janë dokumente, që përmbajnë informacionin e regjistruar, në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të veprimeve tregtare të tatimpaguesit, të cilat mbahen për përcaktimin e shumës së detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi.
2. Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet.
3. Tatimpaguesi, për çdo shitje, lëshon faturë tatimore ose kupon tatimor.

Neni 49

Fatura tatimore

1. Çdo shitblerje mallrash apo të drejtash, si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi, që është pjesë e veprimtarisë tregtare, është objekt faturimi.
2. Faturat për shitjen e sendeve apo kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat përfshihen në përlllogaritjet e detyrimit tatimor.
3. Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit apo shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera, të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

Neni 50

Fatura tatimore me TVSH

1. Tatimpaguesi, që i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), sa herë që ofron mallra apo shërbime për një person tjetër, duhet të lëshojë fature tatimore me TVSH, në përputhje me ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.
2. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë transaksione, për të cilat nuk ekziston detyrimi i lëshimit të një fature tatimore, duke përcaktuar kriteret për dokumentimin e këtyre transaksioneve.
3. Përveç përshkrimeve dhe të dhënave, të parashikuara në pikën 3 të nenit 49 të këtij ligji, fatura tatimore me TVSH përmban :
 - a) vlerën, mbi të cilin përlllogaritet TVSH -ja;
 - b) vlerën me TVSH, të zbatuar sipas kategorive të sendeve, punimeve e shërbimeve;
 - c) shumën e TVSH-së.

4. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të përcaktojë kërkesa të tjera, që duhet të përmbajë një faturë tatimore, për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive të zhvilluara, të sendeve të tregtueshme, të punimeve apo të shërbimeve.

Neni 51

Lëshimi i faturës tatimore

1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat një të merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

2. Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, dënohet, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, për efekt të llogaritjes së vlerës së gjobës, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 121 të këtij ligji, përcakton, me udhëzim, mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së tregut, për mallrat, që janë në qarkullim, të pashoqëruara me faturë tatimore.

Neni 52

Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve tatimore

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton formatin e faturës tatimore, e cila shtypet dhe shpërndahet nga autoritetet tatimore apo nga subjekte private të autorizuar.

2. Kriteret, që duhet të plotësojnë personat, që licencohen për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor, kushtet e shtypjes, informacionin që duhet të përmbajnë, standardet e sigurisë, si dhe rregullat e shpërndarjes e të vënies në dispozicion të tatimpaguesve të faturave tatimore, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastet kur shërbimi i shtypjes dhe shpërndarjes së dokumenteve tatimore bëhet nga subjekte tregtare private, autorizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumenteve tatimore lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Neni 53

Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi

1. Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi, për çdo rast të tillë, shënon në faturë edhe numrin e tij të identifikimit.

2. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë forma të posaçme dokumentesh, që zëvendësojnë faturën tatimore.

Neni 54

Kuponi tatimor

1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.

4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

Seksioni II

Pajisjet fiskale

Neni 55

Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale

1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

2. Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së autorizimit për këto shoqëri.

3. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.

Neni 56

Kontrolli i sistemit automatik të mbledhjes së të dhënave të pajisjeve fiskale

1. Ministri i Financave mund të vendosë që mbledhja e të dhënave të pajisjeve fiskale të bëhet nëpërmjet një sistemi automatik.

2. Shërbimi i sistemit të kontrollit automatik mund të kryhet nga subjektet e pajisura me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bazë të kriterëve të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Seksioni III

Mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore

Neni 57

Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore

1. Tatimpaguesi mban kontabilitetin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me aktet e nxjerra në zbatim të tij.

2. Për regjistrimin e veprimeve ekonomike, që lidhen me tatimet dhe taksat, përdoren edhe librat, regjistrat apo dokumentacioni i përcaktuar në ligjet tatimore specifike dhe në dispozitat përkatëse nënligjore.

3. Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë, përfshirë faturën tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat nënligjore përkatëse.

4. Tatimpaguesit, subjekte të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe kuona tatimorë, në përputhje me ligjin e fushës dhe me aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij. Gjithashtu, këta tatimpagues mbajnë dokumentacion tatimor, sipas kërkesave të këtij ligji, të ligjeve specifike tatimore dhe të dispozitave nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

5. Të dhënat dhe regjistrat e nevojshëm për tatimet mund të mbahen në formë elektronike, kur legjislacioni tatimor apo dispozitat përkatëse nënligjore nuk e pengojnë një gjë të tillë, me kusht që të garantojnë, në çdo kohë, një pasqyrim të plotë të veprimeve ekonomike dhe të të dhënave për tatimet.

Seksioni IV

Detyrime të tjera të tatimpaguesit dhe të të tretëve

Neni 58

Dokumentimi i mallrave

Tatimpaguesit që mbajnë, tregtojnë, përdorin ose transportojnë mallra, duhet të kenë dokumentet e nevojshme tatimore, që provojnë pronësinë ose kontrollin mbi këto mallra dhe, me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, i vënë këto dokumente në dispozicion të tyre.

Neni 59

Pagesat me para në dorë

1. Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 300 000 lekë.

2. Përveç detyrimeve të tjera, të parashikuara në këtë ligj, tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor, duhet të reklamojë në vende të dukshme, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve që ofron. Në rastet kur ushtron njëkohësisht tregti me shumicë dhe me pakicë, është i detyruar që t'i organizojë këto veprimtari në vende të veçanta, të ndara nga njëri-tjetri.

Neni 60

Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike

1. Tatimpaguesi vë në dispozicion të administratës tatimore librat, regjistrimet, informacionin, dokumentet e nevojshme për të kryer llogaritjen e saktë të detyrimeve të tyre tatimore.

2. Tatimpaguesi lejon hyrjen e nëpunësve të administratës tatimore në mjediset, ku ushtron veprimtarinë ekonomike, gjatë orarit zyrtar të punës.

3. Me kërkesën e administratës tatimore, tatimpaguesi jep shpjegime shtesë, me gojë ose me shkrim. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose të kërkesave të tjera me shkrim për informacione apo dokumente nga administrata tatimore, brenda 20 ditëve nga data e postimit të kërkesës ose e dërgimit elektronik të tatimpaguesit;

b) takimin me punonjës të administratës tatimore gjatë orarit të punës, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacion, sipas nenit 94 të këtij ligji.

4. Kërkesa e administratës tatimore për shpjegime shtesë bëhet vetëm për informacione, të lidhura me transaksionet tregtare të tatimpaguesit, proceset ose procedurat teknike dhe me operacionet financiare ndërmjet tatimpaguesit dhe palëve të treta.

Neni 61

Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacion

1. Me kërkesën e administratës tatimore, palët e treta japin informacion, me shkrim ose me gojë, vënë në dispozicion librat dhe regjistrimet, si dhe informacion tjetër për detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, me të cilin ata kanë hyrë në transaksione tregtare ose financiare. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve me shkrim, ose të kërkesave të tjera, me shkrim, për informacion ose dokumente, nga administrata tatimore, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur kërkesa, dërguar me postë ose në mënyrë elektronike, është marrë ose vlerësohet të jetë marrë prej palës së tretë;

b) takimin me punonjësit e administratës tatimore gjatë orarit zyrtar të punës në mjediset e veprimtarisë ekonomike të palës së tretë ose në zyrat e administratës tatimore, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacion, në bazë të fletëthirrjes me shkrim, sipas nenit 94 të këtij ligji.

2. Kur tatimpaguesi ose një palë e tretë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas këtij kreu, administrata tatimore mund të ushtrojë autoritetin e vet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Ministri i Financave cakton me udhëzim rastet kur palët e treta janë të detyruara të dërgojnë informacion për administratën tatimore, në mënyrë periodike, sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar.

Neni 62

Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion

Kërkesa me shkrim bëhet për të dhënat e nevojshme, për të përlllogaritur detyrimin tatimor dhe u drejtohet:

- a) personave juridikë, për:
 - i) dividendët, që u paguhen aksionarëve ose ortakëve;
 - ii) personat, me të cilët janë duke kryer ose kanë kryer transaksione financiare apo tregtare;
 - iii) pagesat e bëra për nënkontraktorët apo në pozicionin e nënkontraktorit;
 - iv) debitorët dhe kreditorët;
- b) bankave dhe institucioneve financiare, për:
 - i) pagesat e interesit;
 - ii) depozitat dhe detyrimet në fund të vitit;
 - iii) veprime të tjera bankare;
 - iv) regjistrin elektronik të llogarisë bankare, në emër të tatimpaguesve, përfshirë emrin tregtar dhe numrin personal të identifikimit;
- c) shoqërive komisionere ose fondeve të investimeve kolektive, për transaksionet e titujve;
- ç) agjentëve të pasurisë së paluajtshme, për veprimet ndaj klientëve;
- d) blerësve ose shitësve të pasurisë së paluajtshme, për përshkrimin dhe çmimin e pasurisë së paluajtshme;
- dh) noterëve, për veprime noteriale, për shitblerje të pasurive, të luajtshme apo të paluajtshme, apo kontrata sipërmarrjeje;
- e) personave juridikë, rezidentë dhe jorezidentë, për pagesat e bëra personave jorezidentë;
- ë) institucioneve shtetërore dhe nëpunësve të administratës shtetërore;
- f) kontraktorëve të tjerë të tatimpaguesit;
- g) donatorëve, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, për pagesën bërë tatimpaguesve për furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve.

Neni 63

Përfshirja nga detyrimi për të dhënë informacion

1. Në rast të hetimit tatimor nga organet e administratës tatimore, kanë të drejtë të refuzojnë dhënien e informacionit, sipas këtij neni, personat e mëposhtëm:

- a) anëtarët e familjes së tatimpaguesit;
- b) avokatët, noterët, këshilltarët tatimorë, doktorët, personeli mjekësor, për informacionin, që kanë njohur gjatë veprimtarisë normale profesionale.

2. Personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të tatimpaguesit, nuk janë të detyruar të japin informacion tek organet e administratës tatimore kur ky informacion

mund t'i ekspozojë ata, si dhe anëtarët e shkallës së parë të familjes së tyre për ndjekje penale. Në këtë rast, administrata tatimore duhet ta njohë tatimpaguesin me të drejtën e këtyre personave për të refuzuar dhënien e informacionit, informacion, i cili duhet të regjistrohet dhe nënshkruhet nga personi i interesuar.

KREU VII

DEKLARATA TATIMORE

Neni 64

Deklarata tatimore

1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës.

2. Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore.

3. Deklaratat dhe formularët e tjerë, që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen në dispozicion të publikut, pa pagesë, nëpërmjet:

- a) publikimit në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore;
- b) sporteleve të njësive të shërbimit për tatimpaguesin;
- c) dërgimit me postë, duke përdorur shërbimin postar rekomandë, për ata tatimpagues, që paraqesin kërkesë me shkrim për ofrimin e këtij shërbimi.

4. Formatet e deklaratave dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet deklaratës tatimore, miratohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 65

Dorëzimi i deklaratës tatimore

1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratën tatimore nëpërmjet:

- a) postës, sipas dispozitave të këtij ligji;
- b) mënyrës elektronike;
- c) bankës apo një institucioni tjetër financiar.

2. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën e dorëzimit të deklaratës tatimore.

3. Në rastet kur afati i fundit për dorëzimin e deklaratës bie në ditë pushimi, atëherë si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës, pas ditës së pushimit.

4. Tatimpaguesi dhe, nëse ka, përfaqësuesi i tij nënshkruajnë deklaratën tatimore, shënojnë numrat e tyre të identifikimit tatimor dhe konfirmojnë, në përgjegjësinë e tyre, se deklarata është e plotë dhe e saktë.

5. Deklarata tatimore vlerësohet e dorëzuar, nëse plotësohen kërkesat e këtij ligji, të legjislacionit tatimor dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

6. Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

7. Detyrimi për të deklaruar ndërpritet në çastin e aplikimit në QKR për çregjistrim (në rastin e personave fizikë) ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë (në rastin e personave juridikë).

Neni 66

Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore

1. Në rastet kur tatimpaguesi ndodhet përpara pamundësisë për dorëzimin në kohë të deklaratës tatimore, ai paguan detyrimin tatimor dhe njofton administratën tatimore për zgjatjen e afatit të dorëzimit të kësaj deklarate. Në rastet e pamundësisë për dorëzimin në kohë të deklaratës tatimore, afati i dorëzimit zgjatet automatikisht me 30 ditë dhe për këtë periudhë nuk zbatohet masa e gjobës.

2. Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore nuk ndikon në afatin e pagesës së detyrimit tatimor dhe në përlllogaritjen e kamatëvonesës për detyrimin tatimor, i cili do të rezultojë si i papaguar në çastin e dorëzimit të deklaratës tatimore.

Neni 67

Deklarata tatimore e ndryshuar

1. Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi.

2. Deklarata e ndryshuar mund dorëzohet brenda dymbëdhjetë muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare.

3. Dorëzimi i një deklarate tatimore të ndryshuar përfshin:

- a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë;
- b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar;
- c) kërkesën e tatimpaguesit për kreditimin e tatimit të paguar më tepër plus interesat e llogaritura për këtë periudhë, duke e llogaritur këtë shumë për llogari të detyrimeve tatimore të tjera, ekzistuese apo të ardhshme;
- ç) kërkesën për rimbursimin e tatimit të paguar më tepër, plus interesat.

4. Për llogaritjen e interesit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji për kamatëvonesat.

KREU VIII

VLERËSIMI TATIMOR

Neni 68

Vlerësimi tatimor

1. Vlerësimi tatimor:
 - a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore;
 - b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës.
2. Nëse tatimpaguesit i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata merret si vetëvlerësim tatimor. Pagesa e tatimit bëhet në mënyrën dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës.
3. Nëse detyrimi tatimor mbahet në burim nga një agjent i mbajtjes së tatimit në burim dhe tatimpaguesi nuk është subjekt i kërkesës së dorëzimit të deklaratës tatimore për tatimin e mbajtur në burim, mbajtja e tatimit në burim është vlerësim tatimor.
4. Nëse administrata tatimore vëren se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor.
5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:
 - a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
 - b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji;
 - c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.
6. Vlerësimi i bërë nga administrata tatimore hyn në fuqi 10 ditë kalendarike pas datës, kur njoftimi i vlerësimit tatimor dhe i kërkesës për të paguar vlerësohet të jetë marrë, siç parashikohet në nenin 69 të këtij ligji.
7. Kur një vlerësim bëhet në përputhje me shkronjat “b” ose “c” të pikës 5 të këtij neni, barra e provës, që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.
8. Shuma e detyrimit tatimor, e detyrueshme për t'u paguar, sipas deklaratës tatimore, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, vlerësohet si detyrim me vlerë zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.

Neni 69

Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor

1. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, duhet t'i dërgojë tatimpaguesit, me postë rekomande, njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor.
2. Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë:
 - a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik;
 - b) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
 - c) datën e njoftimit;
 - ç) çështjen, për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatimore, që u referohet njoftimi;
 - d) shumën e tatimit të vlerësuar, kamatëvonesën dhe gjobat;
 - dh) kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;
 - e) vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;
 - ë) shpjegimin e arsyes së vlerësimit;

f) shpjegimin e së drejtës së tatimpaguesit për të ankimuar vlerësimin.

3. Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tij regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.

4. Nëse nuk bie dakord me vlerësimin e detyrimit tatimor, të kryer nga administrata tatimore, tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit, ose të vlerësuar si të jetë marrë dhe të kërkesës, mund të ankimojë, në përputhje me procedurat e parashikuara në kreun XIII të këtij ligji.

Neni 70

E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor

1. Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.

2. Për detyrimet tatimore, të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, njoftimin e vlerësimit tatimor, në të gjitha rastet, nxirret nga drejtori i drejtorisë rajonale.

3. Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël.

Neni 71

E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi

Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur:

a) tatimpaguesi nuk dorëzon deklaratën tatimore, në përputhje me afatin dhe mënyrën e kërkuar në legjislacionin tatimor përkatës;

b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;

ç) tatimpaguesi nuk bashkëpunon me kontrollin tatimor të autorizuar;

d) tatimpaguesi nuk vë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumente të tjera, të nevojshme, për llogaritjen e detyrimit të tij tatimor;

dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;

e) tatimpaguesi hyn në transaksione shitblerjeje me para në dorë, që tejkalojnë shumën 300 000 lekë;

ë) tatimpaguesi nuk përdor rregullisht pajisjen fiskale.

Neni 72

Baza e mënyrave alternative të vlerësimit

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

- a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;
 - b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;
 - c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjerë;
 - ç) të dhëna të tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, si dhe të pagave krahasuese;
 - d) çmimet e referencës së shitjeve me pakicë, kur tatimpaguesit e TVSH-së nuk lëshojnë ose nuk mbajnë fatura tatimore.
2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur.
3. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 73

Afati i parashkrimit të së drejtës për të bërë vlerësim tatimor

1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.
2. Afati i parashkrimit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të ndërpritet kur:
 - a) si rezultat i apelimit të vlerësimit të mëparshëm bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:
 - i) afati i parashkrimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
 - ii) 30 ditë kalendarike nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit;
 - b) si rezultat i një kontrolli ose hetimi tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore, bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:
 - i) afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
 - ii) 30 ditë kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar, me shkrim, të kontrollit ose hetimit tatimor;
 - c) ndaj tatimpaguesit ka filluar një çështje penale për detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:
 - i) afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
 - ii) 30 ditë kalendarike nga data e marrjes nga gjykata e vendimit të formës së prerë, për çështjen penale.
3. Në rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet një çështje penale për detyrimet tatimore të tij, pas kalimit të afatit të parashkuar në pikën 1 të këtij neni, e drejta për vlerësim tatimor vlerësohet se nuk është parashkuar.

KREU IX

PAGESA DHE RIMBURSIMI I TATIMIT

Neni 74

Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor

1. Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjin tatimor përkatës.
2. Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë.
3. Tatimpaguesi mund t'i paguajë detyrimet tatimore në mënyrë elektronike, nëpërmjet bankave ose institucioneve të tjera, që kanë lidhur marrëveshje me administratën tatimore, për të pranuar këto pagesa.
4. Kur afati i fundit për pagesën e detyrimit tatimor bie në ditë pushimi, data e pagesës së tatimit është dita e parë e punës, pas ditës së pushimit.
5. Të gjitha pagesat tatimore kryhen në lekë.

Neni 75

Detyrimet tatimore të paguara më tepër

1. Kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin për vlerësimin tatimor, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi.
Pas kësaj, me miratimin, me shkrim, të tatimpaguesit, shuma e mbetur, nëse ka:
 - a) rimburohet automatikisht, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër;
 - b) kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.
2. Veprimet për shumat e paguara më tepër për detyrimet tatimore regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit.

Neni 75/1

Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore

Nëse personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH, rezultojnë me tepëri kreditore dhe paraqesin, pranë drejtorisë rajonale tatimore, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër, administrata tatimore, brenda 30 ditëve kalendarike, verifikon saktësinë e pretendimit, njofton tatimpaguesin dhe realizon rimbursimin, kur plotësohen kushtet. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

Mënyra dhe procedurat e hollësishme teknike për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 76

Kamatëvonesa

1. Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë për këtë shumë, në masën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

2. Nëse një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore, sipas nenit 75 të këtij ligji, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë për shumën e paguar më tepër, si më poshtë:

a) kur një shumë e paguar më tepër kreditohet kundrejt një detyrimi tatimor tjetër, kamatëvonesa paguhet duke filluar nga data e pagesës më tepër deri në afatin e pagesës së tatimit, kundrejt të cilit bëhet kreditimi;

b) kur një shumë e paguar më tepër rimburohet, kamatëvonesa paguhet për periudhën nga 30 ditë pas bërjes së pagesës më tepër deri në kryerjen e rimbursimit.

3. Masa e kamatëvonesës, sipas këtij neni, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

4. Kamatëvonesa paguhet në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore, as të ankimohet, me përjashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor, për të cilin zbatohet, ndryshon.

Neni 77

Marrëveshja e pagesës me këste

1. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar plotësisht dhe në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë marrëveshje pagese me këste.

2. Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t'i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësisë të ngjashme me të dhe duhet të parashtrijë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore.

3. Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të dhe tatimpaguesi.

4. Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës.

5. Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillë.

6. Tatimpaguesi duhet të paguajë kamatëvonesë për të gjitha detyrimet tatimore, pagesa e të cilave shtyhet, sipas marrëveshjes së pagesës me këste.

Neni 78

Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste

1. Marrëveshja e pagesës me këste zgjidhet nga administrata tatimore kur:

- a) tatimpaguesi nuk i bën pagesat në përputhje me marrëveshjen;
- b) tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja.

2. Nëse marrëveshja e pagesës me këste zgjidhet, të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, paguhen brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes.

Neni 79

Radha e pagesës së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve

1. Pagesat e detyrimeve tatimore bëhen sipas kësaj radhe:
 - a) kostot administrative;
 - b) gjobat e vlerësuara;
 - c) kamatëvonesat;
 - ç) tatimi i vlerësuar.
2. Kostot administrative llogariten në përputhje me rregullat e miratuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave.
3. Radha e pagesës për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është si më poshtë:
 - a) kontributet e punëmarrësit;
 - b) kontributet e punëdhënësit.

KREU X

KONTROLLI TATIMOR

Neni 80

Kontrolli tatimor

1. Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.
2. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe në librat, regjistrimet e informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit, parashikuar në nenin 72 të këtij ligji.
3. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor.
4. Zgjedhja e tatimpaguesve, që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të kryer nga administrata tatimore, për të identifikuar tatimpaguesin, i cili ka më shumë rrezik për ta shkelur legjislacionin tatimor.
5. Kontrolllet, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësive të ngjashme me të. Kontrolllet, që kryhen nga administrata tatimore vendore, urdhërohen nga titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.
6. Procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore miratohen nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 81

Njoftimi i kontrollit tatimor

1. Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit njoftimin, i cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor.

2. Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:

- a) identifikimin e organit, që kryen kontrollin tatimor;
- b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;
- c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- ç) datën e lëshimit;
- d) bazën ligjore për kontrollin;
- dh) llojet e tatimit, objekt të kontrollit;
- e) periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor;
- ë) një përshkrim të të drejtave dhe të detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor, përfshirë të drejtën e ankimit të vlerësimit, që bëhet në bazë të kontrollit tatimor;
- f) datën dhe orën kur fillon kontrolli tatimor;
- g) vendin e kontrollit tatimor;
- gj) nënshkrimin e titullarit të zyrës;
- h) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor.

Neni 82

Përjashtimi i inspektorit nga kontrolli tatimor

1. Nëpunësit e administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, nuk mund të marrin pjesë në kontrollin e këtij tatimpaguesi.

2. Me nëpunës të administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, kuptojmë personin:

- a) me lidhje gjaku deri në shkallën e tretë;
- b) përfaqësues të tatimpaguesit;
- c) të lidhur me marrëveshje biznesi me tatimpaguesin.

Neni 83

Raporti i kontrollit tatimor

1. Inspektori i grupit të kontrollit tatimor është përgjegjës për përgatitjen e raportit të kontrollit, brenda shtatë ditëve kalendarike pas datës së përfundimit të kontrollit tatimor.

2. Raporti i kontrollit jep rezultatet e kontrollit, shumën e vlerësimit të propozuar dhe referencat ligjore, që justifikojnë propozimin e bërë, dhe nënshkruhet nga inspektori/inspektorët e kontrollit tatimor.

3. Një kopje e raportit të kontrollit i jepet drejtorit të drejtorisë rajonale të tatimeve dhe një kopje i dërgohet me postë tatimpaguesit.

4. Tatimpaguesi ka të drejtë t'i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 5 ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

5. Kundërshtimi i tatimpaguesit paraqitet me shkrim, ku jepen arsyet e marrjes së këtij kundërshtimi.

6. Grupi i kontrollit e shqyrton kundërshtimin, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kundërshtimit, ose që vlerësohet të jetë marrë dhe arsyetimi i dhënë nga grupi i kontrollit për kundërshtimin përfshihet në raportin përfundimtar të kontrollit.

Neni 84

Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor

1. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor.

2. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përshkruan vendin e kontrollit, periudhën, për të cilën është kryer kontrolli, një përshkrim të dokumenteve të shqyrtuara, personat e intervistuar, arsyetimin e tatimpaguesit, të marrë parasysh dhe rezultatin e argumentuar të kontrollit.

3. Një kopje e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe shuma e vlerësimit, nëse ka, i dërgohet tatimpaguesit me postë dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore apo në njësinë e ngjashme me të.

4. Nëse raporti përfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, ky vlerësim hyn në fuqi 30 ditë kalendarike nga data që raporti i kontrollit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi

5. Tatimpaguesi, që kundërshton vlerësimin e propozuar, mund ta ankimojë këtë vlerësim, në përputhje me dispozitat e kreut XIII të këtij ligji.

Neni 85

Rikontrolli tatimor

1. Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyruese për administratën tatimore. Për të njëjtin detyrim tatimor nuk mund të kryhen kontrole të mëtejshme, me përjashtim të rasteve kur:

a) tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar gjatë kontrollit tatimor ose nuk ka vepruar, në përputhje me kërkesën me shkrim, për t'i dhënë informacion administratës tatimore, gjatë kryerjes së kontrollit tatimor;

b) administrata tatimore ka prova, konkrete dhe të besueshme, që tatimpaguesi është përfshirë në evazion tatimor;

c) inspektori, gjatë kontrollit tatimor, nuk ka vepruar në përputhje me procedurat dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore. Në përbërjen e grupit të rikontrollit tatimor nuk mund të bëjnë pjesë inspektorë, që kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor të mëparshëm.

2. Rikontrolli tatimor miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kërkesës me shkrim për fillimin e një rikontrolli tatimor, të bërë nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, si dhe nga drejtori i drejtorisë së kontrollit apo auditit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 86

Bashkëpunimi me specialistë të jashtëm

1. Në rastet kur punonjësve të administratës tatimore u mungon ekspertiza e duhur, për të kontrolluar dhe vlerësuar me korrektësi detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, administrata tatimore mund të kërkojë asistencë teknike nga specialistë të jashtëm të fushave të veçanta.

2. Specialistit të jashtëm, të kontraktuar nga administrata tatimore, mund t'i jepet vetëm informacioni teknik përkatës. Specialisti i jashtëm është subjekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit si të gjithë nëpunësit e administratës tatimore.

Neni 87

Asistenca e huaj

1. Administrata tatimore mund të kërkojë asistencën e një autoriteti tatimor të huaj, për zgjidhjen e çështjeve të veçanta tatimore.

2. Asistenca e huaj kërkohet në bazë të marrëveshjeve tatimore, dypalëshe ose shumëpalëshe. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla, asistenca kërkohet në bazë të parimit të reciprocitetit, me kusht që:

a) informacioni i dhënë të jetë objekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit, sipas këtij ligji;

b) informacioni i marrë të përdoret në përputhje me këtë ligj, vetëm në zbatim të legjislacionit tatimor.

KREU XI

MBLEDHJA ME FORCË E DETYRIMIT TATIMOR TË PAPAGUAR

Neni 88

Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar

1. Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

2. Administrata tatimore i ushtron këto kompetenca, duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimalizojë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

3. Kriteri i vlerësimit të riskut bazohet në dokumentacionin financiar, të dhënë nga tatimpaguesi ose palët e treta, duke marrë parasysh shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit dhe aftësinë e tij për ta paguar tatimin.

Neni 89

Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

1. Sa herë që administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, administrata tatimore i dërgon, me postë rekomande, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre.

3. Detyrimi për dërgimin e njoftimit dhe të kërkesës për të paguar nuk zbatohet, nëse administrata tatimore zotëron prova konkrete dhe të besueshme, se tatimi është në rrezik dhe tatimpaguesi, për të shmangur mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, mund të fshehë ose të transferojë aktivet.

4. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, mund të kërkojë pranë organeve kompetente:

a) ndalimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të administratorit, të personit juridik, ortakut dhe aksionarit të personit juridik apo individit tregtar, i cili ka detyrime të papaguara;

b) ndalimin e transferimit jashtë shtetit të shumave të depozituara në llogaritë bankare, në emër të individit tregtar apo të shoqërisë tregtare, që ka detyrime të papaguara.

Neni 90

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo banke, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të mbajë një shumë, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet:

a) shumës që kërkohet të mbahet;

b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

2. Me përjashtim të rasteve kur në ligj është parashikuar ndryshe, nëse në bankë, ku tatimpaguesi ka llogarinë bankare, ka edhe urdhra pagese të tjera, urdhri i lëshuar nga administrata tatimore ekzekutohet i pari.

Neni 91

Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij.

2. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguroese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguroese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

3. Para vendosjes së një barre siguroese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin lidhur me to.

4. Njoftimi për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme, për të identifikuar tatimpaguesin, detyrimin tatimor të papaguar, pasurinë, objekt të barrës siguroese dhe/ose barrën hipotekore dhe kompetencën e administratës tatimore për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit.

5. Format i njoftimit për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekore dhe regjistrat publikë për regjistrimin e tyre parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Nëse plotësohen të gjitha kërkesat në fuqi për njoftimin dhe dorëzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar, në favor të administratës tatimore, barra siguroese dhe/ose barra hipotekore është e vlefshme kundrejt të gjitha të drejtave të tjera mbi pasurinë, objekt të sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar dhe ka përparësi.

Neni 92

Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit tatimor

1. Tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë vendimin për masën e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar te drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të dhe të kërkojë çlirimin nga sigurimi, vetëm kur është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga çasti i marrjes dijeni për këtë parregullsi.

2. Kur kërkesa e tatimpaguesit miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, në bazë të një vendimi të marrë me shkrim, drejtori i drejtorisë rajonale ose titullari i njësisë së ngjashme me të ndërmer menjëherë të gjitha masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për zhbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurinë e tatimpaguesit.

Vendimi futet në dosjen e tatimpaguesit.

Në qoftë se drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo titullari i njësisë së ngjashme me të nuk miraton kërkesën e tatimpaguesit, tatimpaguesi mund ta ankimojë këtë vendim në përputhje me kreun XIII të këtij ligji.

Neni 93

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar **nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguar** në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit **nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë** sipas këtij kreu, është objekt i dispozitave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe realizohet nga administrata tatimore.

3. Urdhri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore. Urdhri duhet të identifikojë tatimpaguesin, pasuria e të cilit është objekt i sekuestrimit, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e tatimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet tatimpaguesit me postë rekomande.

4. Administrata tatimore mund ta sekuestrojë pasurinë sipas detyrimit vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me nenin 91 të këtij ligji dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës, kur urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi, në formën e parashikuar në nenin 94 të këtij ligji.

5. Nëse administrata tatimore vëren se mbledhja e tatimit është në rrezik, mund të dërgojë njoftim dhe kërkesë për pagesën e menjëhershme të këtij tatimi dhe nëse detyrimi tatimor nuk paguhet plotësisht, administrata tatimore ka kompetencë të bëjë sekuestrimin, pavarësisht nga afatet e parashikuara në këtë nen.

Neni 94

Urdhri i sekuestrimit

1. Urdhri i sekuestrimit përmban:

- a) shumën e detyrimeve tatimore të papaguara;
- b) afatin për pagesën e detyrimeve tatimore;
- c) pasurinë që sekuestrohet;
- ç) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;
- d) informacionin rreth së drejtës së tatimpaguesit për ankim administrativ.

2. Nëse objekt i sekuestrimit është paga e tatimpaguesit, urdhri përfshin edhe emrin dhe adresën e punëdhënësit të tatimpaguesit.

Neni 95

Pasuria, objekt i sekuestrimit

E gjithë pasuria e tatimpaguesit është objekt i sekuestrimit në masën e detyrimit tatimor të papaguar, përveç sendeve të përcaktuara në nenin 529 të Kodit të Procedurave Civile.

Neni 96

Shitja e pasurisë së sekuestruar

1. Nëse edhe me kalimin e 15 ditëve kalendarike nga sekuestrimi i pasurisë, bërë në përputhje me nenin 93 të këtij ligji, tatimpaguesi nuk shlyen të plotë detyrimin tatimor të prapambetur, pasuria e sekuestruar konfiskohet nga administrata tatimore dhe shitet në ankand publik, në përputhje me dispozitat procedurale të ligjit për ankandin publik.

2. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes, më pas për të paguar koston administrative, gjobat, interesin dhe tatimin, në përputhje me nenin 79 të këtij ligji.

3. Shuma e mbetur i kthehet tatimpaguesit brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

Neni 97

Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë

1. Në rastet kur shuma e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar nuk mbulon të gjithë shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të nxjerrë një njoftim për palët e treta, me të cilin urdhëron shlyerjen e drejtpërdrejtë të pagesës, brenda 14 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit ose që vlerësohet të jetë marrë, në një shumë të barabartë me vlerën e pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi te pala e tretë, kur ky transferim është kryer pas nxjerrjes së njoftimit të administratës tatimore për sekuestrimin e pasurisë.

2. Përgjegjësia e palës së tretë kufizohet në vlerën e tregut të pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi.

3. Në rastet kur detyrimi tatimor i tatimpaguesit, person juridik, mbetet i pashlyer edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar, personi që, gjatë tre vjetëve përpara nxjerrjes së njoftimit të sekuestrimit, ka marrë nga ky tatimpagues të drejtat mbi pasurinë, nëpërmjet një transaksioni të kryer me vlerë dukshëm më të vogël se vlera e tregut, është në radhë të dytë përgjegjës për detyrimin e pashlyer. Kjo përgjegjësi shkon deri në vlerën e të drejtave të transferuara, duke zbritur shumën e paguar nga personi për këtë pasuri.

Neni 98

E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e treta

1. Administrata tatimore mund t'i kërkojë palës së tretë të kryejë pagesën e drejtpërdrejtë të çdo shumë, që i detyrohet tatimpaguesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit kësaj pale të tretë.

2. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar bëhen në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në nenin 69 të këtij ligji.

3. Në qoftë se pala e tretë nuk paguan shumën brenda afatit të caktuar, ndaj saj administrata tatimore mund të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë, të parashikuara në këtë kre.

Neni 99

Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit

1. Nëse edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, atëherë detyrimi tatimor i mbetur transferohet për llogari të ortakut, aksionarit dhe administratorit përgjegjës për shlyerjen e detyrimit tatimor, në përputhje me nenin 16 të ligjit “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare”.

2. Administratori, ortakët apo aksionarët janë solidarisht përgjegjës për detyrimin tatimor të papaguar të personit juridik.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni vlejnë edhe për rastet kur në përfundim të procesit të likuidimit apo falimentimit të tatimpaguesit, shoqëri tregtare, ka mbetur ende i pashlyer detyrimi tatimor.

4. Ministri i Financave miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni.

Neni 100

Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese

1. E drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej.

2. Afati i parashkrimit, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ndërpritet gjatë periudhës:

- a) së ankimimit të detyrimit tatimor;
- b) kur detyrimi tatimor është objekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore;
- c) kur detyrimi tatimor është objekt i një çështjeje penale.

Neni 101

Detyrimi për t’u paraqitur

1. Administrata tatimore ka të drejtë të thërrasë çdo person që ka dijeni për dokumentacionin apo procedurat tatimore, kur ajo e gjykon se prania e tij është e nevojshme për zbatimin e duhur të legjislacionit tatimor.

2. Administrata tatimore ka të drejtë të thërrasë çdo person për të dëshmuar, për të dhënë ekspertizë ose për të paraqitur librat e regjistrimet, në rastet kur informacioni i kërkuar nuk mund të dërgohet lehtësisht dhe pa shpenzime të mëdha me postë ose në mënyrë elektronike.

3. Kërkesa e administratës tatimore për t’u paraqitur bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore dhe përmban:

- a) identifikimin e zyrës tatimore, qendrore ose vendore, që nxjerr kërkesën për paraqitje;

- b) emrin dhe identifikimin tatimor të personit të thirrur;
 - c) vendin, datën dhe orën e paraqitjes;
 - ç) objektin e kërkesës dhe cilësinë e personit të thirrur (tatimpagues, palë e tretë ose ekspert);
 - d) një listë të librave, regjistrimeve dhe dokumenteve të tjera, që personi duhet të dorëzojë.
4. Kërkesa për paraqitje dërgohet me postë rekomande, të paktën 15 ditë kalendarike para datës së caktuar për paraqitje.
5. Personi thirret gjatë orarit të zyrtar të punës, përveç rasteve kur masa të jashtëzakonshme dhe urgjente kërkojnë që procedura të kryhet jashtë orarit zyrtar të punës.
6. Për mosparaqitje, në përputhje me kërkesën e administratës tatimore, personi i thirrur ndëshkohet me gjobë.
7. Procedura e thirrjes shtyhet vetëm për shkaqe të arsyeshme, që paraqiten në një kërkesë me shkrim të tatimpaguesit.

Neni 102

Ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor

Administrata tatimore ndërpret menjëherë zbatimin e masave shtrënguese të sigurimit të detyrimit tatimor, të parashikuar në këtë ligj:

- a) kur tatimpaguesi shlyen plotësisht të gjitha detyrimet tatimore;
- b) pas mbarimit të afatit të parashkrimit, sipas nenit 100 të këtij ligji;
- c) pas deklarimit si të pambledhshëm të detyrimit tatimor;
- ç) kur detyrimi tatimor falet me ligj të veçantë.

Neni 103

Procedurat për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm

1. Deklarimi i një pjese apo i të gjithë detyrimit tatimor të interesit dhe gjobës, si të pambledhshëm, bëhet pasi të jenë zbatuar dhe evidentuar të gjitha procedurat e mbledhjes, sipas këtij ligji, përfshirë:

- a) shitjen e investimeve likuide dhe të aktiveve të tjera jothelbësore për vazhdimin e veprimtarisë ekonomike;
- b) negocimin e një plani të pagesës me këste;
- c) kryerjen e vlerësimit se falimentimi ose likuidimi nuk do të çonin në një rezultat më të mirë.

2. Vendimi për deklarimin të pambledhshëm të të gjithë ose të një pjese të detyrimit tatimor ka parasysh edhe mundësitë reale të mbledhjes dhe se ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme për mbledhjen e plotë të detyrimit tatimor përbën mënyrën më efçente për maksimalizimin e mbledhjes totale të tatimeve, sipas ligjit.

3. Për klasifikimin si të pambledhshëm të një pjese ose të të gjithë detyrimit tatimor, tatimpaguesi duhet t'i bëjë kërkesë me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Kërkesës i bashkëlidhet dokumentacion i plotë për të gjitha aktivet dhe pasivet e tij, përfshirë edhe:

- a) të ardhurat dhe shpenzimet, të dhëna me hollësi;
- b) parashikimet e fluksit të parasë;
- c) vlerësimet e aktiveve;
- ç) deklaratat e fitimeve e të humbjeve dhe bilancet;
- d) listat e debitorëve e të kreditorëve dhe një vlerësim të mundësisë për mbledhjen e borxheve.

4. Deklarimi i detyrimit tatimor si i pambledhshëm i të gjithë ose i një pjese të tij nuk mund të bëhet kur ka prova të evazionit tatimor ose të mashtrimit.

5. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

6. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij, për shuma të barabarta apo më të mëdha se 5 000 000, lekë bëhet me urdhër të Ministrit të Financave, sipas dokumentacionit dhe rekomandimit, dhënë nga administrata tatimore.

7. Administrata tatimore publikon çdo vit vlerën totale të detyrimeve tatimore të deklaruara si të pambledhshme, numrin e kërkesave në total dhe numrin e kërkesave të pranuar.

Neni 104

Fillimi i procedurave të falimentimit

1. Administrata tatimore kërkon në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare:

- a) 2 vjet pas kalimit në statusin pasiv nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- b) detyrimi tatimor i të cilëve është deklaruar i pambledhshëm;
- c) që deklarojnë rezultat me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vite rresht;
- ç) nuk kanë kryer veprimtari tregtare për një periudhë prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- d) kanë detyrime të pashlyera ndaj administratës tatimore prej të paktën 2 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Tatimpaguesit, shoqëri tregtare, për të cilat administrata tatimore ka kërkuar fillimin e procedurave të falimentimit, publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Mosfillimi i procedurës së falimentimit të tatimpaguesve, shoqëri tregtare, brenda gjashtë muajve nga verifikimi i njërit prej kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nga nëpunësit e administratës tatimore, që verifikojnë apo kanë për detyrë të verifikojnë faktin juridik, përbën shkelje disiplinore.

KREU XII

HETIMI TATIMOR

Neni 105

Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor

1. Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.
2. Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
 - a) mbledhjen e informacionit tatimor;
 - b) hetimin tatimor;
 - c) ndjekjen dhe zbatimin e masave shtrënguese.
3. Punonjësit e njësive të hetimit tatimor gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
4. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor, që ushtrojnë funksionet e ndjekjes dhe të ekzekutimit të masave shtrënguese, pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor, në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 105/1, në titull dhe kudo në përmbajtjen e këtij neni hiqen fjalët “të njësive të hetimit tatimor”.

Neni 105/1 **Struktura dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm** **(Antikorrupsion)**

1. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) janë struktura të specializuara zbulimi, hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.
2. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) ka si mision parësor:
 - a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimeve të administratës tatimore, të cilat mund të përbëjnë vepra penale;
 - b) mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme për veprimtaritë e punonjësve të administratës tatimore qendrore, të cilat mund të përbëjnë vepër penale;
 - c) bashkërendimin e punës me prokurorinë, si hallkë ndërmjetëse, për vazhdimin e plotë të hetimit;
 - ç) shërbimin, si pikë kontakti, ndërmjet administratës tatimore dhe institucioneve të tjera, që kanë si funksion luftën ndaj korrupsionit.
3. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
4. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe ata, që ushtrojnë funksionet e parandalimit, të zbulimit, ndjekjes dhe hetimit të plotë të veprave korruptive pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës. Miratimi i lejes jepet nga Ministria e Brendshme, vetëm pas autorizimit të lëshuar nga Ministri i Financave.
5. Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 105/2 **Struktura dhe funksionet e Avokatit të Tatimpaguesve**

1. Avokati i Tatimpaguesve mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që

përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

2. Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:

- a) evidentimin, klasifikimin dhe trajtimin e drejtë të çdo ankese të marrë nga tatimpaguesit;
- b) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;
- c) bashkëpunimin me drejtorinë e kontrollit të brendshëm, me drejtorinë e personelit dhe me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;
- ç) ndjekjen dhe trajtimin me korrektësi të çdo rasti individual dhe mbylljen e arkivimit të tyre vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor, dispozitat e Kodit të Etikës dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij kreu;
- d) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, drejtorinë e trajnimit dhe drejtorinë e personelit, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;
- dh) bërjen e propozimeve zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm dhe koordinatorëve rajonalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për masa administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;
- e) referimin e rasteve të veçanta drejtorisë së investigimit të brendshëm ose drejtorisë së investigimit kriminal, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregojnë se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të investigimit administrativ ose kriminal;
- ë) bërjen e propozimeve Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

3. Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve ka si funksion parësor sigurimin e një informacioni eficient dhe prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative, si dhe garantimin e plotësimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

4. Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të investigojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është investiguar nga drejtoria e investigimit tatimor apo nga drejtoria e investigimit të brendshëm. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të investigojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces

i. Megjithatë, Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të investigojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i apelimit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumatat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për apelimin.

5. Avokati i Tatimpaguesve emërohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

6. Autoriteti, funksionet e bashkëpunimi i Avokatit të Tatimpaguesve brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Procedurat e hollësishme për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve, si dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar nga shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

8. Manuali i Avokatit të Tatimpaguesve, i cili duhet të përmbajë procedura të hollësishme dhe proceset e punës për mbledhjen e informacionit, evidentimin dhe përpunimin e ankesave të tatimpaguesve, zgjedhjen dhe trajtimin e ankesave e të shqetësimeve të tatimpaguesve, përgjithësimin e rasteve, mbylljen e rasteve, si dhe treguesit e matjes së performancës së punës dhe procedurat e raportimit, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

KREU XIII

ANKIMIMI ADMINISTRATIV TATIMOR

Neni 106

Objekti i ankimit administrativ tatimor

1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor.

Neni 107

Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi

1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjithë gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

Neni 108

Kompetenca për shqyrtimin e ankimit tatimor

1. Drejtoria e apelimit tatimor shqyrton ankimin tatimor dhe merr vendim në bazë të provave dhe të argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore.

2. Drejtoria e apelimit tatimor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë nga tatimpaguesi ose administrata tatimore.

3. Drejtoria e apelimit, pas shqyrtimit të ankimit, vendos:

a) lënien në fuqi të aktit, objekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit;

b) shfuqizimin/revokimin e aktit, objekt ankimi;

c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin.

4. Tatimpaguesi ka të drejtë ta paraqesë personalisht çështjen para drejtorisë së apelimit tatimor ose të caktojë një person për ta përfaqësuar para kësaj drejtorie.

5. Barra e provës, për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.

6. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor duhet të përfshijë një shpjegim, me shkrim, për mbështetjen ligjore të vendimit të marrë prej saj, duke përfshirë arsyetimin, në përputhje me dispozitat e nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 109

Vendimi i drejtorisë

1. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor futet në dosjen e tatimpaguesit dhe nga një kopje i dërgohet, me postë rekomande, tatimpaguesit dhe organit të administratës tatimore, që ka bërë vlerësimin tatimor ose ka marrë vendimin, që është objekt i ankimit.

2. Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë.

3. Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.

4. Për rivendosjen në afat, zbatohen procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 110

Rimbursimi i detyrimit tatimor, pagesa e kamatëvonesës dhe e gjobës

1. Nëse vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor është në favor të tatimpaguesit dhe administrata tatimore e pranon vendimin, detyrimi tatimor, i paguar më tepër nga tatimpaguesi dhe kamatëvonesa për tatimet e paguara më tepër, të llogaritura nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimbursimit, i rimbursohen tatimpaguesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor.

2. Nëse drejtoria e apelimit tatimor lë në fuqi vendimin e administratës tatimore, kamatëvonesa, e llogaritur nga data e nxjerrjes së vlerësimit tatimor fillestar dhe çdo gjobë paguhen nga tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi i kësaj drejtorie është marrë ose vlerësohet të jetë marrë.

3. Njësitë e administratës tatimore, të përfshira në shqyrtimin administrativ të aktit, mund të ankohen në gjykatë kundër vendimit të drejtorisë së apelimit tatimor, sipas afateve të parashikuara në nenin 109 të këtij ligji.

KREU XIV

SANKSIONET

Neni 111

Dënimet administrative

1. Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agjentit tatimor apo përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin dhe për të cilin ky ligj parashikon dënim administrativ, përbën shkelje tatimore administrative.

2. Shkeljet e ligjit, që parashikohen për lëvizjen e mallrave, nëpërmjet kufirit doganor të Republikës së Shqipërisë, dënohen në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

3. Shkeljet e ligjit, që parashikohen për mallrat e akcizës, zbatohen në përputhje me ligjin në fuqi për akcizat.

4. Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore apo rrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore.

5. Gjobat e vendosura për shkelje administrative, që lidhen me një detyrim tatimor, nuk mund të kalojnë 100 për qind të detyrimit tatimor.

Neni 112

Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim

Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në ligje të tjera, mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave dënohet me gjobë me 25 000 lekë për çdo shkelje.

Neni 113

Mosdeklarimi në afat

Tatimpaguesi, i cili nuk lëshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar.

Neni 114

Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit

1. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit, gjatë të cilit pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, shuma nuk mund të jetë më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar.

2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose kërkesës së pasaktë të rimbursimit është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

3. Kjo gjobë zbatohet edhe në rastet kur tatimpaguesi ndryshon deklaratën fillestare, sipas kërkesave të nenit 67 të këtij ligji.

Neni 115

Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim

1. Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë apo i një kërkesë të pasaktë për rimbursim dënohet me një gjobë të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar apo rimbursimit të kërkuar më tepër, për secilin muaj apo pjesë muaji, derisa shuma e detyrimit të paguhet plotësisht. Në asnjë rast shuma nuk mund të jetë më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar.

2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose e kërkesës së pasaktë të rimbursimit është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

Neni 116

Evazioni fiskal

Fshehja e detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve false, deklaratave të pavërteta apo informacioneve joreale, vlerësimi i të cilave çon në përlogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion fiskal dhe dënohet me gjobë të

barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.

Neni 117

**Dënimet për agjentët
e mbajtjes së tatimit në burim**

Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim apo agjenti i taksave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet dhe taksat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit të pambledhur apo të shmangur.

Neni 118

**Mosmbajtja e saktë e librave,
regjistrave dhe dokumentacionit**

Tatimpaguesi, që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël, dhe me 50 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.

Neni 119

Mosdeklarimi i punonjësve

1.Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

- a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh;
- b) tatimpaguesit e tjerë, gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

2.Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit.

3. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore.

Neni 120

**Pagesat ose arkëtimet
me para në dorë mbi 300 000 lekë**

Tatimpaguesit, që janë persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë transaksione shitjeje apo blerjeje me para në dorë, për shuma, që tejkalojnë 300 000 lekë, dënohen me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion.

Neni 121

Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore

1. Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore.

2. Me kërkesë të tatimpaguesit, masa e konfiskimit zëvendësohet me pagesën e menjëhershme të një gjobe, të barabartë me vlerën e tregut për të njëjtin mall.

3. Personi i identifikuar i paregjistruar, në kuptim të nenit 41 të këtij ligji, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit që mban në ruajtje, përdor apo transporton.

Neni 122

Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri në 10 ditë pune, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ii) herën e dytë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, pas mosrespektimit të afatit të parë 10-ditor dhe kur për këtë pajisje është përcaktuar një afat vendosjeje tjetër deri në 10 ditë, pas vendosjes së gjobës së parë, sipas nëndarjes “i” të shkronjës “a” të kësaj pike, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

iii) pas kësaj periudhe, sipas nëndarjes “ii” të shkronjës “a” të kësaj pike, me pezullim të veprimtarisë deri në 6 muaj;

iv) në rastet e mosvendosjes së pajisjes fiskale, me mbyllje të plotë të veprimtarisë;

b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për kontrollin e dytë, me gjobë, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

iii) për kontrollin e tretë, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose me mbyllje të veprimtarisë deri në 6 (gjashtë) muaj;

c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore/biletë me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

ç) lëshon kupon tatimor, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster, që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit, për të kërkuar kupon tatimor, me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;

dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

e) nuk bën faturë për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve të ofruara, me dënim, sipas përcaktimeve të nenit 124 të këtij ligji;

ë) nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave, me dënim, sipas përcaktimeve të nenit 118 të këtij ligji;

(SHFUQIZOHET germa f)

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale, me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë:

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këtë nen bëhen nga organet tatimore të juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

3. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuara, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.

4. Në rast se një tatimpaguesi i është bllokuar veprimtaria nga administrata tatimore dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, atij i konfiskohet e gjithë sasia e mallit.

Neni 123

Dënimet për shoqëritë e autorizuara dhe të paautorizuara

1. Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë dhe/ose mirëmbajnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, 50 000 (pesëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë, nëse:

a) nuk sigurojnë miratimin e tipit në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, përpara hedhjes në treg të një tipi të caktuar të pajisjeve;

b) nuk sigurojnë mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, kur janë të autorizuara për një shërbim të tillë;

c) nuk kryejnë kontrollin periodik të pajisjeve fiskale, në mjediset e tatimpaguesit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;

ç) nuk ndjekin procedurat dhe nuk respektojnë afatet e përcaktuara në aktet nënligjore, në lidhje me instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale;

d) nuk afishojnë në vend të dukshëm autorizimin e dhënë nga Ministri i Financave dhe autorizimet për tipat e pajisjeve, të cilat ato i tregtojnë në mjediset e shitjes.

2. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale të subjekteve të tjera tatimpaguese, të paautorizuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe sekuestrim të pajisjeve fiskale, ndërsa shoqëritë, që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale, dënohen me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.

3. Shoqëritë e autorizuara nga Ministri i Financave dënohen me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) - 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast, nëse:

a) nuk hapin skedarë dhe nuk mbajnë librin e mirëmbajtjes;

b) nuk shkruajnë të dhënat e nevojshme në librin e mirëmbajtjes;

c) nuk nënshkruajnë, si pjesë të kontratës, marrjen përsipër të mirëmbajtjes së pajisjes fiskale;

ç) nuk mirëmbajnë pajisjen fiskale dhe elementet e saj, brenda kushteve të përcaktuara;

d) nuk kryejnë vulosje të pajisjes fiskale;

dh) nuk vënë në dijeni administratën tatimore, në rastet kur tatimpaguesi ka ndërmarrë

veprime për ndryshimin e të dhënave;

e) nuk vënë në dijeni tatimpaguesin, me të cilin kanë kontratë mirëmbajtjeje rreth heqjes apo pezullimit të autorizimit;

ë) nuk marrin në dorëzim të dhënat nga memoria fiskale, në prani të tatimpaguesit dhe të përfaqësuesve të administratës tatimore;

f) nuk ruajnë memorien fiskale në mënyrën e parashikuar nga dispozitat përkatëse.

4. Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, kur konstatohet se tregtojnë pajisje fiskale me funksione të ndryshme nga ato të miratuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në Ministrinë e Financave.

Neni 124

Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore

Moslëshimi i faturës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave, që llogariten dhe paguhën në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

Neni 125

Mosmarrja e kuponit tatimor

1. Blerësi ose përfituesi i shërbimit, i cili gjatë kontrollit në distancat e parashikuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nga vendi i shitjes apo ofrimit të shërbimit, nuk ka kupon tatimor, dënohet me gjobë me 1 000 lekë.

2. Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljes së parashikuar në këtë nen bëhen nga organet e administratës tatimore të juridiksionit, ku kryhen shkeljet.

Neni 126

Mosdhënia e informacionit

Refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me gjobë me 10 000-50 000 lekë për çdo shkelje.

Neni 127

Pengimi i kontrollit ose i hetimit tatimor

1. Tatimpaguesi, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pengon ushtrimin e të drejtave të administratës tatimore për kontrollin apo hetimin tatimor, dënohet me një gjobë nga 100 000 lekë, për biznesin e vogël dhe 1 000 000 lekë për bizneset e tjera.

2. Të drejtën për miratimin e masës së gjobës, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, e ka drejtori i drejtorisë rajonale apo titullari i njësisë së ngjashme me të. Për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël, kjo e drejtë i takon titullarit të zyrës së tatim-taksave të qeverisjes vendore.

3. Në rast se organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare, organet tatimore kanë të drejtë t'ia sekuestrojnë dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Neni 128

Lëshimi i faturës së pasaktë

1. Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t'u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

2. Tatimpaguesi, që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor, dënohet me gjobë 10 000 lekë.

3. Tatimpaguesi, i cili nuk është subjekt i detyrimit për lëshimin e faturës me TVSH dhe lëshon fatura të tilla, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të TVSH-së së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar, si dhe me marrjen e 100 për qind të TVSH-së së faturuar padrejhtësisht.

Neni 129

Dënimet për tatimpaguesit, që janë banka apo institucione financiare

1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, që kryejnë operacione bankare, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) 50 000 lekë për çdo shkelje, për hapjen e llogarive, për pagesa ose forma të tjera transaksionesh bankare/financiare për personat fizikë dhe juridikë, pa dokumentin zyrtar, që konfirmon numrin e identifikimit të tatimpaguesit;

b) 40 000 lekë për çdo shkelje për mosrespektimin e afatit të njoftimit të administratës tatimore për hapjen nga tatimpaguesi të llogarive, të pagesave ose forma të tjera transaksionesh bankare/financiare;

c) 125 për qind të interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, të llogaritur për çdo ditë, deri në transferimin e pagesës në buxhet, për mostransferimin e pagesave nga tatimpaguesi në buxhet, brenda një dite pune nga dorëzimi i urdhrit të transferimit nga tatimpaguesi;

ç) kur banka nuk mban shumën e kërkuar, ajo paguan gjobë të barabartë me 0,2 për qind në ditë të detyrimit të pambajtur.

Neni 130

Mosafishimi i çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobë me 35 000 lekë, për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël dhe 65 000 lekë për tatimpaguesit e tjerë.

Neni 131

Veprat penale

1. Personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjëherë nga veprat që vijojnë, dënohet në përputhje me Kodin Penal kur:

a) me dashje përpiqet të kryejë evazion tatimor;

b) me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk e paguan atë në buxhet;

c) me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor;

ç) me dashje dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar;

d) me dashje nuk i bindet një kërkesë me shkrim për t'u paraqitur në organet tatimore;

dh) me dashje ndërhyr në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit;

e) kërcënon ose kryen shkelje ndaj një zyrtari tatimor;

ë) në bashkëpunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon ryshfete;

f) i ofron ryshfet një zyrtari tatimor;

g) me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose rregullore.

2. Administrata tatimore bën kallëzim penal në prokurori për çdo shkelje të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 132

Ndjekja e dyfishtë

1. Vendosija e dënimit administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjetër tatimor, nuk e ndalon administratën tatimore për të paraqitur kallëzim penal në prokurori, për vepra penale tatimore.

2. Përfundimi i një çështjeje penale kundër tatimpaguesit nuk ndalon vendosjen, për të njëjtin tatimpagues, të një dënimi administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjetër tatimor.

KREU XV

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 133

**Efekti në detyrimet tatimore
dhe vlerësimet ekzistuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e parashikuara në këtë ligj për të gjitha procedurat e mbetura për mbledhjen e detyrimeve tatimore.

Tatimpaguesit, të cilët janë të çregjistruar në QKR, por që figurojnë të regjistruar në regjistrat përkatës të administratave tatimore, konsiderohen të çregjistruar nga këto administrata nga data e çregjistrimit të tyre në QKR. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, administratat tatimore marrin masat për pasqyrimin e këtij veprimi në regjistrat e tyre.

Tatimpaguesve, të cilët kanë bërë kërkesë për çregjistrim në QKR e më pas nuk kanë zhvilluar veprimtari ekonomike, por nuk kanë dorëzuar deklaratat tatimore me vlerë zero dhe, për këtë arsye, janë të evidentuar si debitorë pranë administratës tatimore, u falen gjobat dhe interesat për këtë mosdeklarim.

Neni 134

Komisioni i Apelimeve Tatimore

1. Brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përfundojnë të gjitha funksionet e Komisionit të Apelimeve Tatimore.

2. 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Komisioni i Apelimeve Tatimore nuk do të pranojë më depozitimin për shqyrtim të kërkesave të reja.

3. Komisioni i Apelimeve Tatimore shqyrton të gjitha praktikantët e depozituara në sekretarinë të komisionit, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 135

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 20 pika 3, 52 pika 2, 55 pika 2, 56 pika 2 dhe 91 pika 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 pika 1, 16 pika 5, 21 pika 3, 50 pikat 2 dhe 4, 51 pika 3, 52 pika 1, 53 pika 2, 55 pika 3, 56 pika 1, 64 pika 4, 72 pika 3, 79 pika 2 dhe 80 pika 6 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualët teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjera.

4. Aktet nënligjore dhe manualët botohen edhe në buletinin tatimor dhe janë detyruese për administratën tatimore dhe tatimpaguesit.

5. Buletini tatimor është publikimi zyrtar i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 136

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, shfuqizohet.

Neni 137

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

[Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.](#)

[Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.](#)

[Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.](#)

[Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.](#)

[Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.](#)

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)

[Ndryshuar me Ligjin nr. 10148, dt. 28.9.2009. Botuar ne FI. Zyrtare Nr. 144. Dt. 12.10.2009](#)

[Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne FI. Zyrtare Nr. 194. dt. 20. 01.2010.](#)

[Ndryshuar me Ligjin Nr. 10261, dt. 01.04.2010. Botuar ne FI.Zyrtare Nr. 45. Dt. 21.04.2010](#)

[Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, date 7.04.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 51. Dt.03.05.2011.](#)

[Ndryshuar me Ligj Nr. 62/2012, date 24/5/2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 97, date 9 gusht 2012.](#)

L I G J

Nr. 8438, Datë 28.12.1998

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

Neni 2**

Përkufizime

1) Për qëllim të këtij ligji:

a) emërimi « tatimpagues » nënkupton çdo person që i nënshtrohet detyrimit të tatimit sipas këtij ligji;

b) emërimi « person » nënkupton :

i) një « individ » (person fizik jotregtar sipas Kodit Civil);

ii) një « person fizik » (person fizik tregtar) ;

iii) një « person juridik » (**shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare"**, personat e tjerë juridikë te themeluar sipas Kodit Civil, te cilet ushtrojne veprimtari fitimprurese ne Republiken e Shqiperise, si dhe personat e tjere juridike te themeluar ose të njohur si të tillë me ligje të veçanta) ;

iv) një « ortakëri », si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari të përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik me vete në **format e parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**, nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta.

c) dy persona konsiderohen « persona të lidhur », nëse njëri prej tyre vepron ose mund të veprojë në përputhje me drejtimit, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e personit tjetër, ose që të dy mund të veprojnë në përputhje me drejtimit, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e një personi të tretë, pavarësisht nëse këto drejttime, kërkesa, sugjerime apo dëshira janë komunikuar (deklaruar). Në veçanti do të konsiderohen si « persona të lidhur » personat e mëposhtëm:

i) bashkëshortet, prinderit apo fëmijet e tyre ;

ii) një shoqëri tregtare apo çdo person, që zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 për qind ose më shumë, në vlerë apo në numër, të aksioneve apo të fuqisë votuese të një shoqërie tjetër.

iii) Dy ose më shumë shoqëri, nëse një person i tretë zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 për qind ose më shumë, në vlerë ose në numër, të aksioneve ose të fuqisë votuese në secilën shoqëri.

2. a) Emërimi « Seli e Përhershme », nënkupton një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht apo pjesërisht biznesi i një personi.

b) Do të konsiderohen si seli të përhershme: një zyrë administrative, një degë, një fabrikë, një punishte, një minierë apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore, si dhe një shesh ndërtimi, rikonstruksioni, instalimi apo montimi.

c) Një person nuk do të konsiderohet se ka seli të përhershme nëse ai:

i) përdor mjediset vetëm për qëllim magazinimi apo ekspozimi të mallrave që i përkasin atij personi;

ii) mban një gjëndje mallrash që i përkasin atij personi vetëm me qëllim magazinimi apo ekspozimi;

iii) mban një gjëndje mallrash që i përkasin atij personi vetëm për qëllime përpunimi nga një person tjetër;

iv) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim blerjeje mallrash apo për mbledhje të dhënash për biznesin e atij personi;

v) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim ushtrimin e çdo veprimtarie përgaditore apo ndihmëse për biznesin e atij personi.

ç) Pavarësisht nga dispozitat e shkronjave « a » dhe « b » të sipërpërmendura, kur një agjent i ndryshëm nga një agjent i pavarur, ndaj të cilit zbatohet shkronja « d » e përmendur më poshtë, vepron në emër të një personi, ka dhe zakonisht ushtron një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të atij personi. Ai person do të trajtohet njëllor sikur të kishte një seli të përhershme në vendin ku ushtrohen këto veprimtari, për çdo veprimtari që kryen agjenti për atë person, përveç rasteve kur veprimtaritë e agjentit kufizohen në shkronjën « c » të përmendur më sipër, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin atë vend të caktuar biznesi një seli të përhershme.

d) Një person nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme kur ai ushtron biznesin e tij nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm, apo çdo agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta agjentë të veprojnë në kuadër të zakonshëm të biznesit të tyre.

dh) Fakti që një shoqëri kontrollon ose kontrollohet prej një shoqërie tjetër, nuk përbën në vetvete arsye për ta quajtur secilën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

“3) Për qëllimet e Kapitullit III A të këtij ligji:

a) "biznes" nënkupton çdo veprimtari ekonomike që ka për qëllim realizimin e një fitimi;

b) "vendndodhje e biznesit" nënkupton çdo dyqan, njësi të veçantë ose vende të tjera të palëvizshme, ku kryhet biznes;

c) "qarkullim" nënkupton të ardhurat gjithsej të realizuara nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve;

ç) "ambulant" nënkupton një person fizik, të angazhuar në shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve, i cili nuk ka vendndodhje fikse të biznesit të tij;

d) "transport individual" nënkupton:

i. një person fizik, që kryen si biznes transportin e mallrave ose të pasagjerëve, duke përdorur jo më shumë se një automjet;

ii. një person fizik, që kryen si biznes transportin e mallrave ose të pasagjerëve në ujërat detare të vendit ose në lumenjtë dhe liqenet brenda vendit, duke përdorur jo më shumë se një mjet lundrues.

Neni 3*

Rezidenca

Rezident në Republikën e Shqipërisë janë këta persona:

1) **Individi**, në rast se:

- ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;
- është shtetas shqiptar dhe funksionar konsullor, diplomatik ose i ngjashëm i Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj.

2) **Individi**, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore.

3) **Personi juridik**, i cili:

- a) ka seline qendrore (zyren **qendrore**) në Republikën e Shqipërisë;
- b) ka vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

4. Personi fizik, që, sipas legjislacionit tregtar, është regjistruar me këtë cilesi në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.

Neni 4

Burimi i të ardhurave

Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:

- a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë;
- b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë;
- c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- dh) të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- e) të ardhurat nga kalimi i pronësisë mbi pasuritë e parashikuara në gërmën “dh” të këtij neni;
- ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident;
- f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente;
- g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jo rezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza; **si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit.**
- h) të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident;**
- i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.

Neni 5

Periudha tatimore

Periudha tatimore fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

KREU II

TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

Neni 6

Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale, që më poshtë do të quhen “të ardhura”, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.

Neni 7

Shtrirja e detyrimit

1. Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.
2. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, të realizuara në teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

E ardhura e tatueshme

1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:
 - a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; Përfshihen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventa apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim;
 - b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqëri tregtare;
 - c) të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emëtuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji;
 - ç) të ardhurat që rrjedhin nga drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
 - d) të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar;
 - dh) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;
 - e) të ardhurat e individëve nga lojërat e fati dhe kazinotë.

f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndermjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksoiner zotëron dhe ja shet një personi tjetër;

g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

"gj) të ardhurat e tatueshme, të realizuara gjatë periudhës tatimore nga ato subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, që kanë një qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, të cilat llogariten si diferencë ndërmjet të ardhurave, gjithsej, me shpenzimet e njohura, të specifikuara në nenin 12/2 të këtij ligji."

h) të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave."

Neni 8/1*

Të ardhura të përjashtuara

Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat vetjake:

1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve.

3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqesish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike.

5* Shfuqizohet

6. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

7. Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish të dënuarit politikë.

8. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve.

Neni 9

Tarifat tatimore

1. Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të taten sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, **të ardhurat nga lojërat e fatit**, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, taten me 10 për qind.

3. shfuqizohet.

Neni 10*

Mbledhja e tatimit

1. Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën “a”, të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.
2. Të gjithë punëdhënësit mbajnë regjistrime të pagesave të specifikuar në gërmën “a”, të nenit 8 të këtij ligji, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 11*

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, tokë ndërtesa, tatóhet me 10 përqind të fitimeve të realizuara. Ky paragraf nuk zbatohet në rastet e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën me të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën e ndërtuar mbi tokë. Në këtë rast tatimi i të ardhurave kryhet sipas procedurës së dhënë në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 ditëve, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni.

Neni 12

Të ardhurat e tatueshme nga veprimtaria e biznesit të vogël

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8 000 000 lekë dhe jo më pak se 2 000 000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.

2. Të ardhurat, gjithsej, nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme etj.

Neni 12/1

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10 përqind.

Neni 12/2

Shpenzimet e njohura

Për efekt të përcaktimit të së ardhurës së tatueshme, subjekteve të taksës vendore të biznesit të vogël do t'u njihen si shpenzime nga të ardhurat, gjithsej, të gjitha shpenzimet e kryera ose të lindura gjatë periudhës tatimore, që janë tërësisht të lidhura me qëllimin e biznesit.

Neni 12/3 ** **Shpenzimet e panjohura**

1. Për efekt të përcaktimit të së ardhurës së tatueshme, nuk njihen shpenzimet e mëposhtme:

- a) kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe të truallit;
- b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
- c) vlera e shpërblimeve në natyrë;

ç) SHFUQIZOHET

d) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë, për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;

dh) gjokat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;

e) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;

ë) tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato nga biznesi;

f) shpenzimet për përfaqësim dhe për pritje-përcjellje, të cilat e tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;

g) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave;

gj) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar për qëllime tatimore në ligjin nr.7892, datë 21.11.1994 "Për sponsorizimet", nuk njihen si shpenzime të njohura shumë e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;

h) shpenzimet për dhurata;

i) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi;

j) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit të faturave nga persona të tretë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi;

k) humbjet, dëmtimet, firot dhe skercot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, te j normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;

l) shpenzimet për pagat, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat me marrëdhëniet me punësimin, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ll) shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

m) nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkalar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm;

n) borxhi i keq, nëse nuk plotësohen tri kushtet e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji. Një borxh i keq, që është mbledhur, duhet të përfshihet si e ardhur në çastin e mbledhjes;

nj) shpenzimet për udhëtime, ushqim, akomodim dhe lëvizje duhet të kufizohen te shumat e specifikuar me udhëzim të Ministrit të Financave;

o) shpenzimet për asetet kapitale, përveç shpenzimeve për tokën, veprat e artit dhe pasuri të tjera, që nuk amortizohen, në pronësi të taksapaguesit dhe të përdorura për veprimtaritë e

biznesit të taksapaguesit, do të mbulohen, gjatë kohës, përmes shpenzimeve të amortizimit, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

- i) kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve, me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, në mënyrë lineare, me 5 për qind;
- ii) amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;
- iii) kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet softëare dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave amortizohen në bazë të vlerës së grupit, me 25 për qind;
- iv) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë, me 20 për qind.

2. Baza e amortizimit është vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore, duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë, gjatë periudhës tatimore dhe duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme, gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet të ardhurës së tatueshme dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit është një shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë. Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 12/4

Mbajtja e regjistrimeve

Librat dhe regjistrimet, që kërkohet të mbahen nga tatimpaguesit, janë: libri i shitjes (i qarkullimit), libri i blerjeve, libri i shpenzimeve dhe i të ardhurave dhe libri i aktiveve të biznesit, të cilat do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 12/5

Kreditimi i tatimit

Taksa vendore mbi biznesin e vogël, e paguar gjatë vitit pranë organeve të qeverisjes vendore, është e kreditueshme (e zbritshme) përkundrejt tatimit për t'u paguar, të llogaritur si shumëzim i të ardhurës së tatueshme, në deklaratën tatimore vjetore, me shkallën tatimore.

Neni 12/6

Deklarimi

1. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën "gj" të nenit 8 të këtij ligji, është i detyruar që, deri më 31 mars të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t'u paguar, taksa vendore, e paguar gjatë periudhës tatimore pranë organeve të qeverisjes vendore, çdo shumë për t'u paguar apo për t'u rimbursuar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t'u paguar.

Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me xhiro vjetore të parashikuar nën 2 milionë lekë, duhet të deklarojnë, sipas afateve të

përcaktuara në këtë nen, vetëm nëse xhiroja vjetore për vitin ushtrimor kalon vlerën 2 milionë lekë."

2. Tatimi, i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore tatimore, pakësuar me kreditimin e tatimit, përcaktuar në nenin 12/5 të këtij ligji, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore tatimore."

Neni 13

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

1. Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

3. Çdo deklaratë individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kod fiskal i individit. Edhe në rastin kur individ është person jorezident në Republikën e Shqipërisë, si kod fiskal shërben numri i identifikimit personal në letërnjoftimin e individit.

4. Përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë.

5. Përveç tatimpaguesve të parashikuar në këtë nen, deklarata vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, për arsye se duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur këta individë plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve.

Neni 13/1

Të dhënat që duhet të përmbajë deklarata vjetore e të ardhurave

1. Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore.

2. Deklaruesi, në rast se konstaton gabime materiale të bëra nga ai vetë gjatë plotësimit të deklaratës, ka të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës, të bëjë korrigjimet e nevojshme. **Brenda këtij afati, individ ka të drejtë të bëjë korrigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij korrigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 "Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim" të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."**

3. Për të përfituar nga shpenzimet e zbritshme për fëmijët dhe për personat në kujdestari, të parashikuara në shkronjat "b" e "c" të pikës 1 të nenit 13/3 të këtij ligji, pjesa e deklaratës, që i përket këtyre shpenzimeve, plotësohet vetëm nga kryefamiljari.

4. Mënyra e plotësimit nga kryefamiljari e deklaratës për pjesën e shpenzimeve të zbritshme, për rastet e parashikuara në pikat 2 e 3 të këtij neni, rregullohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 13/2

Të dhënat për të ardhurat bruto

1. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen:

- a) të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët dhe fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, që rezulton nga Deklarata e të Ardhurave Personale të Biznesit të Vogël për të vetëpunësuarit;
- b) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit;
- c) të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit;
- ç) të ardhurat bruto nga interesa bankarë;
- d) fitimi kapital neto, i krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme;
- dh) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- e) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
- ë) fitimi kapital nga dhurimi;
- f) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- g) të ardhura bruto të tjera, të papërmendura në pikën 1 të këtij neni.

2. Të ardhurat e përcaktuara në nenin 8/1 të këtij ligji, nuk përfshihen në të ardhurat bruto për efekt të plotësimit të deklaratës së të ardhurave. **Në rast se shuma e të ardhurave të përcaktuara në pikën 1 e tejkalon masën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në vit, individi detyrohet të plotësojë dhe të dorëzojë deklaratën e të ardhurave individuale vjetore, vetëm nëse shuma e të ardhurave vjetore bruto, sipas pikës 1, e tejkalon shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.**

Neni 13/3

Shpenzimet e zbritshme

1. Tatimpaguesit, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë, mund të jenë subjekte deklaruese. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, sipas pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

- a) kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për jetën dhe shëndetin, të derdhura nga vetë individi. Kufiri maksimal i shpenzimeve, i njohur për kontributet vjetore, është kufiri i përcaktuar në ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";
- b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;
- c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 13/4

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të tatimpaguesit, që plotëson deklaratën vjetore të të ardhurave, është 10 për qind.

Neni 13/5

Mbajtja e dokumentacionit

1. Për çdo të ardhur dhe shpenzim, të referuar në deklaratën vjetore të të ardhurave, tatimpaguesi që bën deklaratën mban kopje origjinale të dokumentit që provon të ardhurën apo shpenzimin e zbritshëm ose fotokopje të njësuar nga institucioni lëshues i dokumentit. **SHFUQIZOHET FJALIA**. Originali i tyre, në çdo rast, ruhet në përputhje me legjislacionin fiskal dhe vihet në dispozicion të administratës tatimore, kur kërkohet prej saj.

2. Afati i ruajtjes së dokumentacionit nga individët deklarues është ai i përcaktuar në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 13/6

Tatimi për t'u paguar

1. Diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave bruto dhe shpenzimeve të zbritshme përbën të ardhurën e tatueshme të individit, e cila tatohet, me shkallën tatimore në fuqi, 10 për qind. Shumës së këtij tatimi i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore, të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve. Për individët rezidentë fiskalë shqiptarë, që kanë realizuar të ardhura dhe janë taksuar për to jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara, të vërtetuara nga autoritetet e këtyre vendeve, janë të kreditueshme në masën e përcaktuar në marrëveshjet specifike. Në rast se të ardhurat i kanë realizuar dhe u janë taksuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria nuk ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara nuk janë të kreditueshme.

2. Nëse diferenca është pozitive, deklaruesi, **jo më vonë se data 30 prill** bën pagesën e tatimit. Nëse diferenca është negative, administrata tatimore ia kthen deklaruesit shumën e taksave të paguara më tepër ose, me pëlqim të deklaruesit, kjo shumë mund të përllogaritet si pagesë e kryer për vitin tatimor vijues.

Neni 13/7

Dorëzimi i deklaratës

1. Deklarata dorëzohet në drejtorinë tatimore rajonale më të afërt me vendbanimin e tatimpaguesit, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike.

2. Deklarata hartohet sipas formularit të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 13/8

Afatet e ekzekutimit të kreditimit

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës **30 shtator** të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata.

Neni 13/9

Mosplotësimi në kohë apo plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore vjetore të të ardhurave

1. Kur administrata tatimore konstaton raste të mosplotësimit në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, për dorëzim.

2. Në rast kur tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep informacion të gabuar apo të rremë e të pakorrigjuar nga ai vetë, brenda afatit të parashikuar nga ky ligj për korrigjimin, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal.

Neni 13/10

Udhëzimi i deklaratës vjetore

1. Ministri i Financave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr udhëzim për zbatimin e neneve 13 deri në 13/9 të këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr vendim për zbatimin e nenit 13/3 të këtij ligji.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat personale, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë

Neni 15

Sanksionet

Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi të ardhurat personale përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

KREU III

TATIM MBI FITIMIN

Neni 16**

Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin

1. Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen këta persona:
 - a) **Personat juridikë dhe ortakëritë e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 2 këtij ligji dhe që janë regjistruar për TVSH-në.
 - b) Personat juridikë, ortakëritë të parashikuara në nënparagrafet “iii” dhe “iv” të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 2 dhe që janë të regjistruar për TVSH-në e tjera të personave të themeluara ose të organizuara në bazë të një ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - c) **Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël.**
2. **Çdo person, sipas kuptimit të këtij ligji, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekt i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë çregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekt, që i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël.**

Neni 17

Detyrimi për të paguar

1. Tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Tatimpaguesit jorezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha të ardhurat, me burim në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18***

Përrjashtimet

Përrjashtohen nga tatimi mbi fitimin:

a) organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore;

b) Banka e Shqipërisë;

c) personat juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përrfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;

ç) organizatat e punës apo dhomat e tregëtisë, industrisë ose bujqësisë, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përrfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre;

d) organizatat ndërkombëtare, agjencitë e bashkëpunimit teknik dhe përfaqësitë e tyre, përrjashtimi nga tatimet i të cilave parashikohet nga marrëveshje të veçanta;

dh) personat e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.

e) fondacionet ose institucionet financiare jo bankare të krijuara ose të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;

ë) shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të liçensuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.”

***Të gjitha subjektet e përrmendura në shkronjën “a” deri në shkronjën “ë” të këtij neni, pavarësisht nga përrjashtimi nga pagimi i tatimit mbi fitimin, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që I nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Neni 19*

Fitimi i tatueshëm

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përrcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përrputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.

Neni 20

Shpenzime të njohura

Për përrcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuar nga ky ligj.

Dokumenti i përrdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përrpiluar dhe lëshuar, në përrputhje me udhëzimet e Ministrisë të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.

Për veprimtaritë e ndërtimeve dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, njihet si shpenzim i zbritshëm edhe vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtime. Metodika e përrcaktimit të vlerës së truallit për m² miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe bazohet në koston minimale fiskale të ndërtimeve, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve.

Për veprimtarinë e ndërtimit dhe shitjes me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi. Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal.

SHFUQIZOHET PARAGRAFI

Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.

Neni 21***

Shpenzime të panjohura

1. Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijon:
 - a) Kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe të truallit;
 - b) Kosto e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
 - c) Zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i kontributit të secilit person në ortakëri;
 - ç) vlera e shpërblimeve në natyrë;
 - d) **SHFUQIZOHET**
 - e) dividendët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit për ortakët apo aksionerët e shoqërive tregtare, si dhe fitimet në rastet e ortakërisë;
 - ë)* interesat e paguara, të cilat tejkalojnë normën mesatare të interesit 12 mujor të kredisë për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë
 - f) gjokat, kamatë-vonesat dhe kushtet e tjera penale;
 - g) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera, speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore.
 - gj) tatimi mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të zbritshëm;
 - h) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;
 - i) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara nga Ministri i Financave;
 - j) shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar në ligjin nr. 7892 datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, për qëllime tatimore, nuk njihen si shpenzime të zbritshme shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit.
 - k) shpenzimet për dhurata;
 - l) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi.
 - ll) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit të faturuara nga persona të tjerë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi.
 - m)* humbjet, dëmtimet, frotot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, të normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore.
 - n. shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar.
- Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull.

nj. shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

o. shfuqizohet

2.*Nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkeluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm. Ky kufizim nuk zbatohet për bankat dhe shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut..

3. Në rastin e personave juridikë, që nuk janë themeluar sipas ligjit “Për tregtarët shoqëritë tregtare” paragrafi i dytë i këtij neni zbatohet në të njëjtën mënyrë si edhe për subjektet e tjera të parashikuara në këtë nen.

Neni 22 ***

Amortizimi

1. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet e veprimtarisë llogariten nga:

a) pronari i aktiveve të veprimtarisë, në të gjithë rastet, përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni;

b) në rastet e aktiveve të dhëna me qira, me huapërdorje ose në një formë tjetër, të parashikuar me dispozita ligjore, nga personi që mbart riskun për humbjen apo shkatërrimin e aktivitetit.

2. Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen;

3. Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.

4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara, llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;

5. Dy kategorite e mëposhtme të aktiveve amortizohen, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si vijon:

a) Kompjutera, sisteme informacioni, produkte “softëare” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.

b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

c) Për aktivet e ndërmarrjeve shtetërore apo shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, që amortizohen sipas shkronjës “b” të paragrafit të pestë të këtij neni, norma e amortizimit për vitet 1999-2000 është 10 për qind.

6. Në çdo kategori, të përshkruar në paragrafin e pestë të këtij neni, përqindja e amortizimit, e specifikuar në këtë pikë, zbatohet mbi bazën e amortizimit të kategorisë përkatëse.

7. Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore:

a) duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore;

b) duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore.

Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet fitimit të tatueshëm dhe baza e amortizimit merret zero.

Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit të jetë një shpenzim i zbritshëm veprimtarie.

Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 23 *

Inventari

Njohja fillestare (me kosto) dhe vlerësimi i inventarit, në fund të periudhës tatimore, bëhen sipas metodave të përcaktuara në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të cilat duhet të zbatohen në mënyrë sistematike.

Zhvlerësimi dhe rivlerësimi i inventarit, pas njohjes fillestare, sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ky rregull zbatohet edhe për aktivet financiare dhe aktivet jomateriale.

Neni 24

Borxhet e këqija

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, borxhi i keq njihet si shpenzim i zbritshëm, në rast se plotësohen, njëkohësisht, tri kushtet e mëposhtme:

- a) Një shumë, që korrespondon me këtë borxh, është përfshirë më parë në të ardhurat;
- b) borxhi është fshirë nga librat kontabël të tatimpaguesit;
- c) janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e tij.

Neni 25

Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave dhe të shoqërive të sigurimit janë shpenzime të njohura rezervat teknike, të krijuara në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe provizionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por, në çdo rast, pa tejkalar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm.

Neni 26

Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.

Neni 27

Mbartja e humbjeve

1. Në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit".

2. Në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës, të një personi, ndryshon me më shumë se 25 për qind, ne

vlere ose në numër, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për humbjet e pësuar nga ai person juridik në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit.

Neni 28***

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin deri më 31 dhjetor 2007 është 20 përqind, ndërsa nga data 1 janar 2008 do të jetë 10 përqind.

Neni 29 *

Deklarimi tatimor dhe llogaritja perfundimtare e detyrimit

1. Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Per efekte fiskale, te dhenat e dokumenteve te mesiperme quhen te pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojne dy muaj pas dorezimit te tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk pergjigjet zyrtarisht.

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 te ketij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, ne çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

3. Shfuqizohet.

Neni 30**

Parapagimet

1. Gjatë periudhës vijuese, tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, shumat si më poshtë:

1. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimin mbi fitimin, brenda datës 30 mars për muajt janar, shkurt dhe mars, brenda datës 30 qershor për muajt prill, maj dhe qershor, brenda datës 30 shtator për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 30 dhjetor për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumat si më poshtë: (Hyn ne fuqi ne 1 janar 2013)

a) Për çdo njërin nga muajt janar, shkurt, mars e prill të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) Per çdo njërin nga 8 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore, pakësuar me pagesat e bëra nga janari deri në prill të periudhës vijuese tatimore, pjesëtuar me 8.

1. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës tatimore të vitit të dytë paraardhës, parapagimet për muajt janar-prill të periudhës vijuese tatimore të jenë si vijon:

Shuma e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me numrin e muajve gjatë të cilëve tatimpaguesi ka ushtruar veprimtarinë tatimore. Për përcaktimin e parapagimeve për muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, tatimi llogaritet sipas shkronjës “b” të paragrafit të parë të këtij neni.

3. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës paraardhëse tatimore, parapagimet për muajt Janar-Prill të periudhës vijuese tatimore, të jenë sa shuma e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën e mëparshme, pjesëtuar me numrin e muajve të periudhës së mëparshme, për të cilët është ushtruar veprimtari. Shkronja “b” e paragrafit të parë të këtij neni zbatohet për përcaktimin e parapagimeve, për efekt të muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore.

4. Në rastin kur një tatimpagues fillon të ushtrojë një veprimtari në periudhën vijuese tatimore, parapagimet për këtë periudhë të jenë sa shuma e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën vijuese, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore. **Përjashtimisht tatimpaguesit të cilët fillojnë veprimtarinë në periudhën vijuese dhe ushtrojnë veprimtari në sferën prodhuese, nuk do t'i nënshtrohen parapagimit të detyrimit për tatimin mbi fitimin për një periudhë 6-mujore ose për periudhën e mbetur deri në fund të vitit vijues, nëse kjo periudhë është edhe më e vogël se 6 muaj.

5. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë interes mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave.

6. Nëse organet tatimore vlerësojnë se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ajo mund të rregullojë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin mbi fitimin e vlerësuar prej saj.

7. Për tatimpaguesit, parapagimet mujore të të cilëve, sipas paragrafit të parë të këtij neni, në periudhën vijuese ose atë paraardhëse tatimore nuk kanë kaluar 10 000 Lekë, këto parapagime mund të akumulohen për çdo 3-mujor dhe të paguhen deri në datën 15 të muajit që ndjek 3-mujorin.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi fitimin, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç mbajtjes së gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, përcaktohet në ligjin nr. 9920, date 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 32

Sanksionet

1. Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi fitimin përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për rastet e shkeljeve, për mbajtje të gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.

KREU III/A

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

Neni 32/1

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/2

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/3

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/4

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/5

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/6

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/7

****** SHFUQIZOHET**

Neni 32/8

****** SHFUQIZOHET**

KREU IV

TATIMI I MBAJTUR NE BURIMIN E TE ARDHURAVE

Neni 33****

Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat

1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jo-fitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë:

- a) dividendët;

- b) ndarjet e fitimit;
- c) interesat;
- ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;
- d) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit;
- dh) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;
- e) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikqyrëse që lidhen me to;
- ë) pagesat për qeratë;
- f) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.
- g) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.

2. Pika 1 e këtij Neni nuk zbatohet për:

- a. personat rezidentë shqiptarë, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të tatimit mbi vlerën e shtuar ose personat e regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël;
- b. dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit brenda objektit të përcaktuara në nenin 26 të ligjit;
- c. pagesat e bëra personave jorezidentë për shërbimet për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe mallrave.

3. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, tatimi në burim i mbajtur mbi pagesën, sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqëson detyrimin tatimor përfundimtar.

4. Shfuqizohet

5. Pa çenuar dispozitat e mësipërme të këtij neni, për Agjensinë Ndërkombëtare të Transportit Ajror (ANTA) paguhet tatim në burim në masën 10% si tatim i posaçëm për të ardhurat nga shërbimet navigacionale ajrore. Ky tatim llogaritet nga ANTA mbi arkëtimet bruto nga EUROKONTROLLI dhe paguhet në organin tatimor jo më vonë se 15 ditë nga çasti i arkëtimit të tarifave përkatëse nga EUROKONTROLLI.

Neni 33/1

Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati

prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo muaj vonesë.

3. Personi juridik duhet të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit.

4. Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë/vendimi i personit fizik, sipas këtij neni, për miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni.".

Neni 34

Shfuqizohet Neni 35*

Mbajtja e tatimit dhe regjistrimi

1. Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit të parashikuar në nenet 33 dhe 34 të këtij ligji, derdh tatimin e mbajtur në llogaritë e organeve tatimore jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të muajit të pagesës.

2. Paguesi i këtyre shumave duhet të nxjerrë pagesat e perfitimeve dhe mbajtjen në burim të tatimeve dhe t'ia vërë në dispozicion organeve tatimore, si dhe personit, për të cilin është bërë pagesa, regjistrimet përkatëse.

KREU V

DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 36

Transferimi i çmimit

1. Kur janë vendosur apo krijuar kushte, ndërmjet personave të lidhur në një veprimtari në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që mund të ekzistojnë ndërmjet dy personave të pavarur, organet tatimore mund të vendosin, që të ardhurat e një apo më shumë prej këtyre personave të lidhur të përfshijnë fitimin që ai ose ata mund të kishin arritur, nëse nuk do të egzistonin këto kushte.

2. Për të siguruar aplikimin e drejtë dhe efektiv të këtij neni, organet tatimore mund të arrijnë marrëveshje me kushte që më përpara me personat që kryejnë një veprimtari, të cilat do të përcaktojnë se kushtet specifike ndërmjet personave të lidhur nuk ndryshojnë nga ato që mund të ndodhin ndërmjet personave të pavarur.

Neni 37

Kreditimi i tatimit të huaj

1. Në qoftë se gjatë periudhës tatimore një rezident nxjerr nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë fitime apo të ardhura, tatimi mbi të ardhurat personale apo tatimi mbi fitimin, i pagueshëm nga ai rezident, lidhur me këto të ardhura apo fitime duhet të reduktohen me atë masë të tatimit të pagueshëm mbi këtë të ardhur ose fitim. Masa e tatimit të huaj të pagueshëm duhet të vërtetohet me dokument autentik, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.
2. Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat personale ose tatimi mbi fitimin, i dhënë në paragrafin e parë të këtij neni nuk duhet të kalojë tatimin e pagueshëm mbi fitimin apo të ardhurat nga burimi i huaj, në rast se këto të ardhura realizohen në Republikën e Shqipërisë.
3. Në rastin e një tatimpaguesi, i cili është subjekt i tatimit mbi fitimin, çdo reduktim i tatimit, i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, kufizohet në tatimin, që do të ishte i pagueshëm në Republikën e Shqipërisë, i llogaritur sikur neni 27 i këtij ligji të zbatohet në çdo vend të huaj, në lidhje me fitimet apo humbjet e rezultuara nga burime në atë vend të huaj.
4. Reduktimi i tatimit, sipas këtij neni, duhet të llogaritet në mënyrë të veçantë, lidhur me çdo vend të huaj, nga i cili janë përfituar të ardhurat apo fitimet.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 38 **

Dispozita kalimtare

1. Tatimi që duhet të mbahet në përputhje me paragrafin e parë dhe të dytë të nenin 10 dhe të nenin 33 të këtij ligji, do të mbahet nga pagesat e bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ndërtesat, konstruksionet dhe impiantet e blera para datës 1 Janar 1999 do të amortizohen në bazë të kostos së tyre historike.
3. Aktivet e qëndrueshme, të patrupëzuara, të blera para datës 1 Janar 1999 do të amortizohen mbi bazën e kostos së tyre historike. Nëse vlera, e mbetur kontabël, e regjistrimit të këtyre pasurive në datën 1 Janar 1999 është më e vogël se 50 për qind e kostos së tyre historike, tatimpaguesit i lejohet të vazhdojë amortizimin, në përputhje me udhëzimin nr.8, datë 12.02.1992 “Mbi normat e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme, të personave fizikë dhe juridikë”.
4. Baza e amortizimit të kompiutereve, sistemeve të informacionit, produkteve “soft-ëare” dhe sistemeve të ruajtjes së të dhënave, si dhe të të gjitha aseteve të vepritarisë, të blera përpara datës 1 Janar 1999, për periudhën tatimore 1999, do të jetë vlera e këtyre aktiveve në librin e madh më 1 janar 1999, rregulluar siç është përshkruar në nenin 22, pika gjashtë e këtij ligji.
5. Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore 1999 dhe 2000 të reduktohet me humbjet e pësuar nga tatimpaguesi përpara datës 1 Janar 1999, të llogaritet në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, në qoftë se këto humbje janë regjistruar në deklaratat e fitimit të vitit 1998. Humbjet e pësuar në vitet 1996 dhe 1997 nuk mbarten.
6. Tatimpaguesit, që kanë përfituar lehtësi tatimore në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.7667 datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, i gëzojnë këto lehtësi sipas kushteve të parashikuara me ligjin e mësipërm.
7. ***Tatimpaguesit që kanë gëzuar lehtësi dhe përjashtime, sipas ligjeve nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” dhe nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për miratimin me

ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.02.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", të ndryshuar, i gëzojnë ato, sipas kushteve të parashikuara në këto ligje".

*** Ndryshimet e nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, fillojnë të zbatohen më 1 janar 2008.**

Detyrimi i parë për deklarimin e të ardhurave individuale vjetore, për vitin fiskal 2011, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, duhet të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012, ndërsa pagesa e tatimit, sipas pikës 2 të nenit 13/6, të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012.

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 31 dhjetor të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata, për vitin 2011. Për vitet e tjera vijuese fiskale, afatet e mësipërme janë jo më vonë se data 30 prill.

Neni 39

Ligjet që shfuqizohen

1. Ligji nr. 7786, datë 27.1.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", me ndryshimet përkatëse, si dhe të gjitha aktet e tjera, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.
2. Ligji nr. 7677, date 3.3.1993, "Për tatimin mbi fitimin", me ndryshimet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat e tjera, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 40

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2008.

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2011.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.3.2012

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013.

K R Y E T A R I

Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

Ndryshuar me :

Ligjin Nr.8711, datë 15.12. 2000

Ligjin Nr.8841, datë 11.12. 2001

Ligjin Nr.8919, datë 12.12. 2002

Ligjin Nr.9161, datë 18.12. 2003

Ligjin Nr.9326, datë 06.12. 2004

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 103 datë 29 dhjetor 2004

Neni 32/3**

Ndryshuar me Fletoren Zyrtare 82 date03/11/ 2005

Shpallur me dekretin Nr. 4682 datë 01.11.2005

Ndryshuar me Ligjin Nr. 9458 datë 21.12.2005

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 105 datë Janar 2006

Ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 123 datë 27.11.2006

Ndryshuar me ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr. 54 datë 12.05.2006

Ndryshuar me ligj Nr. 9735 datë 17.05.2007, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.63, datë 04.06.2007.

Ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr. 90 datë 21.07.2007.

Ndryshuar me Ligj nr. 9804 datë 13.09.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr.125 datë 27.09.2007

Ndryshuar me Ligj nr. 9844 datë 17.12.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr.180 dhjetor 2007.

Ndryshuar me Ligj nr. 9943, date 26.6.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 114 dt. 22.6.2008.

Ndryshuar me Ligj nr.10072,datë 9.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, datë 04.03.2009.

Ndryshuar me Ligj nr.10228,datë 4.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 13, datë 25.02.2010.

Ndryshuar me Ligj nr. 10343, date 28.10.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 159, date 3 dhjetor 2010.

Ndryshuar me Ligj nr. 10364, date 16.12.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 179, dhjetor 2010.

Ndryshuar me Ligj Nr. 20/2012, date 1.3.2012, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 26, date 27 mars 2012.

Ndryshuar me Ligj nr. 71/2012, date 28.6.2012, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 89, date 31 korrik 2012.

Tabela Nr.1*

Tabela për Tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tatueshme (në muaj)	Përqindje	
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10.000	
10.001 +	30.000	+ 10% të shumës mbi 10.000 lekë
30.001 +	Më tepër	+ 10% të shumës mbi 0 lekë

PASQYRA NR. 2

ÇMIMI I SHITJES		TATIMI I PAGUESHËM
Mbi (lekë)	Në (lekë)	Përqindje
0	2 000 000	0,5 % e çmimit të shitjes
2 000 000 +	4 000 000	1 % të çmimit të shitjes
4 000 000 +	6 000 000	2 % të çmimit të shitjes
6 000 000 +	E më tepër	3 % të çmimit të shitjes

L I G J

Nr 7928 datë 27.4.1995

**PER
TATIMIN MBI VLEREN E SHTUAR
I NDRYSHUAR**

Në bazë të nenit 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

V E N D O S I :

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj vendos tatimin mbi vlerën e shtuar.
2. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet:
 - a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë
 - b. për të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

PERSONAT E TATUESHEM

Neni 2

Personat e tatueshëm

1. Personi juridik a fizik, individ ose çdo person tjetër është person i tatueshëm nëse:
 - a. detyrohet të jetë i regjistruar në bazë të këtij ligji, apo;
 - b. është i regjistruar dhe ende nuk është çregjistruar.
2. Për qëllimet e paragrafit 1 termi “person” përfshin edhe institucionet ose organizmat shtetërorë publikë kombëtarë, rajonalë a lokalë që kryejnë veprimtari ekonomike.

Neni 3*

Detyrimi për të kërkuar regjistrimin

1. Personi që nuk është i regjistruar detyrohet të kërkojë të regjistrohet:
 - a. brenda 15 ditëve nga data e fillimit të veprimtarisë së tij ekonomike, kur qarkullimi i tij që kryhet apo do të kryhet është me i madh se kufiri minimal i regjistrimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni;

b. brenda 15 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, nëqoftëse gjatë këtij viti qarkullimi rritet mbi kufirin minimal të regjistrimit, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

1/1.Shfuqizohet

2. Qarkullimi që merret parasysh përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike të kryera nga i njëjti person dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi.

3. Në qoftë se personi fillon ose ndërpret veprimtaritë e tij ekonomike gjatë një viti kalendarik, qarkullimi në lidhje me kufirin minimal të regjistrimit llogaritet në proporcion me kohezgjatjen e veprimtarive.

4. **Kufiri minimal i regjistrimit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 5 të këtij neni.**

5. Këshilli i Ministrave kur e konsideron të nevojshme rishikon kufirin minimal të regjistrimit të përcaktuar në bazë të pikës 4 të këtij neni, duke marrë parasysh inflacionin apo faktorë ekonomikë e administrative dhe zëvendëson këtë kufi minimal me një kufi të ri.

Neni 4

E drejta për të kërkuar regjistrimin

Një person që nuk është i detyruar të regjistrohet në bazë të nenit 3 dhe që si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike kryen furnizime të tatueshme, ka të drejtë të kërkojë të regjistrohet në bazë të këtij ligji.

Neni 5

Regjistrimi

1. **Personi, që kërkon të regjistrohet, detyrohet të ndjekë rrugën e përcaktuar në ligjet nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, dhe nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.**

2. **Administrata tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ka të drejtë të regjistrojë një person të tatueshëm edhe nëse ai nuk ka kërkuar të regjistrohet.**

Neni 6

Detyrimi për të njoftuar ndryshimet

Personi i tatueshëm detyrohet të njoftojë organet tatimore me shkrim brenda 15 ditëve për çdo ndryshim në emrin, adresën, veprimtarinë e tij ekonomike, ose për çdo ndryshim në informacionin e dhënë prej tij organeve tatimore, në kohën kur ka kërkuar të regjistrohet.

Neni 7**

Çregjistrimi

1. **Personi i tatueshëm i regjistruar detyrohet të kërkojë çregjistrimin jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit, kur ai ka kryer furnizime të tatueshme, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.**

2. **Personi i tatueshëm, që kërkon të çregjistrohet, u nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".**

3. **Personi i tatueshëm detyrohet të çregjistrohet, sipas këtij ligji, vetëm nëse plotëson kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.**

4. Organet tatimore refuzojnë të regjistrojnë dhe të çregjistrojnë çdo person, që nuk është as i detyruar dhe as ka të drejtë për t'u regjistruar, me efekt nga data që ky person nuk ka të drejtë të regjistrohet.
5. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një formular deklarimi, i cili përmban informacionet, që kërkohen nga organi tatimor, si dhe të bëjë pagesën përfundimtare.”.

KREU III

FURNIZIMET E MALLRAVE DHE SHERBIMEVE

Neni 8**

Furnizimi i mallrave

1. **Me furnizim mallrash kuptohet transferimi i së drejtës për të zotëruar si pronar pasurinë e luajtshme ose te paluajtshme, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Furnizimi me energji elektrike, ujë, gaz, ngrohje, ftohje ose ajër të kondicionuar është furnizim mallrash.

Neni 9**

Furnizimi i shërbimeve

1. **Me furnizim shërbimesh kuptohet çdo furnizim që nuk është furnizim mallrash, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Furnizimi i shërbimeve të bëra prej një të punësuar për punëdhënësin e tij për arsye të punësimit nuk është furnizim nga i punësuar.

Neni 10

Furnizimet e përziera

1. Furnizimi i shërbimeve i përfshirë në furnizimin e mallrave është pjesë e furnizimit të mallrave.
2. Furnizimi i mallrave i përfshirë në furnizimin e shërbimeve është pjesë e furnizimit të shërbimeve.
3. Furnizimi i shërbimeve i përfshirë në importin e mallrave është pjesë e importit të mallrave.
4. Ministri i Financave cakton me udhëzim nëse një furnizim është furnizim mallrash a furnizim shërbimesh.
5. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim nëse personi i tatueshëm, i cili prodhon mallra si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike që përdoren nga ai për qëllimet e kësaj veprimtarie, të trajtohen njëkohësisht edhe sikur ai i furnizon këto mallra si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike edhe si marrje prej tij të furnizimit për qëllimet e kësaj veprimtarie.

***** Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e shoqërive të ndërtimit, të cilat ndërtojnë për të shitur, pavarësisht nga fakti se sipërmarrësi i punimeve dhe investitori janë i njëjti person i tatueshëm. Në këtë rast furnizimi i procesit të ndërtimit është i tatueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.**

Neni 11

Furnizimi nëpërmjet agentit

1. Furnizimi i mallrave a shërbimeve, i kryer nëpërmjet një agjenti, i cili vepron në cilësinë e agentit për një person tjetër, është një furnizim prej kryesorit.
2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për furnizimin e shërbimeve të agjentit që vepron si një agjent i kryesorit të tij.

Neni 12

Transferimi i veprimtarisë ekonomike

Transferimi nga një person i tatueshëm i një veprimtarie ekonomike apo një pjese të saj, në lidhje me të cilën ai është i tatueshëm, të një person tjetër, nuk është një furnizim mallrash a shërbimesh, në qoftë se marrësi është ose bëhet person i regjistruar në bazë të këtij ligji, në lidhje me veprimtarinë ekonomike ose pjesën e saj që transferohet.

Neni 13***

Momenti i furnizimit

1. Furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Personi që kryen një furnizim të tatueshëm, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim në momentin kur mallrat janë livruar, ose kur ato bëhen të disponueshme, apo shërbimet janë kryer prej tij në lidhje me atë furnizim.
3. Kur personi që kryen një furnizim të tatueshëm arkëton pagesën më përpara se mallrat të livrohen a te bëhen të disponueshme, ose shërbimet të jenë kryer, ai është i detyruar të lëshojë një faturë për furnizimin në momentin që pagesa është arkëtuar prej tij.
4. Kur personi që kryen furnizimin e tatueshëm nuk detyrohet të lëshojë faturë, momenti i furnizimit është momenti kur mallrat dorëzohen ose bëhen të disponueshme apo shërbimet janë kryer, ose në qoftë se pagesa është arkëtuar më përpara, momenti kur pagesa është arkëtuar.
5. Për qëllimet e këtij neni, kur kryhen ose do të kryhen dy a më shumë pagesa për furnizimet e marra, atëherë çdo pagesë konsiderohet për një furnizim të veçantë, për aq sa është shuma e asaj pagese.
6. Kur shërbimet furnizohen në mënyrë të rregullt a të vazhdueshme, furnizimi i shërbimeve quhet i kryer në çdo rast për të cilin lëshohet faturë në lidhje me çdo pjesë të atij furnizimi. l**Në ndërtim fatura tatimore duhet lëshuar çdo muaj.
7. Kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qera ose shitjen me këste, pavarësisht nga momenti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-në lind mbi vlerën e plotë të mallit dhe llogaritet mbi pagesat e vlerës së plotë të kësteve për mallin e vënë në dispozicion për përdoruesin.

Neni 14

Vendi i furnizimit të mallrave

1. Vendi i furnizimit të mallrave është vendi ku mallrat livrohen ose bëhen të disponueshme nga furnizuesit. Në qoftë se livrimi a bërja të disponueshme përfshin edhe transportin e mallrave, vendi i furnizimit është vendndodhja e mallrave ku fillon transportimi, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

2. Furnizimi i energjisë elektrike, gazit, ujit, ngrohjes, ftohjes dhe ajrit të kondicionuar kryhet atje ku merret furnizimi.

Neni 15

Vendi i furnizimit të shërbimeve

1. Furnizimi i shërbimeve kryhet atje ku shërbimet jepen, përveç rasteve që në këte ligj përcaktohet ndryshe.
2. Furnizimi i shërbimeve në lidhje me pasurinë e paluajtshme kryhet atje ku gjendet pasuria e paluajtshme.
3. Furnizimi i shërbimeve të transportit apo shërbimeve që përfshihen në transport kryhen atje ku zhvillohet transporti.
4. Furnizimi i shërbimeve që nuk përfshihen në paragrafët 2 ose 3 nga personi i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri, ose në rastin e individit, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri, kryhet në vendin e veprimtarisë ekonomike a në vendin e zakonshëm të rezidencës.
5. Kur furnizimi i tatueshëm i shërbimeve që kryhen në Shqipëri furnizohet nga një person që nuk ka vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri, ose në rastin e individit, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është jashtë Shqipërisë, personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet, konsiderohet sikur ta ketë bërë furnizimin në Shqipëri si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.

Neni 16

Furnizimet e tatueshme

Me furnizim të tatueshëm kuptohet furnizimi i mallrave a shërbimeve, përveç furnizimeve të përjashtuara.

Neni 17

Veprimtaria ekonomike

1. Furnizimi është pjesë e veprimtarisë ekonomike të një personi, nëse furnizimi është kryer prej tij si pjesë e, ose e lidhur me çdo veprimtari të tij ekonomike të pavarur, kushdo qoftë qëllimi ose rezultati i saj.
2. Veprimtaritë ekonomike të një individit nuk përfshijnë veprimtaritë e kryera prej tij vetëm si pjesë e veprimtarive të tij çlodhëse ose argetuese.

Neni 18**

Furnizimi kundrejt pagesës

1. Furnizimi konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, në para a në natyrë, nëse furnizuesi direkt a indirekt merr apo ka të drejtë të marrë pagesë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.
2. Përdorimi prej një personi të tatueshëm për qëllime private të mallrave të furnizuara atij për qëllimet e veprimtarisë së tij ekonomike trajtohen si furnizim i atyre mallrave kundrejt pagesës.

**Në rastet e çregjistrimit, të gjitha mallrat e furnizuara për personin e tatueshem dhe ende në pronësi të personit të tatueshëm, për qëllimet e veprimtarisë së vet ekonomike, dhe të

gjitha mallrat gjendje të personit të tatueshëm trajtohen si furnizim i atyre mallrave kundrejt pagesës në datën e çregjistrimit.

3. Mallrat që i janë furnizuar një personi të tatueshëm për qëllimet e veprimtarisë së tij ekonomike, kur furnizohen prej tij ose u jepen për përdorim personave të tjerë kundrejt pagesës së reduktuar, trajtohen si furnizime kundrejt pagesës, përveç rasteve kur mallrat janë furnizuar a përdorur vetëm si mostra.

4. Furnizimi bëhet kundrejt pagesës së reduktuar, në qoftë se furnizuesi nuk arkëton pagesën, ose pagesa është dukshëm më e vogël se ç'duhej të ishte nëse qëllimi i furnizuesit ka qenë fitimi për këtë dhe furnizime të ngjashme.

Neni 19

Furnizimet e përjashtuara

1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar, nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9 e 26.1 të këtij ligji.
2. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim se cili prej furnizimeve të përjashtuara, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, nuk është një furnizim i përjashtuar në kushte e rrethana të përcaktuara.".

Neni 20***

Toka dhe ndërtesat

1. *** Furnizimi i tokës dhe truallit ose dhënia me qera e tyre është një furnizim i përjashtuar, përveç rasteve të shfrytëzimit për parking ose magazinim të mjeteve të transportit dhe të mjeteve të tjera lëvizëse.
2. Furnizimi i ndërtesave, përveç procesit të ndërtimit, është një furnizim i Përjashtuar.
3. **Dhënia me qira e ndërtesave është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve:**
 - a) të dhënies me qira për një periudhë jo më shumë se dy muaj;
 - b) të strehimit në hotele ose vende pushimi.

Neni 21

Shërbimet financiare

1. Furnizimi i shërbimeve financiare është furnizim i përjashtuar.
2. Për qëllimet e këtij neni me shërbime financiare kuptohet:
 - a) dhënia, negocimi dhe marrja me huatë, kreditë, garantim kredish dhe çdo sigurim për paratë, duke përfshirë edhe administrimin e huave, kredive a garantim kredish prej dhënësit;
 - b) transaksionet në lidhje me llogaritë bankare, pagesat, transferimet, borxhet, çeqet dhe instrumentet e negociueshme, përveç mbledhjes së borxhit;
 - c) transaksionet lidhur me monedhën, bankënotën dhe paranë që janë mjete të ligjshme pagesë, përveç artikujve të përdorur vetëm për koleksione;
 - ç) transaksionet lidhur me aksionet, kapitalet financiare, obligacionet dhe letra të tjera me vlerë, përveç shërbimeve për mbikqyrje;
 - d) administrimin e fondeve të investimeve;

dh) transaksionet në lidhje me kontratat për sigurimin e jetës, duke përfshirë risigurimin;
e) transaksionet në lidhje me administrimin e fondeve të pensioneve dhe sigurimet e detyrueshme shëndetësore.

Neni 22

Bankat

Furnizimi i arit, nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, si dhe i bankënotave dhe i monedhave nga Banka e Shqipërisë është furnizim I përjashtuar.

Neni 23

Shërbimet postare

Furnizimi i pullave te postës për përdorim për shërbime postare ose pulla të ngjashme është furnizim i përjashtuar.

Neni 24

Organizatat jofitimprurëse

Furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar është një furnizim i përjashtuar nëse është:

- a) furnizim shërbimesh nga organizata fetare apo filozofike, me qëllim mirëqenien shpirtërore;
- b) furnizim mallrash e shërbimesh nga organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik dhe që çmimet e mallrave dhe shërbimeve që ato furnizojnë janë dukshëm më të ulëta se çmimet e tregut. Statusi i organizatave jofitimprurëse për përfitim publik jepet me autorizim nga Ministri i Financave, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24/1

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore, publike dhe private, në përputhje me ligjet nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1 tetor 2010, është furnizim i përjashtuar.

Neni 25

Diplomatët etj.

Ministri i Financave cakton me udhëzim përjashtimin e furnizimeve për misione diplomatike e konsullore, si dhe personelin e tyre mbi bazën e reciprocitetit dhe përjashtimin e furnizimeve për organizata ndërkombëtare, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 25/1***

Operacionet hidrokarbure

Janë të perjashtuara nga TVSH:

- a) Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët e nënkontraktorët e tyre, të vërtetuar si të tillë nga **Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore**, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.
- b) Furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas nenit 26/1 të këtij ligji.
“Operacionet hidrokarbure”, për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”.

Neni 25/2

Ambalazhet dhe materialet e barnave

Furnizimi i ambalazheve dhe i materialeve, që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, është furnizim i përjashtuar.

Neni 25/3****

Shitja e librave, e gazetave, e revistave dhe shërbimet e reklamave në to

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat, furnizimi i gazetave, i revistave dhe i librave të çdo lloji, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike.

Neni 25/5

1. Furnizimi falas, si ndihme për situatat e përcaktuara, sipas ligjit nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, është furnizim i përjashtuar.
3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë rregullat për rastet e përjashtimit të ndihmave që jepen në rastin e emergjencave civile.

Neni 25/6*

1. Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t’u riekportuar për personat e tatueshem të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, është furnizim i përjashtuar.
4. Ministri i Financave përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm, për zbatimin e përjashtimit.

Neni 25/7****

Furnizimet e shërbimeve të lojrave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Neni 25.8

Furnizimi i kartave të identitetit është furnizim i përjashtuar.

Neni 25/9

Sherbimet nderkombetare

Furnizimi i shërbimeve të bëra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri, ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri, është furnizim i përjashtuar.

Neni 26***

Importimi i mallrave

1. Për qëllimet e këtij ligji “importimi i mallrave” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7609, datë 22.9.1992 “Per tarifate doganore” dhe importimi i tyre quhet i kryer në momentin e parashikuar në atë ligj, edhe nëqoftëse mallrat e importuara janë apo jo të përjashtuara nga taksat doganore nga ai ligj.

2. TVSH llogaritet, zbatohet dhe paguhet në importimin e mallrave sikur TVSH i pagueshëm është taksë doganore e përcaktuar nga ligji nr. 7609, datë 22.9.1992 “Për tarifate doganore”.

2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj. Për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë, në çastin e importit.

Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret dhe procedurat, që do të ndiqen për shtyrjen e TVSH-së, në rastin kur zgjatja e ciklit të investimit dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më e gjatë se 12 muaj, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

2.2. **Për importimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a. të zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës të TVSH-së, sipas skemës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përcaktohet mbi bazën e ligjit nr. 7609, datë 22.9.1992 “Për tarifate doganore”, edhe nëqoftëse mallrat e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore në bazë të atij ligji.

4. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu, nëse nuk janë përfshirë sipas paragrafit 3:

a) shpenzimet e transportit e te sigurimit dhe shpenzimet e tjera, te perfshira ne importimin e mallrave dhe levrimin e tyre, deri ne momentin e çastin e hyrjes ne territorin e Republikes se Shqiperise;

b) tarifate, taksat dhe detyrime të pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre mallrave nga shtete prej të cilave ato eksportohen apo të pagueshme si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH të pagueshëm që nuk përfshihet në bazë të këtij ligji.

5. Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet sipas pikave 3 e 4 më lart, pa përfshirë vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit të përdorur si lëndë e parë përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

6. Operatorët e telefonisë celulare do të vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të gjitha kartat SIM dhe numrat IMEI të aparateve celulare, që janë në përdorim në datën 1 tetor 2007. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, duke filluar nga data 1 tetor 2007, operatorët e telefonisë celulare do të ofrojnë shërbimet e tyre vetëm për numrat IMEI të aparateve celulare, për të cilat importuesit apo zotëruesit e tyre kanë ndjekur procedurën e mëposhtme:

a) importuesit e aparateve telefonike celulare, në çastin e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve fiskale pranë shërbimit doganor, duhet të deklarojnë edhe listën e numrave IMEI të aparateve të importuara;

b) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, të vendosur në ligj, ndjekin të njëjtën procedurë si në shkrinjën “a” të kësaj pike;

c) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është nën minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë pranë shërbimit doganor një deklaratë individuale për numrin IMEI të aparatit telefonik celular.

Shërbimi doganor njofton zyrtarisht operatorët e telefonisë celulare për numrat IMEI, të deklaruar nga importuesit dhe individët, në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike. Forma e deklarimit të numrave IMEI nga importuesit dhe individët përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 26/1

Furnizimet e përjashtuara në import

Është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja:

a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat, brenda vendit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

b) importimi i mallrave të vendosura në regjimin e tranzitit;

c) importimi i mallrave të deklaruara për të qenë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv;

ç) importimi i mallrave dhe i shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

"Operacione hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet", të ndryshuar;

d) importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm;
dh) importimi i mallrave nga NATO-ja dhe organizmat e saj, në kuadër të operacioneve, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

e) Shfuqizohet

ë) importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

f) importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

KREU IV

VLERA E TATUESHME DHE SHKALLA TATIMORE

Neni 27

Vlera e tatueshme

1. Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm është shuma totale e paguar për atë furnizim, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Vlera e tatueshme e furnizimit të mallrave në nenin 18, pika 2 ose 3 është pagesa totale që duhet të ishte e pagueshme në lidhje me atë furnizim nëse qëllimi i furnizuesit është nxjerrja e fitimit ndaj atij dhe furnizimeve të ngjashme.

Neni 27/1****

Vlera minimale e tatueshme

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.

Neni 27/2

Furnizimi i arit të përpunuar

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, nuk përfshin vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit, të përdorur si lëndë e parë, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 28

Detyrimet mbi furnizimet

1. Vlera e tatueshme e furnizimit përfshin tarifat, tatimet dhe detyrimet e pagueshme si rezultat i furnizimit përveç TVSH të pagueshëm për këtë furnizim në bazë të këtij ligji.
2. Personi që kryen furnizime të tatueshme detyrohet të njoftojë në mënyrë të dukshme nëpërmjet shpalljes, kontratës a reklamës nëse çmimi i mallrave ose i shërbimeve për t'u furnizuar ose çmimi që duhet të paguhet për furnizimin përfshin apo nuk e përfshin TVSH-në, përveç rasteve që Ministri i Financave në udhëzim ka të drejtë ta përcaktojë ndryshe.
3. Në rast se furnizimi i tatueshëm kryhet pa një shumë të ndarë e të identifikuar si një pagesë e TVSH-së, vlera e tatueshme e tij është shuma që, së bashku me TVSH të

paguëshëm mbi këtë shumë në bazë të këtij ligji, është e barabartë me pagesën që i bëhet furnizuesit.

4. Për mallrat, të cilat pesojnë humbje gjate tranzitimit, magazinimit dhe prodhimit, siç percaktohet ne akte te veçanta ligjore dhe nenligjore, nuk llogaritet dhe nuk paguhet TVSH-ja.

Neni 29

Saktësimet

1. Kur ka rritje ose ulje në pagesën totale të bërë për furnizimin, atëherë saktësohet përkatësisht vlera e tatueshme e furnizimit.
2. Kur pagesa për një furnizim reduktohet nga një ulje në momentin e furnizimit atëherë reduktohet përkatësisht vlera e tatueshme e furnizimit.
3. Kur pagesa për furnizimin reduktohet nga një ulje për pagesë të menjëherëshme atëherë reduktohet përkatësisht vlera e tatueshme e furnizimit.

Neni 30

Shkalla tatimore

1. TVSH-ja zbatohet në masën 20 për qind, përveç rasteve kur në këtë ligj percaktohet ndryshe.
2. Furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i tatueshëm, me shkallën tatimore 10 për qind.

Neni 31

Eksporti dhe transporti ndërkombëtar

TVSH-ja zbatohet në masën zero për qind:

1. Për mallrat, që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve dhe furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me të. Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kanë të drejtë të caktojnë me udhëzim të përbashkët cilat janë furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.
3. Për furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det.

Neni 32

Tatimi i paguëshëm

TVSH i paguëshëm nga një person i tatueshëm për një periudhë tatimore është diferenca ndërmjet:

- a) TVSH të zbatuar për periudhën tatimore mbi vlerën totale të tatueshme të të gjitha furnizimeve të tatueshme të bëra gjatë periudhës nga ky person, minus
- b) çdo kreditim tatimi të lejuar për këtë person për atë periudhë.

Neni 33

Kreditimi i tatimit

1. Kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është:
 - a) totali i TVSH i zbatuar në lidhje me:
 - (i) të gjitha furnizimet e tatueshme të bëra për personin e tatueshëm gjatë periudhës tatimore nga persona të tjerë të tatueshëm;
 - (ii) të gjitha importet e mallrave të bëra nga personi i tatueshëm gjatë periudhës tatimore kur këto furnizime a importime janë bërë për qëllimet e furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t’u bërë nga personi i tatueshëm;
 - b) çdo kreditim i tatimit i lejuar në bazë të nenit 34, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Kreditimi i tatimit nuk lejohet në asnjë rrethanë për shpenzime që nuk janë tërësisht vetëm për qëllime të veprimtarisë ekonomike.
3. Një person i tatueshëm nuk ka të drejtë të kërkojë kreditim tatimi në bazë të këtij neni, nëqoftëse ai nuk zotëron një faturë që tregon shumën e kreditimit të kërkuar, ose të kërkojë kreditim tatimi në bazë të nenit 34 nëse ai nuk zotëron dokumente që vërtetojnë se borxhi është një borxh i keq.
4. Ministri i Financave cakton me udhëzim lejimin e kreditimit të tatimit për një person të tatueshëm për sa i përket një pjese të TVSH të paguar prej tij, në lidhje me furnizime të tatueshme dhe importime mallrash të kryera prej tij pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra a për t’u bërë prej tij dhe pjesërisht për qëllime të tjera.
5. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë në udhëzim që kreditimi i tatimit nuk lejohet në lidhje me ndonjë lloj furnizimi të tatueshëm apo importimi.

Neni 34

Borxhet e këqija

1. Kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të tatueshëm prej furnizuesit dhe është një borxh i keq, lejohet kreditimi i tatimit në bazë të këtij neni.
2. Shuma e kreditimit të tatimit është sa TVSH e zbatuar në bazë të nenit 30 të këtij ligji, në lidhje me furnizimin që përputhet me shumën e paarkëtuar të borxhit të keq.
3. Kreditimi i tatimit lejohet në çdo periudhë tatimore mbasi borxhi bëhet borxh i keq dhe fillon të paktën gjashtë muaj pas mbylljes së periudhës tatimore, për të cilën TVSH ishte zbatuar në lidhje me furnizimin.
4. Kur kreditimi është lejuar për borxhin e keq dhe plotësisht apo pjesërisht ky borxh paguhet më vonë, shumën e arkëtuar trajtohet si një saktësim në bazë të nenit 29 të këtij ligji.

KREU V

ADMINISTRIMI DHE PROCEDURA

Neni 35

Administrimi dhe procedurat në përgjithësi

1. Ministri i Financave është përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

2. Administrata tatimore dhe administrata doganore janë të vetmet organe që kanë përgjegjesi të zbatojnë këtë ligj. Ato raportojnë tek Ministri i Financave.
3. Për zbatimin e këtij ligji Ministri i Financave nxjerr udhëzimet përkatëse.

Neni 36**

Faturat

1. Personi i tatueshëm që kryen furnizimin, është i detyruar të lëshojë për personin që merr furnizimin një faturë në lidhje me atë furnizim, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
 - 1/1. Në fund të faturës shënohet blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim, transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe shitësi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë.
2. Për qëllimet e këtij ligji fatura përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban:
 - a) emrin, adresën, NIPT-in dhe kodin fiskal të personit që bën furnizimin;
 - b) emrin, adresën dhe NIPT-in, së bashku me kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm për TVSH, emrin, adresën dhe kodin fiskal për blerësin person I tatueshëm I biznesit të vogël dhe vetëm emrin e adresën për blerësit persona të tjerë;
 - b/1) emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targen e mjetit dhe oren e furnizimit;
 - c) datën në të cilën lëshohet fatura;
 - d) numrin e serisë së vendosur nga shtypshkronja që e ka shtypur;
 - e) numrin rendor;
 - f) përshkrimin e çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar;
 - g) sasinë e mallrave apo madhësinë e shërbimeve të furnizuara;
 - h) çmimin për njësi, pa TVSH-në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar;
 - i) shumën e pagueshme pa TVSH-në;
 - j) përqindjen e TVSH-së së pagueshme ndaj çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar;
 - k) shumën e TVSH-së së pagueshme;
 - l) shumën e pagueshme me TVSH;
 - m) çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga Ministri I Financave
3. Kur bëhet ndonjë saktësim në pagesën e kryer për një furnizim pasi fatura të jetë lëshuar për të, personi që bën furnizimin lëshon një faturë tjetër ose një notë kreditimi në formën e kërkuar nga ky në lidhje me atë saktësim.
4. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim se shitësi me pakicë plotëson detyrimet e këtij neni, duke lëshuar një faturë a notë kreditimi (duke përfshirë kuponat), në formën dhe në rrethanat që parashikohen.
5. Kur një person që nuk është i regjistruar lëshon faturë në formën e parashikuar në këtë ligj ose ndryshe, lë të kuptohet se zbaton TVSH ndaj ndonjë furnizimi, i nënshtrohet dënimit.
6. Kur një person lëshon faturë siç parashikohet në paragrafin 5, organet tatimore ngarkohen të arkëtojnë TVSH të shënuar në atë faturë, së bashku me çdo gjobë për dënimin e vendosur në bazë të atij paragrafi.
7. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka të drejtë të lejojë mospërdorimin e faturave tatimore me numër serial të pashtypur në rastet kur personi i tatueshëm I regjistruar mund të tregojë, me kërkesë të organeve tatimore, që sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial për çdo transaksion të tatueshëm dhe që ka një numër të konsiderueshëm klientësh konsumatorë final.

8. Shfuqizohet.

Neni 37

Deklaratat për periudhat tatimore

1. Çdo person i tatueshem detyrohet:
 - a) të bëjë një deklaratë, në bazë të nenit 32 të këtij ligji, për çdo periudhë tatimore jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore me të cilën ajo lidhet;
 - b) të paguajë TVSH për atë periudhë, në ose para datës së detyrueshme të deklaratës.
2. Deklarata e bërë sipas pikës 1 bëhet në atë formë dhe përmban atë informacion siç përcaktohet nga Ministri i Financave.

Neni 38

Periudhat tatimore

1. Periudha tatimore është muaji kalendarik, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Për një person të tatueshëm që regjistrohet fillimisht, periudha tatimore fillon në ditën kur Çertifikata e Regjistrimit shënon se regjistrimi hyn në fuqi dhe përfundon në ditën e fundit të atij muaji.
3. Për një person të tatueshëm që çregjistrohet, periudha tatimore fillon në ditën e parë të muajit përkatës dhe përfundon në ditën në të cilën personi është çregjistruar.
4. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim që, për ndonjë kategori personash të tatueshëm, periudha tatimore është më e gjatë apo më e shkurtër se një muaj.

Neni 39

Deklarime të tjera

Organet tatimore kanë të drejtë të detyrojnë një person të tatueshëm të bëjë deklaramë të tjera, si shtesë e deklaratave për periudhat tatimore, në formën dhe kohën e kërkuar prej tyre.

Neni 40

Detyrimi për të mbajtur regjistrime

1. Cdo person i tatueshëm detyrohet të mbajë llogari, duke përfshirë regjistra për të gjitha furnizimet e kryera prej tij, të gjitha furnizimet e bëra atij dhe të gjitha importet e mallrave të kryera prej tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike **në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar**. Regjistrimet e mbajtura në bazë të paragrafit 1 përfshijnë të gjitha faturat e lëshuara për personin e tatueshëm në lidhje me furnizimet e tatueshme të bëra atij.
2. Ministri i Financave ka të drejtë të parashikojë që, regjistrimet e mbajtura në bazë të paragrafit 1 të regjistrohen në kompjuter ose si të dhëna elektronike.
3. Regjistrimet e mbajtura në bazë të paragrafit 1 ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh.
4. Organet tatimore kanë të drejtë të detyrojnë një person të tatueshëm, duke e njoftuar atë:
 - a) të paraqesë regjistrimet e mbajtura në bazë të paragrafit 1;
 - b) dhe nëse regjistrimet janë mbajtur në kompjuter a si të dhëna elektronike, t'u lejojnë atyre hyrjen në kompjuter ku regjistrimet janë mbajtur dhe hyrjen në kompjuter a pajisje të tjera për të inspektuar regjistrimet e mbajtura si të dhëna elektronike.

Neni 41

Vlerësimet tatimore

1. Administrata tatimore ka të drejtë të bëjë një vlerësim tatimor të shumës së TVSH-së kur:

a) personi nuk bën deklarin nga ajo periudhë kohe apo në formën, që përcaktohet në këtë ligj;

b) personi kërkon që shuma e TVSH-së, e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë, të ndryshojë, për arsye të një gabimi a mangësie;

c) çmon se shuma e TVSH-së, e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë të bërë nga një person i tatueshëm, është më e vogël se shuma që duhej të ishte pasqyruar si e pagueshme;

ç) personi ka qenë i çregjistruar, për shkaqet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, me efekte nga data në të cilën ishte regjistruar;

d) personi duhej të arkëtonte një shumë TVSH-je për një faturë, në përputhje me pikën 6 të nenit 36 të këtij ligji;

dh) çmon se, për ndonjë arsye, shuma e TVSH-së, edhe pse është e pagueshme, nuk është paguar.

2. Administrata tatimore njofton me shkrim personin e tatueshëm për vlerësimin tatimor, duke i dërguar bashkëlidhur edhe kërkesën për të paguar detyrimin tatimor, TVSH-në e pagueshme, kamatëvonesat, si dhe gjokat, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 69 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Personi i tatueshëm detyrohet ta paguajë detyrimin tatimor, të vlerësuar sipas vlerësimit tatimor, të kryer në bazë të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga data kur personi ka marrë apo vlerësohet ta ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë.”.

Neni 42

Ankimi administrativ tatimor

Çdo person, ndaj të cilit është bërë një vlerësim tatimor për TVSH-në, në përputhje me nenin 41 të këtij ligji dhe, për pasojë, organi tatimor ka nxjerrë njoftim për këtë vlerësim, nëse nuk është dakord, ka të drejtë të paraqesë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, sipas afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 106 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ndjekë procedurat e apelimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 43*

E drejta e ankimit SHFUQIZOHET

Neni 44

Afatet kohore

Organet tatimore nuk kanë të drejtë të bëjnë një vlerësim tatimor mbas 5 vjetësh pasi ka përfunduar periudha tatimore me të cilën ai lidhet, përveç rasteve kur ky vlerësim tatimor bëhet vetëm për të zbatuar një rishqyrtim ose ankim kundër vlerësimit tatimor të kryer brenda këtij afati kohor.

Neni 45

Vlefshmëria e vlerësimit tatimor

1. Vlefshmëria e vlerësimit tatimor nuk diskutohet nga çdo lloj procedurë, përveçse nëpërmjet rishqyrtimit dhe ankimit në bazë të këtij ligji.
2. Vlefshmëria e rishqyrtimit nuk diskutohet nga çdo lloj procedurë, përveçse nëpërmjet ankimit në bazë të këtij ligji.
3. Të gjitha vlerësimet tatimore dhe të gjitha informacionet e përfshira në vlerësimin tatimor, gjykohe të jenë përfundimisht të sakta, përderisa këto vlerësime të mos ndryshohen ose anulohen në përshtatje me rishqyrtimin e ankimin në bazë të këtij ligji.

Neni 46

Informacioni

Organet tatimore kanë të drejtë të detyrojnë:

- a) personin e tatueshëm apo drejtorin, nëpunësin, përfaqësuesin tatimor apo agjentin e atij personi;
 - b) çdo person të cilin organet tatimore e gjykojnë se duhet të jetë person i tatueshëm apo drejtorin, nëpunësin, përfaqësuesin tatimor apo agjentin e atij personi;
 - c) çdo person i cili importon apo eksporton mallra ose ka lidhje me importimin apo eksportimin e atyre mallrave apo drejtorin, nëpunësin, përfaqësuesin tatimor apo agjentin e atij personi;
 - ç) çdo person tjetër i cili është ose mund të jetë në lidhje me personin e përmendur në paragrafët (a), (b) dhe (c);
- t'u paraqesin organeve tatimore informacion në lidhje me çdo furnizim mallrash apo shërbimesh sipas kërkesës së organeve tatimore dhe të japin çdo dokument apo regjistrim elektronik të dhënash në zotërim të tyre në lidhje me furnizimin.

Neni 47**

E drejta e hyrjes dhe inspektimit

1. **Personi i autorizuar nga organi tatimore ka të drejtë të hyjë dhe të kërkojë në çdo vend që përfshin tokë, ndërtesë, automjet, anije etj., kur ai ka arsye për të besuar që mallrat ose dokumentet e përdorura prej personit të tatueshëm, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, mbahen atje.
2. Personi që kërkon të hyjë në ndonjë tokë apo ndërtesë në bazë të këtij neni, nuk mund ta bëjë atë, përderisa:
 - a) ai nuk paraqet, sipas kërkesës së personit në atë tokë a ndërtesë, autorizimin me shkrim për të hyrë;
 - b) ai nuk përshtatet me çdo detyrim tjetër të përcaktuar nga Ministri i Financave.
3. Personi që hyn në tokat a ndërtesat në bazë të pikës 1, inspekton ato toka e ndërtesa si dhe çdo dokument e mallra në atë tokë a në atë ndërtesë.
4. Personi që hyn në ndonjë tokë a ndërtesë në bazë të pikës 1, mund të inspektojë dhe të marrë kopje të çdo llogarie, regjistrimi a dokumenti.

5. Personi që hyn në një ndërtesë në bazë të pikës 1, inspekton dhe kontrollon operimet e çdo kompjuteri, arkave regjistruese a pajisjeve të tjera në atë ndërtesë dhe mund të marrë kopjet e çdo llogarie, regjistrimi apo informacion tjetër në ato pajisje.

6. Ministri i Financave nxjerr udhëzime për autorizimin e personave për parashikimin në të gjitha rastet të kompetencave me shkrim dhe për kushtet në të cilat përdoren kompetencat nga personat e autorizuar në bazë të këtij neni.

Neni 48

Pagesa e TVSH

1. Pagesa e TVSH-së bëhet nga personi i tatueshëm për organet tatimore a mënyra të tjera, siç përcaktohet nga Ministri i Financave në udhëzim.
2. Personi i tatueshëm shoqëron çdo deklaratë të bërë prej tij në përshtatje me nenin 37 me:
 - a) pagesën e detyruar të TVSH-së;
 - b) ose dokumentin e pagesës së detyruar të TVSH-së nga data e detyruar.

Neni 49*

Kamatëvonesat

1. Kur personi i tatueshëm nuk paguan shumën e plotë të detyruar të TVSH-së në bazë të këtij ligji në datën në të cilën ajo është e detyruar, paguhen **kamatëvonesat** mbi shumën e papaguar të TVSH-së nga data në të cilën ajo ka qenë e detyruar të paguajë deri në datën në të cilën ajo paguhet.
2. Shfuqizohet
3. **Kamatëvonesat** e pagueshme në bazë të paragrafit 1 bëhen detyruesisht në fund të muajit kalendarik në të cilin ato krijohen.
4. **Kamatëvonesat** e pagueshme në bazë të këtij paragrafi janë njëlloj të detyrueshme dhe nxirren sikur të ishin TVSH i pagueshëm në bazë të këtij ligji.

Neni 50*

Rimbursimet

1. Nëse kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është me i madh se TVSH i zbatuar për atë periudhë, personi i tatueshëm ka të drejtën të mbartë shumën e mbetur si kreditim tatimor për periudhën pasardhëse tatimore në bazë të nenit 32.
2. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor kur:
 - a) Personi i tatueshëm ka mbartur një shumë të kreditimit tatimor për 3 muaj radhazi, në bazë të pikës 1 të këtij neni.
 - b) rimbursimi i kërkuar tejkalon shumën prej 400 000 lekë.
3. Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi Popullor ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimbursohet financuesve të huaj nga administrata tatimore brenda 45 ditëve, sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Financave. **Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes**
4. Eksportuesit kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400.000 (katërqindmijë) lekë.

Organet tatimore bëjnë rimbursimin e tepicës kreditore të TVSH-së për këtë kategori tatimpaguesish, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Këshilli i Ministrave përcakton kategorinë e eksportuesve të përmendur në pikën 4 të këtij neni.

(Pikat 4 dhe 5 hyjnë në fuqi më 19.01.2001, shënim i DPT.)

Neni 51

Kompetencat për të detyruar garancinë

Organet tatimore, para se të bëjnë një rimbursim të kreditimit tatimor për një person të tatueshëm kanë të drejtë ta detyrojnë atë person të paraqesë një garanci për pagesën e ardhshme të TVSH-së prej tij.

Neni 52

Rimbursimet, si pasojë e ankimit administrativ tatimor

Kur një vlerësim tatimor, në bazë të një ankimi administrativ tatimor, ulet apo anulohet, organet tatimore rimbursojnë personin, ndaj të cilit ishte bërë ky vlerësim tatimor, për të gjithë shumën e TVSH-së së paguar më tepër, sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Neni 53*

Kamatëvonesat për rimbursimin

a) SHFUQIZOHET

b) Kur organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në perputhje me nenin 50, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, **në njërin nga format e përcaktuara në nenin 75 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, detyrohen të paguajnë kamatëvonesat e përcaktuara në nenin 76 të po këtij ligji.**

Neni 54****

Nxjerrja e tatimit të papaguar

**** Nëse TVSH-ja e detyruar në mbështetje të këtij ligji, nuk është paguar deri në datën, në të cilën ai është e detyrueshme, organet tatimore kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të nxjerrë me forcë TVSH-në e detyruar, së bashku me interesat apo gjokat e vëna, **ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”**

Neni 55

Përfaqesuesit tatimorë

1. Kur një person është person i tatueshëm për qëllimet e këtij ligji, por nuk ka një vend të veprimtarisë ekonomike, apo në rastin e një individi një vend të zakonshëm të rezidencës në Shqipëri, Ministria e Financave ka të drejtë t'i kërkojë atij të emëroje një person tjetër si përfaqesuesin e tij tatimor.

2. Një person emërohet si përfaqësues tatimor vetëm në qoftë se ai ka një vend të veprimtarisë ekonomike ose në rastin e një individi vendin e zakonshëm të rezidences në Shqipëri.

3. Një person i emëruar si përfaqësues tatimor është personalisht përgjegjës, në bazë të këtij ligji, për të përmbushur të gjitha detyrimet, duke përfshirë çdo gjorbë a dënim, për të cilat kryesori i tij detyrohet dhe merr të gjitha të drejtat e kryesorit të tij sipas këtij ligji.

4. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet për to paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit.

Neni 56

Përfaqësuesi Personal

Kur një person i tatueshëm vdes, bëhet i paaftë, falimenton, shkon në likuidim a shpërndarje, çdo person që vazhdon veprimtarinë ekonomike trajtohet si një person i tatueshëm.

Neni 57

K undërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi vleren e shtuar, që perbejne kundervajtje administrative dhe denimet perkatese percaktohen ne ligjin nr.9920 , date 19.5.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

KREU VI

RASTE TE TJERA

Neni 58

Biznesi i vogël etj.

Ministri i Financave përcakton në udhëzim skemat e veçanta për personat e tatueshëm të biznesit të vogël ose kategori të veçanta të biznesit, apo për persona të tatueshëm të cilët bëjnë furnizime mallrash a kategori të veçanta mallrash, të furnizuara atyre nga persona të tjerë, përveç personave të tatueshëm.

Neni 58.1

Skema e kompensimit të fermerëve

1. Për fermerët, të cilët, në kuadër të veprimtarisë së tyre, në njërin nga fushat e prodhimit bujqësor e blegtoral, furnizojnë me këto produkte një person të tatueshëm, sipas kuptimit të këtij ligji, zbatohet skema e kompensimit të akorduar. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë e blegtorinë, përcakton me udhëzim listën e produkteve të përfshira në këtë skemë.

2. Kompensimi i akorduar i paguhet shitësit fermer nga blerësi, person i tatueshëm, përkundrejt furnizimeve të kryera.

3. Kompensimi i akorduar është i barabartë me produktin e përqindjes fiks të kompensimit me vlerën e furnizimit dhe llogaritet, për çdo furnizim të fermerit, për personin e tatueshëm. Kompensimi mbulon një pjesë të TVSH-së së paguar prej fermerëve, të përfshirë në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, që u janë furnizuar atyre, për nevoja të veprimtarisë së ekonomike, bujqësore e blektorale.

Neni 58.2

Përqindja e kompensimit

Kompensimi është në masën 6 për qind.

Neni 58.3

Detyrime të fermerit

Fermerët përfitojnë të drejtën e kompensimit kur :

- a) nuk janë regjistruar dhe nuk detyrohen të regjistrohen si persona të tatueshëm, sipas këtij ligji;
- b) bëjnë furnizimin me mallra, me prejardhje nga puna e tyre, kryer në njërin nga fushat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 58.1 të këtij ligji;
- c) mallrat, ua furnizojnë të tretëve, persona të tatueshëm ;
- ç) janë pajisur me një kod personal, të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 58.4

Detyrime të personit të tatueshëm

1. Blerësi, person i tatueshëm, lëshon një faturë tatimore për shitësin fermer, për çdo furnizim të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi, për llogari të shitësit fermer, mbi të cilën zbatohet përqindja fikse e kompensimit.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 36 të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit.

Në krye të saj vendoset shënimi “Faturë e lëshuar nga blerësi” dhe në të duhet të shënohen këto të dhëna :

- a) emri, adresa, NIPT-i i personit të tatueshëm blerës;
- b) emri, mbiemri, adresa, kodi personal i fermerit shitës.
- c) datën në të cilën lëshohet fatura;
- ç) përshkrimi i çdo lloj malli të furnizuar;
- d) sasia e mallrave të furnizuara;
- dh) çmimi për njësi i çdo lloj malli të furnizuar;
- e) vlera e furnizimit;
- ë) përqindja e kompensimit të paguar;
- f) shuma e kompensimit të paguar;
- g) vlera e përgjithshme e paguar për atë furnizim.

3. Kompensimi, që personi i tatueshëm blerës, i ka paguar shitësit fermer, vlerësohet si TVSH-ja e kreditueshme për personin e tatueshëm, sipas kushteve të nenit 33 të ligjit dhe deklarohet në periudhën tatimore, kur është lëshuar fatura.

4. Në qoftë se fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë një dënim të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

KREU VII

DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

Neni 59

Regjistrimi gjatë periudhës tranzitore

Çdo person i tatueshëm regjistrohet në bazë të nenit 5 me efekt nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kërkon të regjistrohet në bazë të nenit 3 jo më vonë se një muaj para datës së hyrjes në fuqi të TVSH-së.

Çdo person ka të drejtë të regjistrohet në bazë të nenit 4 me efekt nga data e hyrjes në fuqi të TVSH-së, ka të drejtë të kerkojë të regjistrohet në përshtatje me nenin 3 në çdo kohë pas fillimit të periudhës së regjistrimit.

Fillimi i periudhës së regjistrimit caktohet nga Ministri i Financave.

Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimeve për mallrat e importuara ose të blear para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që rezultojnë gjendje deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 60

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë. Zbatimi i TVSH-së dhe zëvendësimi i tatimit mbi qarkullimin fillon në tremujorin e 4-t të vitit 1995. Këshilli i Ministrave cakton datën e zbatimit të këtij tatimi. Me fillimin e zbatimit të TVSH-së, ligji Nr. 7676 datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi qarkullimin”, si dhe çdo dispozitë tjetër e lidhur me të shfuqizohet.

ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2008.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

Ndryshuar me ligjet:

Ligji nr. 8126, datë 09.07.1996

Ligji nr. 8130, datë 22.07.1996

Ligji nr. 8149, datë 11.09.1996

Ligji nr.8070, datë 15.02.1997

Ligji nr. 8186, datë 23.01.1997

Ligji nr. 8201, datë 20.03.1997

Ligj Nr.7928, date 27.04.1995, “Per Tatimin mbi vleren e shtuar”

Ligji nr. 8240, datë 16.09.1997

Ligji nr. 8445, datë 21.01.1999

Ligji nr. 8505, datë 07.07.1999

Ligji nr. 8714, datë 15.12.2000

Ligji nr. 8779, datë 26.04.2001

Ligji nr. 8845, datë 11.12.2001

Ligji nr. 8963, datë 24.10.2002

Ligji nr. 9162, datë 18.12.2003

Ligji nr. 9332, datë 06.12.2004

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 103 datë 29 dhjetor 2004.

Ligji 9454, datë 21.12.2005 Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.105 Datë Janar 2006

Ligji Nr. 9597, datë 27.07.2006 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 84 datë 09.09. 2006.

Ligji Nr.9674, datë 29.12.2006 botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151 datë 19.01.2007.

Ndryshuar me Ligj Nr. 9712 datë 16.04.2007, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.54 datë 12.05.2007.

Ndryshuar me Ligj Nr.9848, datë 17.12.2007, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.180 Dhjetor 2007.

Ndryshuar me Ligj Nr.9856, datë 26.12.2007, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, Datë 21.01.2008

Ndryshuar me Ligj Nr.9944, datë 26.06.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 114, Datë 22.07.2008

Ndryshuar me Ligj 10 003 datë 06.10.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 164 datë 22.10.2008

Ndryshuar me Ligj Nr. 10 068, datë 2.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 17 datë 27.02.2009

Ndryshuar me Ligj Nr. 10144, date 28.9.2009, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 144, date 12.10.2009.

Ndryshuar me Ligj Nr. 10215, date 21.01.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 8, date 12.02.2010

Ndryshuar me Ligj Nr. 10363, date 16.12.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.181, dhjetor 2010.

LIGJ
Nr. 8976, Datë 12.12 2002

PËR
AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
I NDRYSHUAR

Mbështetur në Nenet 78 pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

K R E U I

Neni 1

Objekti

Ky Ligj rregullon marrëdhëniet juridike, që kanë të bëjnë me përcaktimin e akcizave, të kushteve, procedurave, të drejtave dhe detyrimeve që u nënshtrohen subjektet e akcizes, si dhe çeshtjet që lidhen me rregullat për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga organet tatimore për mallrat, subjekt i akcizës.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Alkool” është alkooli etilik i klasifikuar, sipas kodit N.K.22.07 dhe 22.08;
2. “Akciza” është tatimi i vendosur nga ky ligj mbi mallrat e përcaktuara në shtojcën 1 të këtij ligji.
3. “Aparat distilimi” është impianti në të cilin zhvillohet procesi i distilimit, përfshirë të gjitha pjesët e distilimit, siç janë ftohtësi dhe ena pritëse e produktit të gatshëm.
4. “Artikuj të përpunuar duhani” janë cigare, puro dhe të tjera lloje produktesh duhani të përpunuara, që janë të gatshme për konsum.
5. “Autorizim akcize” është autorizimi i lëshuar nga organet tatimore një tatimpaguesi akcize.
6. “Birrë” është çdo produkt që përfshihet në kodin N.K.22.03 ose çdo produkt tjetër, që përmban një përzierje të birrës me pije joalkoolike, që tejkalon 0.5 për qind në vëllim.
7. “Cigare” është çdo role duhani, që mund të pihet siç është dhe që nuk përfshihet në përkufizimin e puros.

8. “Depo të nënprodukteve të naftës” janë trualli, ndërtesës, depozitat për ruajtje ose mjedise të tjera, të miratuara sipas nenit 5 të këtij ligji, si magazina tatimore për ruajtjen e nënprodukteve të naftës, të paambalazuara, të prodhuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. “Eksport” është largimi i mallrave të akcizës për konsum jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
10. “Fshehje e qëllimshme” janë veprimet ose mosveprimet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, me qëllim që të mos paguajë detyrime ose të paguajë më pak sesa është i detyruar ose të paguajë detyrime ose të paguajë më pak sesa është i detyruar ose për të kërkuar më shumë kreditim ose rimbursim të akcizës.
11. “Garanci e miratuar” është garancia financiare e ofruar për detyrimin tatimor nga një person i autorizuar, që lidhet me çfarëdo lloj sasive mallrash të akcizës, të mbajtura në pezullim tatimor.
12. “Gaz i lëngëzuar i naftës (GNL)” është gazi i mbajtur nën tryzni në formë të lëngëzuar, klasifikuar sipas kodit N.K.27.11.12 deri 27.11.19.00.
13. “Kodi N.K.” është klasifikimi i mallrave të nomeklaturës së kombinuar të mallrave, bazuar në sistemin e harmonizuar.
14. “Lëndë djegëse” janë nënproduktet e naftës, të klasifikuara sipas pikës 4 të nenit 38 dhe seksionit V të shtojcës 1 të këtij ligji.
15. “Magazinë tatimore” është truall, ndërtesë ose mjedis tjetër, i miratuar sipas dispozitave të këtij ligji, në të cilin mallrat subjekt i akcizës prodhohen ose mbahen në kushtet e regjimit të pezullimit tatimor gjatë veprimtarisë ekonomike të një personi të autorizuar.
16. “Mallra akcize” janë mallrat që janë subjekt i pagesës së akcizës.
17. “Nënprodukte naftë” janë produktet që përfshihen brenda kodit N.K. të përshkruara në seksionin V të shtojcës 1.
18. “Ngarkesa tregtare” janë mallrat e akcizës të paambalazuara, të cilat kërkojnë përpunim të mëtejshëm para se të jenë produkt i gatshëm për shitje me pakicë.
19. “Njësi ambalazhimi” është çdo paketë, kuti, shishe, kanoçe ose enë, me kapacitet mbajtës deri në 5 litra ose më pak.
20. “Paketë” është çdo paketë ose kuti me një kapacitet të tillë, të aftë për të mbajtur 20 cigare.
21. “Person” është çdo person fizik ose juridik, që u nënshtrohet dispozitave të këtij ligji.
22. “Pije alkoolike” janë pijet e klasifikuara sipa kodeve N.K. 22.07. dhe 22.08 e që janë subjekt i akcizës, sipas dispozitave të këtij ligji.
23. “Pije joalkoolike” janë ujërat, përfshirë ujërat e gazuara, me përmbajtje alkooli, që nuk e tejkalojnë sasinë 0.5 për qind në vëllim, të cilat përmbajnë sheqer të shtuar, lëndë të tjera ëmbëlsuese ose aroma dhe pije të tjera joalkoolike (përfshirë birrën pa alkool) që nuk e tejkalojnë sasinë 0.5 për qind alkool në vëllim, të klasifikuara sipas kodit N.K.22.01 e 22.02, lëngje frutash ose perimesh, të klasifikuara në kodin N.K.20.09.
24. “Prodhim birre” është procesi i fermentimit të elbit, maltos dhe materialeve të tjera si lupolo, maja dhe shtesa të tjera për të prodhuar birrë.
25. “Prodhues” është cilido person që prodhon mallra të tatueshme me akcizë, qoftë ky person i autorizuar apo jo.

26. "Produkt I ndërmjetëm" nënkupton verën, pavarësisht nga fakti që produkt I ndërmjetëm është çdo produkt sipas kodit N.K.22.06.

27. "Produkte të gatshme" janë mallra akcize, procesi i prodhimit të të cilave është I përfunduar ose që kërkohet vetëm paketimi përfundimtar për shitje me pakicë.

28. "Punonjës i autorizuar" është një punonjës i organit tatimor, i autorizuar nga Drejtori i Pergjithshëm (ose në emer të tij nga kryetari i degës së tatimeve), për të ushtruar funksione të përcaktuara në këtë ligj.

29. "Puro" është:

a. një role duhani, me një mbështjellje të jashtme prej duhani natyror;

b. një role duhani, që përmban në mënyrë mbizotëruese gjethe të prera ose të grira, të formuara me një material lidhës duhani dhe me një mbështjellje të jashtme e cila është prej duhani, me ngjyrën e zakonshme të një puroje dhe që vendoset në mënyrë spirale;

c. një role duhani që përmban kryesisht gjethe të prera ose të grira, që:

i. kanë një mbështjellje të jashtme prej duhani e që kanë ngjyrën e zakonshme të puros;

ii. kanë një peshë ekskluzive ndaj çdo lloj filtri të veçuar ose me një bisht prej jo më pak se 2.3 gram;

iii. ka një perimetër të përgjithshëm mbi së paku një të tretën e gjatësisë së saj, por jo më pak se 34 milimetra.

30."Regjimi i pezullimit tatimor" është një regjim i zbatuar mbi prodhimin, përpunimin, mbajtjen dhe lëvizjen e produkteve, akciza e të cilave është e pezulluar.

31."Shkalla standarte" janë gjoba e vendosura siç përcaktohet në nenin 48 të këtij ligji.

32."Tatimpagues akcize" është çdo person, i autorizuar ose jo, që kryen një tregti ose veprimtari ekonomike, që është subjekt i dispozitave të këtij ligji ose që konsiston dhe përfshin prodhimin, blerjen, shitjen, importimin, eksportimin, trajnimin ose përdorimin e çdo lloj malli, të çdo klasë ose përshkrimi, subjekt të akcizës (pavarësisht nëse është paguar ose jo akciza mbi to).

33."Termometër" është një aparat matës, që miratohet në përdorim, në kuadër të dispozitave të këtij ligji dhe të udhëzimeve në zbatim të tij.

34."Verë" është çfarëdo lloj pije, që klasifikohet sipas kodit N.K. 22.04, 22.05 dhe 22.06.

35."Zëvendësues i lëndëve djegëse" është çdo lëng, i cili përdoret si lëndë djegëse (por që nuk është nënprodukt nafte), në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

36."Përfaqësues tatimor" është çdo person që vepron në emër të një importuesi të mallrave të akcizës për importimin e këtyre mallrave dhe që caktohet si i tillë nga një person, që nuk ka një seli të përhershme në territorin e Republikës së Shqipërisë".

K R E U II

Neni 3

Personat e tatueshëm

1. Persona të tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, janë të gjithë personat që zotërojnë mallra akcize dhe që janë të detyruar ta paguajnë atë, sipas nenit 22 të këtij ligji.
2. Në personat e tatueshëm përfshihet edhe përfaqësuesi tatimor i çdo personi, që importon mallra të tatueshme me akcizë, i autorizuar sipas nenit 7 të këtij Ligji.
3. Nëse një person i përkufizuar në pikën 1 të këtij neni nuk ka paguar akcizën e detyrueshme mbi mallrat e akcizës, atëherë akciza për këto mallra do të paguhet nga çdo person tjetër i përfshirë në importimin, prodhimin ose zotërimin e mallrave të akcizës, në çdo kohë.

Neni 4

Detyrimi për paisjen me autorizim akcize

1. Çdo person që prodhon mallra në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose importon ngarkesa tregtare mallrash, subjekt akcize, për përpunim të miratuar në një magazinë tatimore të miratuar, detyrohet të pajiset me autorizimin e organeve tatimore. Pajisja me autorizim nga organet tatimore përkatëse bëhet sipas kushteve të caktuara nga Ministri i Financave.
2. Çdo person i autorizuar nga organet tatimore, mund të prodhojë dhe mbajë në magazinën tatimore të miratuar, sipas dispozitave të nenit 5 të këtij Ligji, vetëm mallrat e akcizës të përshkruara në autorizim, të cilat prodhohen prej tij në territorin e Republikës së Shqipërisë ose importohen të paemballazuara për përpunim të mëtejshëm, në kuadër të regjimit të pezullimit tatimor.
3. Cdo person që, sipas pikës 2 të këtij neni, ka të drejtë të mbajë mallra akcize në magazinën tatimore pa bërë pagesën e akcizës, mundet gjithashtu të kryejë, pa bërë pagesën e akcizës, operacione me mallrat e akcizës të mbajtura në atë truall, ndërtesë apo mjedis tjetër, sipas autorizimit të organeve tatimore.
- 3/1. Çdo person që importon malto dhe nuk është i autorizuar si prodhues birre, është i detyruar të pajiset me autorizim nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve. Ministri i Financave percakton me udhëzim rregullat për vendosjen e garancise para importimit të maltos, për dokumentacionin e nevojshëm dhe për kthimin e garancise.
4. Cdo person që kërkon të marrë autorizimin për të prodhuar dhe për të mbajtur mallra akcize, duhet të përcaktojë:
 - a. procesin e prodhimit që do të kryejë;
 - b. sasitë e lëndës së parë të përdorur për të prodhuar produkte akcize të gatshme ;
 - c. humbjet në prodhim ose magazinim (firo të lejuara) që do të ndodhin gjatë rrjedhës normale të aktivitetit ekonomik, brenda kufijve të përcaktuar në Udhëzimet e Ministrisë të Financave në përputhje me standartet dhe normat teknike.
5. Sipas kushteve, që Ministri i Financave i parashikon në Udhëzimet e veta në zbatim të këtij Ligji, organet tatimore, bazuar në këtë nen, pajisin me

autorizim çdo person për të prodhuar më tepër se një mall akcize dhe për të mbajtur sasira të secilit prej këtyre mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor.

6. Për pajisjen me autorizimin e organeve tatimore, çdo person paguan një shumë prej 10 mijë lekësh.

7. Ky Nen nuk zbatohet për individët privatë që prodhojnë raki për konsum personal nga vetë ata dhe familjarët e tyre, në sasi që nuk e kalon në asnjë moment sasinë prej pesë litra raki për çdo proces dhe sasinë prej 100 litrash raki për çdo vit kalendarik, për individët privatë që prodhojnë verë për konsum personal nga vetë ato dhe familjarët e tyre në sasi që nuk kalon 200 litra verë për çdo vit kalendarik.

Neni 5

Detyrimi për të kërkuar miratimin e magazinës tatimore

1. Çdo person i autorizuar sipas nenit 4 të këtij ligji, nëse kërkon të prodhojë ose mbajë mallra akcize në ndonjë truall, ndërtesë ose mjedis tjetër nën regjimin e pezullimit tatimor, duhet të kërkojë më parë në organet tatimore, që ato t'i miratojnë atij si magazinë tatimore truallin, ndërtesën ose mjedisin tjetër që ai disponon. Miratimi i magazinës tatimore bëhet sipas kushteve të caktuara nga Ministri i Financave.

2. Për mallrat e akcizës, që kërkojnë pullë fiskale, miratimi i magazines tatimore, në kuadër të regjimit të pezullimit tatimor bëhet vetëm për troje, ndërtesa ose mjedise të tjera ku mbahen vetëm mallra që i nënshtrohen procesit të vjetërimit (siç është periudha e maturimit për disa pije alkoolike), mallra që i nënshtrohen një përpunimi të mëtejshëm para se të ambalazhohen për shitje me pakicë, si dhe mallra të prodhuara për eksport, në sasite e autorizuara nga organet tatimore.

3. Miratimi për mbajtjen e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor jepet vetëm nëse akciza e detyrueshme për këto mallra, sigurohet me një garanci të miratuar, lëshuar nga një bankë ose institucion tjetër financiar të njohur nga Banka e Shqipërisë.

4. Kërkesat që kanë të bëjnë me prodhimin e nënprodukteve të naftës, alkoolit, pijeve alkoolike, verës ose birrës, duhet të përfshijnë listën dhe përshkrimin e të gjitha makinerive dhe pajisjeve, aparateve distiluese, kaldajave, tubave të brumit, enëve të fermentimit, ftohësive, enëve të pritjes së produktit dhe çdo mjeti ose makinerie tjetër që synohet të vendoset mbi ose në çdo truall, ndërtesë ose mjedis tjetër në çastin e kërkesës.

5. Miratimi i çdo trualli, ndërtese ose mjedisi tjetër si magazinë tatimore jepet vetëm pasi punonjësi i autorizuar i organeve tatimore të ketë inspektuar në vend truallin, ndërtesën ose çdo mjedis tjetër ku do të kryhet veprimtaria ekonomike dhe pasi ai të ketë vërtetuar me shkrim se kërkesa, përshkrimi dhe skicat përfaqësojnë saktë truallin, ndërtesën ose mjediset e tejsra, për të cilat është kërkuar miratimi dhe se janë zbatuar të gjitha dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe të udhëzimeve të Ministrisë së Financave, në zbatim të këtij ligji.

6. Në një magazinë tatimore të miratuar nuk mbahen në të njëjtin vend mallrat e akcizës të caktuara për tu mbajtur nën regjimin e pezullimit tatimor, edhe mallra akcize për të cilat akciza është paguar. Gjithashtu, në një magazinë

tatimore të miratuar lënda e parë nuk mund të ruhet në të njëjtin vend me mallrat e akcizës të prodhuara të cilat ruhen nën regjimin e pezullimit tatimor ose në zona të caktuara për mallra akcize, për të cilat akciza është paguar dhe çdo lëvizje e lëndeve të para, për në një vend të ndryshëm nga ai i prodhimit, duhet të jetë e miratuar paraprakisht nga organi tatimor.

7. Çdo person për pajisjen me dokumentacionin e miratimit të magazinës tatimore u paguan organeve tatimore një shumë prej 10 mijë lekësh.

8. Ky nen nuk do të zbatohet për troje, ndërtesa apo mjedise të tjera të miratuara si magazina doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 6

Mënyra e kërkesës për marrjen e autorizimit të akcizës dhe miratimit të magazinës tatimore

1. Cdo person që kërkon të pajiset me autorizim akcize duhet të bëjë kërkesë me shkrim në degën e tatimeve ku ka selinë qendrore.

2. Çdo person i autorizuar, që kërkon të pajiset me miratim për magazinë tatimore për çdo rast duhet të bëjë kërkesë me shkrim në degën e tatimeve të rrethit ku ndodhen magazina tatimore, për të përpunuar dhe prodhuar mallra akcize.

3. Kur një person i autorizuar kërkon të miratojë më tepër se një magazine tatimore, ai duhet t'i bëjë një kërkesë me shkrim në degën perkatese të tatimeve që mbulon zonen e operimit të cdo magazine me qëllim që të miratojë çdo truall, ndërtesë apo ambient tjetër që ai synon të përdorë si magazina tatimore.

4. Çdo kërkesë sipas pikave (2) ose (3) të këtij neni, shoqërohet nga një shpjegues të proceseve dhe një skicë ose përkthim që tregon rrjedhën, ndërtimin dhe përdorimin e të gjithë paisjeve që do të përdoren.

Neni 7

Paisja me autorizim akcize e përfaqësuesve tatimorë

1. Çdo person që vepron, ose synon të veprojë si një përfaqësues tatimor, detyrohet të pajiset me autorizimin përkatës nga organet tatimore, në përputhje me Nenin 4 të këtij Ligji.

2. Çdo person që kërkon një autorizim akcize si përfaqësues tatimor, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim në organin tatimor ku ndodhet selia qendrore e tij ose, në rastin e një personi fizik, në organin tatimor ku ka vendbanimin e perhershëm.

3. Çdo autorizim i lëshuar nga organet tatimore është i vlefshëm për periudha një vjeçare dhe kushte të parashikuara në autorizimin e lëshuar nga organet tatimore.

4. Për marrjen e autorizimit sipas këtij neni, paguhet një shumë prej 10 mijë lekësh.

Neni 8

Transferimi i autorizimit të akcizës dhe/ose i miratimit të magazinës tatimore

1. Kur personi, të cilit i është dhënë autorizimi i akcizës, vdes ose tërhiqet nga pozicioni i vet, organi tatimor mund ta transferojë këtë autorizim te një person tjetër, që vazhdon veprimtarinë për pjesën e mbetur të periudhës për të cilën ishte dhënë autorizimi.
2. Kur një person që zotëron miratimin për përdorimin si magazinë tatimore të një trualli, ndërtese apo mjedisi tjetër transferon veprimtarinë në një tjetër tokë, ndërtesë apo mjedis tjetër, ai është i detyruar të marrë miratimin nga organet tatimore, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, para se të fillojë veprimtarinë ekonomike në truallin, ndërtesën apo mjedisin tjetër.
3. Për transferimin e autorizimit ose të miratimit, çdo person paguan një shumë prej 5 mijë lekësh.

Neni 9

Heqja e autorizimit të akcizës dhe heqja e miratimit të magazinës tatimore

1. Çdo person i autorizuar akcize, që dëshiron të mbylle veprimtarinë e vet ekonomike në ndonjërin prej magazinave të miratuara si magazina tatimore, duhet të njoftojë me shkrim organet tatimore jo më vonë se 30 ditë përpara datës së mbylljes.
2. Kur organet tatimore përkatëse konstatojnë se një person i autorizuar nuk ka filluar kryerjen e veprimtarisë së vet ekonomike në ndonjërin prej magazinave tatimore të miratuara, ato mund ta heqin miratimin për atë magazinë.
3. Organet tatimore, mund të heqin ose ndryshojnë në çdo kohë autorizimin e akcizës ose miratimin si magazinë tatimore të ndonjë trualli, ndërtese apo mjedisi tjetër.

Neni 10

Lëvizja e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor

1. Mallrat e akcizës mund të dalin nga një magazinë tatimore pa pagesën e akcizes, vetëm në rastet e mëposhtme :
 - a. për eksport;
 - b. për t'u dërguar në një magazinë tjetër tatimore të miratuar;
 - c. për furnizimin e anijeve apo avioneve si artikuj të shitjes me pakicë për pasagjerët, me kushtin që këto anije apo avionë ndalesën e parë ta kenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Ngarkesat tregtare të nënprodukteve të naftës, të verës, pijeve alkoolike, alkolit, cigareve, purove dhe produkteve të tjera të përpunuara të duhanit mund të zhvendosen nga vendi i importimit në një magazinë tatimore të miratuar për përpunim të mëtejshëm në kuadër të regjimit të pezullimit tatimor, sipas pikave 3 deri në 5 të këtij neni dhe të nenit 39 të këtij ligji.
3. Nuk lejohet lëvizja e mallrave të akcizës, akciza e të cilave nuk është paguar, përveç kur lëvizja është miratuar me shkrim nga organi tatimor, sipas

pikave 1 dhe 2 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për lëvizjet sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe kur janë plotësuar kërkesat e mëposhtme;

a. akciza e llogaritur si e pagueshme për mallrat e akcizës që dalin është siguruar nëpërmjet një garancie të miratuar nga organi tatimor;

b. mallrat e akcizes që dalin sipas pikës 1 të këtij neni shoqërohen me një dokument, që ka formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë të Financave dhe që lëshohet nga nisësi i mallit ose agjenti i tij;

c. mallrat e akcizës të dala sipas pikës 1 shkronjat “a” dhe “c” dhe pikës 2 të këtij neni gjithashtu përmbushin kërkesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

4. Në rastin e eksportit ose furnizimit të anijeve dhe avioneve të transportit ndërkombëtar, shitësi duhet të provojë në organet tatimore se mallrat e akcizës, sipas rastit, janë eksportuar ose furnizuar si artikuj të shitjes me pakicë në anijet dhe avionët e transportit ndërkombëtar.

5. Çdo dërgesë e mallrave të akcizës e dalë në kuadër të regjimit të pezullimit tatimor kryhet në një kontenier të tipit të miratuar për këtë qëllim nga organi tatimor dhe vuloset nga nisësi me një vulë numerike të miratuar nga organi tatimor, sipas deklarimeve përkatëse të paraqitura pranë këtij organi.

6. Organet tatimore mund të kufizojnë ose ndalojnë lëvizjen e mallrave të akcizës nga magazinat e miratuara të regjimit të pezullimit tatimor, duk njoftuar me shkrim personin e autorizuar të mallrave të akcizës.

Neni 11

Mbajtja e regjistrimeve

1. Çdo person që i nështrohet akcizës është i detyruar të mbajë regjistrime, përmbajtja dhe lloji i të cilave, për çdo mall akcize si dhe vendi ku duhen mbajtur regjistrimet, të disponueshme për organet tatimore, përcaktohen në udhëzimet e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2. Në rastet kur regjistrimet mbahen në kompjuter ose në çfarëdolloj forme tjetër elektronike, personi që i nështrohet akcizës duhet të njoftojë organin tatimor për programin e përdorur dhe të ndihmojë atë për të kuptuar dhe dokumentuar çdo sistem regjistrimesh.

3. Çdo përfaqësues tatimor, i autorizuar sipas dispozitave të nenit 7 të këtij ligji, duhet të përmbushë kërkesat e pikës 1 të këtij neni njëjloj si të ishte personi në emër të të cilit ai vepron si përfaqësues tatimor.

4. Çdo regjistrim, nga data që është krijuar ruhet për një periudhë kohe, sipas afateve të caktuara në ligjin për kontabilitetin dhe u vihet në dispozicion punonjësve të autorizuar të organit tatimor, sipas kërkesës së tyre.

5. Çdo shtesë ose ndryshim në çdo regjistrim shoqërohet me shpjegime për arsyet e shtesës ose të ndryshimit dhe regjistrimi origjinal duhet të jetë i lexueshëm.

Neni 12

Inventarizimi dhe llogaritja e mallit gjendje

Në fund të çdo muaji kalendarik, personat e autorizuar të akcizës inventarizojnë të gjitha lëndët e para dhe mallrat e akcizës, të çdo lloji që gjenden në magazinën e miratuar tatimore, dhe dërgojnë në organet tatimore

një raport të këtij inventari në formën dhe mënyrën e caktuar nga Ministri i Financave.

Neni 13

Humbjet

1. Humbje në prodhim është diferenca ndërmjet sasisë së pritshme të prodhimit, llogaritur nga sasia e lëndës së parë të përdorur pas zbatimit të normativave të procesit të prodhimit dhe koeficientëve të humbjes në prodhim të shpallura në autorizimin e personave të autorizuar të akcizës dhe sasisë së mallrave të akcizës të deklaruar si të prodhuara nga sasia e lëndëve të para të përdorura në periudhën e prodhimit.
2. Humbje në tranzit është diferenca ndërmjet sasisë së mallrave të akcizës të deklaruara në dokumentin e transportit (ose sasia reale nëse është më e madhe) në vendin e nisjes (ose pikën e importit kur mallrat e akcizës janë të importuara) dhe sasisë së mallrave të akcizës gjendje në mjetin e transportit kur dergesa arrin destinacion. Kjo pikë nuk zbatohet për mallrat e akcizës nën regjimin e tranzitit të kontrolluara nga dogana.
3. Humbje në mallin gjendje (në magazinë) është diferenca ndërmjet sasisë së mallrave të akcizës, të regjistruara në regjistrat e magazinave tatimore të miratuara dhe sasisë së mallrave të akcizës të gjetura gjatë kryerjes së një kontrolli fizik të mallit gjendje.
4. Kur konstatohet një humbje, për mallrat e akcizës që nuk gjenden, organet tatimore bëjnë vlerësimin e akcizës së pagueshme.

Neni 14

Vlerësimi

1. Kur organet tatimore konstatojnë se një person detyrohet të paguajë atyre një akcizë të caktuar, ato bëjnë vlerësimin e akcizës së pagueshme nga personi, dhe e njoftojnë këtë person për shumën në fjalë.
2. Organet tatimore bëjnë vlerësimin e akcizës së pagueshme, kur personi i detyruar për të paguar akcizën nuk mund të provojë se akciza e pagueshme është paguar:
 - a. sepse ai nuk ka mbajtur regjistrime sipas kërkesave të këtij Ligji ose të Udhëzimeve të Ministrisë të Financave në zbatim të tij;
 - b. sepse ai nuk ka përgatitur ndonjë dokument ose kopje të ndonjë dokumenti sipas kërkesës së organeve tatimore;
 - c. për shkak të ndonjë harrese apo gabimi në regjistrim ose deklaram, të bërë nga personi të cilit i kërkohet të mbajë regjistrime ose të bëjë deklarime sipas dispozitave të këtij ligji;
 - ç. për shkak të ndonjë humbje, sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 15

Kompetenca për të inspektuar dhe kontrolluar në magazinat tatimore të miratuara

1. Punonjësit e organeve tatimore, të pajisur me autorizimin përkatës, për të inspektuar dhe kontrolluar magazinat tatimore të miratuara, kanë këto të drejta :

a. të hyjnë në çdo kohë dhe të qëndrojnë për aq kohë sa është e nevojshme në çdo vend të agazinës tatimore ku ndodden makineri, paisje ndihmëse dhe aparate që mund të përdoren për prodhimin e mallrave të akcizës dhe ku ushtron veprimtarinë ekonomike, me mallrat e akcizës, personi i autorizuar;

b. të hyjnë në çdo kohë në vendet e magazinës tatimore të tatimpaguesit, ku magazinohen, mbahen ose shiten mallra akcize;

c. të inspektojnë trojet, ndërtesat ose ambientet e tjera dhe të inventarizojnë, sipas nevojave, çdo pjesë të tyre, proceset e prodhimit, kontenierët, paisjet ndihmëse, mallrat dhe materialet, makineritë dhe aparatet që i përkasin personit të autorizuar;

ç. të verifikojnë nëse ekziston ndonjë tubacion, distileri, kontenier, paisje ndihmëse, makineri ose aparat, ndonjë magazinë, mall apo artikull që i nënshtrohet akcizës, të cilat janë të fshehura.

d. të analizojnë çdo aparat distilimi ose aparate të tjera të përdorura nga një person i autorizuar për prodhimin e mallrave të akcizës, në çfarëdo kohë, për të parandaluar ose zbuluar mashtrimet, me kusht që një veprim i tillë të mos dëmtojë funksionimin e aparateve;

dh. të kalibrojnë, masin, peshojnë, provojnë, shenjojnë, etiketojnë, stampojnë, kyçin, vulosin si dhe të shenjojnë ose sigurojnë aparatet, kontenierët, makineritë, paisjet ndihmëse ose mallrat e akcizës dhe të mbyllin, vulosin dhe sigurojnë të gjitha ose çdonjërin prej tyre, kur prodhuesi i mallrave të akcizës nuk është duke punuar në magazinën tatimore të miratuar;

e. të marrin si mostra mallra në proces prodhimi, që janë prodhuar, janë gjendje ose janë nën zotërimin e personit që kryen veprimtari si person i autorizuar akcize, të cilat do të vihen në dispozicion nga prodhuesi ose ndonjë person tjetër pa pagesë. Për marrjen e mostrave lëshohet dokumenti përkatës.

Neni 16

Kompetencat për të kontrolluar në mjedise të tjera

1. Punonjësit e autorizuar të organeve tatimore që kanë atributet e policisë gjyqësore, sipas ligjit nr.8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", mund të ushtrorjnë verifikime dhe kontrole në mjedise të tjera të personit që merret ose dyshohet se kryhen veprime që lidhen me mallrat e akcizës.

2. Për përmbushjen e detyrave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, punonjësit e autorizuar të organeve tatimore kanë këto kompetenca:

a. të kërkojnë mbeshetjeten e punonjesve te Policise Tatimore ose të Rendit kur e shohin të nevojshme një gjë të tillë;

- b. të kryejnë verifikime dhe kontrole në truall, ndërtesë ose mjedis tjetër, në çdo kohë, si dhe të sekuestrojnë ose të marrin me vete çdo send, që përbën ose lidhet me shkelje të parashikuara sipas këtij ligji;
 - c. të kërkojnë ose të realizojnë për aq sa është e nevojshme për realizimin e verifikimeve, kontroleve dhe sekuestime, heqjen e çdo pengese ose bllokimi;
 - d. të kontrollojnë personat që gjenden në objektin ku kryhen verifikimet dhe kontrollet
3. Verifikimi ose kontrolli në banesa, të cilat nuk janë të deklaruara paraprakisht pranë organit tatimor si seli ose vendndodhje për kryerjen e një veprimtarie të caktuar, bëhet vetëm me pëlqimin e pronarit ose autorizimin e lëshuar nga gjykata.

Neni 17

Kompetencat për të kontrolluar automjetet ose mjetet lundruese

1. Punonjësit e autorizuar të organit tatimor përkatës mund të ndalojnë dhe kontrollojnë automjetin ose anijen kur ka të dhëna se ai ose ajo mund të jetë duke transportuar mallra akcize të cilat janë:
- a. të tatueshme me akcizë e cila nuk është paguar ose siguruar,
 - b. duke u larguar ilegalisht nga ose drejte ndonjë vendi;
 - c. subjekt sekuestrimi për ndonjë arsye sipas këtij ligji;

Neni 18

Kompetenca për të sekuestruar regjistrimet

1. Kur ka të dhëna se një dokument, skedar kompjuterik apo regjistrim tjetër, përmban informacion që lidhet me mallrat e akcizës, për të cilat nuk është paguar akciza, punonjësit e autorizuar nga organi tatimor mund të sekuestrojnë këto regjistrime.
2. Nëse ndonjë regjistrim sekuestrohet në bazë të pikës 1 të këtij neni, punonjësit e autorizuar nga organi tatimor përgatisin një procesverbal të hollësishëm të regjistrimeve të sekuestruara dhe i japin një kopje të origjinalit brenda 24 orëve, vetëm personit të autorizuar nga tatimpaguesi i akcizës ose përfaqësuesi i tij fiskal.
3. Do të konsiderohet si mbrojtje për organet tatimore ndaj çdo kërkesë për dëm të shkaktuar për dhenien e kopieve të origjinalit të regjistrimeve brenda 24 orëve, vetëm personit të autorizuar nga tatimpaguesi i akcizës ose përfaqësuesi i tij fiskal.

Neni 19

Përfundimet

1. Në zbatim të këtij ligji, organet tatimore lejojnë transaksione pa pagimin e akcizës, kur provohet se:
- a. mallrat e akcizës ekportohen;
 - b. mallrat e akcizës janë vendosur nën regjimin e pezullimit doganor;

c. mallrat e akcizës improtohen nga përfaqësitë diplomatike, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në të cilat parashikohen shprehimisht përjashtimi nga pagimi i akcizës;

d. mallrat e akcizës janë vendosur nën regjimin e pezullimit tatimor.

e. gazoili është shitur për anijet e peshkimit në sasitë, kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Në zbatim të këtij ligji, organet tatimore bëjnë rimbursimin e akcizës së paguar, kur provohet se:

a. mallrat e akcizës janë subjekt i një procesi të miratuar;

b. mallrat e akcizës eksportohen;

c. shfuqizohet

ç. Për lëndët djegëse të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MË për burim, për nevojat e veta apo për shitje, sipas sasisë, kushteve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) për lëndën djegëse të konsumuar në serat me ngrahje, në industrinë e riciklimit, përprodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasitë e produktit final të shitur me faturë TVSH-je dhe sipas kushteve e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) për ambalazhet e plastikës, të qelqit dhe ato të përziera, të përdorura si lëndë e parë, industrive vendase të riciklimit të këtyre materialeve u rimburohet 50 për qind e akcizës së paguar për këto ambalazhe, sipas sasisë, kushteve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rimbursimi i akcizës së përcaktuar në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj pike kryhet çdo muaj. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

3. Përjashtohen nga akcizat importimi i nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, të cilat, në mbështetje të ligjeve nr.7746, datë 29.07.1993 “Për hidrokarburet” dhe nr.7811 datë 12.4.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve” dhe në bazë të marrëveshjeve që kanë nënshkruar me Qeverinë Shqiptare, kanë rënë dakort për ndarjen e prodhimit dhe për tatimin mbi fitimin në masën 50 për qind. Përcaktimi dhe dokumentimi i sasive që këto subjekte përdorin për nevoja të shpimeve për kërkimin dhe vënien në shfrytëzim të zonave naftëmbajtës përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës.

4. Shfuqizohet

Neni 20

Kufijtë kohorë për vlerësimet

1. Organet tatimore nuk kanë të drejtë të bëjnë një vlerësim tatimor pas pesë vjetësh nga data në të cilën është krijuar detyrimi për akcizën, përveç rasteve të mëposhtme:

- a. kur vlerësimi bëhet vetëm për të bërë të frytshëm një apelim ndaj një vlerësimi të bërë brenda këtij kufiri kohor;
- b. kur vlerësimi bëhet si rezultat i mospagimit, për shkak të mashtrimit;
- c. kur vlerësimi bëhet për shkak se personi ka prodhuar ose tregtuar mallra me akcizë pa qenë i autorizuar nga organet tatimore.

2. Në rastin e vlersimeve të bëra si rezultat i mospagimit të akcizës nëpërmjet mashtrimit, periodha prej pesë vjetësh, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, zëvendësohet me njëzet vjet.

KREU III

KERKESA TE PERGJITHSHME PER MALLRAT E AKCIZES

Neni 21

Mallrat që i nënshtrohen akcizës sipas këtij ligji

1. Mallrat e akcizës, të përshkruara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, i nënshtrohen akcizës, sipas tarifave të treguara në këtë shtojcë.

2. Akciza e pagueshme për mallrat e akcizës, të përshkruara në shtojcën 1 të këtij ligji, llogaritet në përputhje me nenet 22 e 23 të këtij ligji, përveç mallrave të detyruara për t'u pajisur me pulla akcize ose me kod sigurie (më poshtë referuar “Pulla fiskale”), sipas neneve 24/1, 24/2 e 25 të tij.

3. Akciza e pagueshme për mallrat e akcizës që kërkojnë pulla fiskale, sipas neneve 24/1, 24/2 e 25 të këtij ligji, llogaritet në përputhje me nenet 26, 27 e 28 të tij.

4. Ngarkesa tregtare të verës, alkoolit, pijeve alkoolike ose cigareve, të importuara ose të prodhuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk kërkohet të pajisen me pullë, por vera, alkooli, pijet alkoolike ose cigaret do të trajtohen në të gjitha pikëpamjet sikur ngarkesat tregtare të verës, alkoolit, pijeve alkoolike ose cigareve të jenë në njësi ambalazhimi ose paketa, të cilat pajisen me pulla akcize, siç parashikohen në Kreun IV të këtij ligji.

5. Nuk u nënshtrohen pagimit të akcizave, sipas dispozitave të këtij ligji, mallrat e mëposhtme që mund të përmbajne alkool:

- a. mallrat ushqimore, ku përmbajtja e alkoolit nuk e tejkalon sasinë prej 8.5 litra të pastër për 100 kilogramë produkt;
- b. aromat dhe esencat alkoolike, të klasifikuara nën kodin N.C.33.02.

Neni 22

Pagesa e akcizës

1. Akciza për mallrat, që i nënshtrohen akcizës, në bazë të dispozitave të këtij ligji, paguhet në çastin e importimit ose të prodhimit të mallrave të akcizës në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.
2. Akciza paguhet sipas tarifavenë fuqi në çastin e krijimit të detyrimit për t'u paguar.
3. Proçdurat për mënyrën dhe kohën e pagimit të akcizës përcaktohen në udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.
4. Për mallrat e akcizës, që i nënshtrohen regjimit të pezullimit tatimor, çasti kur akciza bëhet e pagueshme është më e hershme sesa koha kur:
 - a. akciza pushon së qeni e pezulluar, në përputhje me regjimin e pezullimit tatimor;
 - b. ka shkelje ndaj ndonjë kërkesë, që lidhet me regjimin e pezullimit tatimor;
 - c. personi i autorizuar pushon së qeni i autorizuar;
 - ç) trualli, ndërtesa ose çdo mjedis tjetër, në të cilin mbahen mallrat e akcizës, pushojnë së qeni magazinë tatimore e miratuar.
 - d. mallrat përkatëse të akcizës konsumohen;
 - dh. mallrat përkatëse të akcizës largohen nga magazinat tatimore, me përjashtim të rastit që parashikon neni 10 i këtij ligji;
 - e. lëshohet një faturë, që lidhet me shitjen e mallrave të akcizës;
 - ë) organi tatimor zbulon ose njoftohet se mallra akcize nën regjimin e pezullimit tatimor nuk gjenden në magazinë ose se ka mospërputhje të pajustificuara;
 - f) janë gjetur mospërputhje në gjendjen e llogarive të çdo tatimpaguesi të akcizës ose çasti kur gjendja e lëndëve të para, të përdorura për çdo zë prodhimi të produktit të gatshëm, nuk justifikon sasinë e pranueshme të produktit të gatshëm.

Neni 23

Dorëzimi i deklaratës

Pagesa e akcizës shoqërohet me dorëzimin e një deklaratë nga personi i autorizuar i akcizës. Ministri i Financave përcakton në udhëzim datat dhe numrin e deklaratave, të dhënat që duhet të përmbajnë ato, mënyrën si dhe formën e tyre. Deklarata nënshkruhet nga personi i autorizuar i akcizës ose nga një person i autorizuar prej tij dhe i njohur si i tillë nga organi tatimor.

KREU IV

KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR MALLRA TË AKCIZËS QË KËRKOJNË PULLA FISKALE

Neni 24

Përkufizimi i pullës së akcizës

1. Pulla e akcizës nënkupton një shirit unik të përgatitur sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, që përmban një ose disa nga treguesit e mëposhtëm:
 - a. faktin që është paguar akciza për mallrat e akcizës;
 - b. tarifën e akcizës së paguar;
 - c. shumën e akcizës së paguar;

- ç. çastin e pagimit të akcizës;
 - d. faktin që shitja e mallrave të akcizës;
 - i. është e lejueshme vetëm në datat e treguara në pullë;
 - ii. nuk është e lejueshme ose pas datës së treguar në pullë;
 - iii. nuk është e lejueshme në ose përpara datës së treguar në këtë pullë;
 - dh) tipin e mallrave ose emrin e markës së mallrave për të cilat duhej të paguhej akciza;
2. Udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, mund të ofrojnë dispozita të posaçme për:
- a. përmbajtjen e printuar të pullës së akcizës;
 - b. pamjen e pullës së akcizës;
 - c. tipin dhe cilësinë e materialit nga i cili bëhet pulla;
 - ç. shtresën ku duhet të ngjitet pulla, në rastin e mallrave të akcizës që kanë më shumë se një shtresë ambalazhimi;
 - d. pozicionimin e pullës në ambalazhimin e çdo malli akcize të përcaktuar;
 - dh) kohën kur mallra akcize të specifikuara duhet të pajisen me pullë akcize;
 - e. kushtet dhe kriteret e kufizimit të dhënies së pullave, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 26;
 - ë) rastet e përjashtimit të pagesës nëpërmjet deklarimit, të përcaktuar në nenin 28.
 - f) detyrimin e vendosjes së çmimit të shitjes me pakicë të produktit në pullën e akcizës.
3. Pullat e akcizës janë letra me vlerë dhe monopol shtetëror.
4. Në rastet kur Këshilli i Ministrave vendos të ofrojë me koncesion pjesë apo të gjithë veprimtarinë, që lidhet me pullat e akcizës, përfshirë edhe kontrollin e tyre, atëherë kontrata koncesionare miratohet nga Kuvendi.

Neni 24/1

1. Pajisen me pullë akcize produktet e treguara në shtojcën 1 (Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë), pjesa II (birrë, verë, alkool dhe pije alkoolike) dhe pjesa III (duhani dhe nënproduktet e tij), të këtij ligji, duke përjashtuar birrën e prodhuar në vend, kur kërkohet pajisja me kodin e sigurisë, sipas pikës 2 të këtij neni.
2. Kodi i sigurisë do të thotë një shenjë direkte që aplikohet ekskluzivisht për produktet e birrës që prodhohen në Shqipëri nga prodhuesit në shkallë të madhe.
- Pulla fiskale në formën e kodit të sigurisë aplikohet edhe në produkte të tjera të pijeve alkoolike, përfshirë edhe birrën e importuar, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Prodhuesit në shkallë të madhe përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Kodi i sigurisë trajtohet si dokument me vlerë dhe është monopol shteti.
3. Përgatitja dhe vendosja e kodit të sigurisë, kërkesa të tjera dhe procedurat e zbatueshme përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 24 dhe në nenet 25, 26, 27, 28 e 29 të këtij ligji zbatohen me analogji dhe për kodin e sigurisë.

Neni 24/2

1. Çmimi (duke përfshirë TVSH-në dhe çdo taksë tjetër apo detyrim për pullat e aplikueshme, sipas ligjit në Shqipëri), për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga një koncesionar i autorizuar nga Republika e Shqipërisë për të lëshuar, shpërndarë dhe monitoruar pullat fiskale, përcaktohet në tabelën e treguar në shtojcën 2 të këtij ligji.
2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve, sipas ligjit, u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale, i paguajnë koncesionarit çmimin e përcaktuar në shtojcën 2/1 të këtij ligji, në një llogari të specifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave.
3. Në rastin kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve udhëzon koncesionarin të dërgojë pullat fiskale drejtpërdrejt te furnizuesi i huaj i mallrave, që janë subjekt i akcizës, në një adresë të treguar nga importuesi dhe të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, importuesit paguajnë, në një llogari të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kostot e dërgesës dhe kostot e lidhura me të (duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e lidhura me trajtimin, sigurinë dhe sigurimet etj., por pa përfshirë taksat dhe detyrimet e importit). Taksat dhe detyrimet e importit paguhen nga furnizuesi i huaj.
4. Pagesa e pullave fiskale, si dhe shpenzimet përkatëse, siç përcaktohen në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të parapagohen.
5. Pagesa e akcizës kryhet veçmas nga prodhuesit dhe importuesit.
6. Detyrimet që rrjedhin nga TVSH-ja apo taksa të tjera që janë të pagueshme, lidhur me pullat fiskale, të prodhuara dhe të shpërndara nga koncesionari, mbulojnë nga prodhuesit apo importuesit që blejnë pullat fiskale.
7. Përgatitja dhe aplikimi i pullave fiskale dhe kërkesat e procedurat e tjera të zbatueshme përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 25

Përdorimi i pullave fiskale për mallrat e akcizës

1. Mallrat që i nënshtrohen akcizës nëpërmjet pullave të akcizës, duhet të kenë një pullë të ngjitur në njësinë e ambalazhimit ose paketës, siç përcaktohet në këtë ligj.
2. Mallrat e akcizës të importuara që duhet të pajisen me pullë akcize sipas dispozitave të këtij ligji, duhet ta kenë pullën e akcizës në çastin që importohen, pa cënuar dispozitat e nenit 39 të këtij ligji dhe dispozitat e kodit doganor, të cilat u lejojnë importuesve privatë për të importuar mallra akcize për konsum personal.
3. Pulla e akcizës duhet të ngjitet në mënyrë të tillë që të griset ose të bëhet e papërshtatshme për ripërdorim kur kontenieri apo paketa hapet.

Neni 26

Çasti kur akciza behet e pagueshme per mallrat qe kerkohej te pajisen me pulle

1. Akciza paguhet në bazë të shkallës tatimore në fuqi në çastin kur tatimi bëhet i detyrueshëm për t'u paguar.

2. Për mallrat e akcizës për të cilët kërkohet të kenë pullë akcize, çasti kur akciza bëhet e pagueshme është më i hershmi i çastit kur:
- pulla e akcizës kërkohet të vendoset në njësinë e ambalazhimit ose në paketë;
 - për mallrat e akcizës blihen pullat e akcizës;
 - mallrat e akcizës gjenden jashtë magazinës tatimore të miratuar, pa qenë e lejuar dhe pa qenë të pajisura me pullat e akcizës të fiksuara;
 - janë gjetur mospërputhje në gjendjen e llogarive, ose kur gjendja e lëndëve të para, të perdorura për çdo ze prodhimi të produktit të gatshëm, nuk justifikon sasinë e pranueshme të produktit të gatshëm;
 - është zbuluar se pulla e akcizës e ngjitur në mallrat e akcizës është ripërdorur, manipuluar apo vjedhur, ose nuk paraqet detyrimin e duhur për t'u paguar.
3. Organi tatimor, në raste të veçanta, me miratim të Ministrit të Financave, mund të kufizojë dhënien e pullave në masë të nejtë për të gjithë personat.

Neni 27

Pagesa e akcizës për mallrat që kërkohet të pajisen me pullë

- Pagesa e akcizës për mallrat, për të cilat kërkohet detyrimisht pajisja me pulla akcize, bëhet nëpërmjet blerjes së pullave të akcizës në vlerë të barabartë me tatimin e detyrueshëm për t'u paguar mbi sasinë ose vlerën e mallrave të akcizës në njësi ambalazhimi ose ambalazh tjetër, në të cilin duhet ngjitur pulla.
- Blerja e pullave të akcizës bëhet në vendin e përcaktuar nga organet tatimore, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.
- Furnizimi me pulla bëhet kundrejt pagesës.
- Pagesa e akcizës për mallrat e akcizës, për të cilat kërkohet pajisja me pullë, bëhet nëpërmjet blerjes së pullave të akcizës në sasinë përkatëse, përpara se mallrat të importohen ose të nxirren për shitje nga trojet, ndërtesat ose mjediset e tjera të autorizuara për prodhim.

Neni 28

Dorëzimi i deklaratave për mallrat që kërkohet të pajisen me pullë

Pagesa e tatimit për mallrat e akcizës, që duhen pajisur me pullë, shoqërohet me dorëzimin e një deklarate, e cila përmban të dhënat dhe formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 29

Regjistrimet për mallra që kërkohet të pajisen me pullë

Përveç kërkesave të përgjithshme për mbajtje regjistrimesh, të përcaktuara në nenin 11 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, personat që l nënshtrohen akcizës, të cilët prodhojnë ose merren në çfarëdo lloj forme tjetër me mallrat e akcizës, që kërkohet të pajisen me pullë, detyrohen të mbajnë regjistrime të sakta e të përditshme, sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrit të Financave.

K R E U V

DEPOT E NENPRODUKTEVE TE NAFTES

Neni 30

Kërkesa për autorizim akcize dhe miratim trualli, ndërtese apo mjedisi tjetër në të cilat gjenden depo të nënprodukteve të naftës

1. Personi që dëshiron të hapë apo të vazhdojë veprimtarinë në një depo të nënprodukteve të naftës, duhet të bëjë kërkesë pranë organit tatimor për autorizim akcize në bazë të dispozitave të nenit 4 të këtij Ligji dhe për miratimin si magazinë tatimore, në bazë të nenit 5 të këtij ligji.
2. Depoja e nënprodukteve të naftës nuk do të funksionojë në qoftë se personi i autorizuar nuk pajiset me autorizim në përputhje me nenin 4 të këtij ligji dhe trualli, ndërtesa apo mjedisi tjetër, ku ndodhet depoja e nënprodukteve të naftës nuk është miratuar si magazinë tatimore në bazë të nenit 5 të këtij ligji.
3. Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen për depot e miratuara si magazinë doganore, sipas Kodit Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij, të cilat përdoren vetëm për magazinimin e nënprodukteve të naftës të importuara.

Neni 31

Furnizimi i depove me nënprodukte të naftës, magazinimi dhe nxjerrja e nënprodukteve të naftës nga depot

1. Personi i autorizuar i depos, njofton organin tatimor të paktën 1 dite pune përpara marrjes së furnizimit, dhe ai nuk duhet që, pa lejen e organit tatimor të shkarkojë nënproduktet e naftës në depozitat e ruajtjes ose tubacionet e dërgimit dhe të thyejë vulën e vendosur për qëllime transporti.
2. Të gjitha furnizimet e marra dhe të gjitha lëvrimet të nënprodukteve të naftës për qëllime të këtij ligji duhet të maten me një aparat matës, që mat në mënyrë të saktë dhe tregon sasinë e lëngut që rrjedh në të. Aparati matës paraqitet nga personi i autorizuar i depos dhe miratohet nga organi tatimor.
3. Të gjitha nënproduktet e naftës ruhen në depozita të miratura nga organi tatimor dhe personi i autorizuar i depos duhet të vulosë të gjitha hyrjet, daljet dhe pajisjet matëse dhe të ofrojë ndihmën e kërkuar nga organi tatimor për të matur kapacitetin magazinues të një depozite, si dhe të përmbushë të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara nga organi tatimor në miratimin si magazinë tatimore.
4. Gjendja e cdo nënprodukti naftë në depo duhet të jetë e matshme nga organi tatimor me anë të zhytjes fizike të një shkopi matës të shkallëzuar që tregon sasinë duke iu referuar shkallëzimeve të shkopit apo ndonjë metode tjetër të miratuar nga organi tatimor, sipas deklaramit të paraqitur nga personat e autorizuar.

Neni 32

Regjistrimet për depot e nënprodukteve të naftës

1. Personi i autorizuar i depos duhet të mbajë regjistrime të veçanta dhe të bëjë inventarizimin për çdo depozitë magazinimi të miratuar, për të treguar në çdo fund muaji kalendarik apo në çdo kohë tjetër të kërkuar nga organi tatimor:
 - a. sasinë e mallrave të akcizës në çdo depozitë magazinimi sipas matjeve të mëparshme (gjendja në fillim);
 - b. sasinë e mallrave të akcizës në çdo depozitë magazinimi në datën e inventarizimit aktual (gjendja në fund);
 - c. sasinë e mallrave të akcizës të furnizuara nga çdo depozitë magazinimi shoqëruar me detajet për çdo sasi dhe akcizën përkatëse;
 - d. çdo diferencë të zbuluar (mospërputhje)
2. Organi tatimor mund t'i kërkojë personit të autorizuar të depos së nënprodukteve të naftës të mbajë regjistrime shtesë.

Neni 33

Çasti i pagesës së akcizës për mallrat e akcizës të mbajtura në një depo të nënprodukteve të naftës

1. Çasti kur akciza bëhet e pagueshme për mallrat e akcizës të mbajtura në një depo të nënprodukteve të naftës do të jetë më i hershmi ndërmjet:
 - a. çastit të largimit (daljes) të tyre nga depozitat e miratuara si depo të nënprodukteve të naftës;
 - b. çastit kur mallrat e akcizës nuk gjenden ose kur mospërputhjet nuk justifikohen.

Neni 34

Llogaritja e akcizës për mallrat e akcizës të mbajtura në një depo të nënprodukteve të naftës

1. Për depot e nënprodukteve të naftës të miratuara zbatohen dispozitat e përgjithshme të neneve 11, 12, 13, dhe 14 të këtij ligji.
2. Kur nga inventari del se sasi të caktuara mallra akcize mungojnë, mungesat i njoftohen degës përkatëse të tatimeve menjëherë ose, kur nuk arrihet të njoftohet menjëherë, ditën e nesërme të punës dhe, nëse nuk vërtetohet mospërputhje akciza, paguhet nga administratori i depos së miratuar sipas shkallës tatimore në fuqi në kohën kur u zbuluan mungesat brenda 10 ditësh nga zbulimi.
3. Personi i autorizuar për administrimin e depos është i detyruar të paguajë sipas vlerësimit të bërë bazuar në nenin 14 dhe pagesa bëhet në përputhje me pikën 3 të nenit 22 të këtij ligji.
4. Deklarata e kërkuar në përputhje me këtë ligj do të bëhet sipas formularit të përcaktuar nga organi tatimor.

Neni 35

Ndihma e ofruar punonjesve të autorizuar të organeve tatimore

1. Punonjësve të autorizuar të organit tatimor i ofrohet ndihma e kërkuar me qëllim mundësimin e hyrjes në çdo pjesë të depos së miratuar.
2. Administratori i depos së miratuar pajis punonjësit e autorizuar të organit tatimor me të gjitha veshjet mbrojtëse të nevojshme, duke i udhëzuar ata për rregullat standarte të sigurisë, që janë në fuqi për sektorin.

K R E U V I

DISPOZITA TË POSAÇME PËR DISA NGA MALLRAT E AKCIZËS

Neni 36

Metoda e llogaritjes së akcizës

1. Kur akciza llogaritet sipas vëllimit ose peshës së mallrave, për të cilat është e detyrueshme të paguhet akcize, vëllimi ose pesha e tyre do të përcaktohen në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij Ligji.
2. Kur akciza llogaritet sipas vlerës së mallrave, për të cilat është e detyrueshme të paguhet akcizë, vlera e tatueshme për qëllimet e akcizës do të jetë:
 - a. për mallrat e importuara të akcizës, vlera doganore sic përcaktohet nga Kodi Doganor pavarësisht nga fakti që detyrimi doganor paguhet ose jo.
 - b. për mallrat e prodhuara në Shqipëri dhe që i janë shitur një blerësi, që nuk është person i lidhur (siç përcaktohet në ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat), shuma e paguar faktikisht për mallrat e shitura përfshirë vlerën e paketimit, por përjashtuar TVSH-në;
 - c. për mallrat e akcizës, të prodhuara në Shqipëri dhe që i janë shitur një blerësi, që është një person i lidhur (siç përcaktohet në ligjin Tatimi mbi të Ardhurat), shuma që duhej të pagohej nga një blerës person i palidhur për mallrat e akcizës të shitura, që përfshin vlerën e paketimit por jo TVSH-në, sipas përcaktimit të organeve tatimore.
 - ç) për gazoilin, sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës.

Neni 37

Llogaritja e akcizes per nenproduktet e naftes

1. Në bazë të paragrafit (2) më poshtë, akciza mbi nënproduktet e naftës llogaritet mbi vëllimin e produktit të matur në një temperaturë standarte prej 15°C. Kur vëllimi matet në një temperaturë të ndryshme nga 15°C, vëllimi duhet të saktësohet në përputhje me standartet Nderkombetare në fuqi, të cilat përcaktohen në Udhëzimin e Ministrisë së Financave.
2. Dispozitat rregulluese në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohen për naftën e rëndë sipas kodit N.K. 27.10 00 74 dhe 27.10 00 78 ose gazin natyror të lëngëzuar sipas kodit N.KC. 27.11 12 11 dhe 27.11 19 00. dhe metoda e rregullimit për një detyrim të tillë akcize përcaktohet në përputhje me Udhëzimet e Ministrit.

Neni 38

Zëvendësuesit e lendeve djegëse

1. Çdo lëng i përdorur si zëvendësues për lëndët djegëse tatóhet me akcizë sipas të njëjtës tarifë tatimore dhe në bazë të të njëjtave kushte si për lëndët djegëse të cilën ka zëvendësuar.
2. Akciza do të llogaritet mbi çdo substancë që i shtohet lëndëve djegëse me të njëjtën tarifë dhe në bazë të të njëjtave kushte si për lëndët djegëse të cilat i janë shtuar kur përdorimi i kësaj substance është:
 - a. si lëndë djegëse për motorrë, mjete ose makineri të tjera;
 - b. si lëndë shtuese ose zgjeruese :
 - i. në çdo substancë për të cilën aplikohet akcizë, në bazë të pikës 1 të këtij neni
 - ii. në çdo nënprodukt nafte, që është përdorur ose do të përdoret, siç përmendet në paragrafin (a) me lart.
3. Çdo referencë për lëndët djegëse të përdorura në këtë ligj interpretohet si referencë ndaj çdo substance mbi të cilën është vendosur akciza sipas këtij neni, dhe në këtë mënyrë referencat ndaj akcizës mbi nënproduktet e naftës interpretohen si referenca ndaj akcizës së aplikuar ndaj çdo substance mbi të cilën vendoset akciza në bazë të këtij neni.
4. Organi tatimor mund të vendosë që çdo substancë ndaj të cilës është aplikuar akciza sipas këtij neni, të trajtohet për qëllime të këtij neni njëjloj si të ishte:
 - a. vaj i rëndë ose i lehtë;
 - b. benzinë për avione;
 - c. gazoil;
 - ç. benzinë me ose pa plumb.
 - d. vajguri
5. Organi tatimor mund të vendosë që çdo substancë e tatueshme me akcizë, sipas dispozitave të pikave (1) ose (2) të këtij neni, të tatóhet me akcizë me të njëjtën tarifë tatimore dhe të trajtohet, për qëllime të këtij ligji, njëjloj si të ishte një nga substancat e përshkruara specifíkisht në pikën (4) të këtij neni, me të cilin përafrohet më tepër.
6. Për qëllime të këtij neni, termi “lëng” nuk përfshin substancat që shndërrohen në gjendje të gaztë në një temperaturë prej 15°C dhe nën një trysni prej 1013.25 milibar.

Neni 39

Ngarkesat tregtare të disa mallrave të akcizës

1. Ngarkesat tregtare të produkteve të përpunuara të duhanit, alkolit, pijeve alkolike, nënprodukteve të naftës dhe verës mund të importohen dhe të zhvendosen nga pika doganore e hyrjes, ose të prodhohen dhe lëvizin nën regjimin e pezullimit tatimor nga një magazinë tatimore e miratuar e prodhimit, për përpunim të mëtejshëm, në një magazinë tjetër tatimore të miratuar kur plotësohen kushtet e mëposhtme;
 - a. kur importuesi ose prodhuesi është personi që do të përpunojë ngarkesën tregtare për të prodhuar produktet e gatshme;

- b. kur ngarkesa transportohet me një kontenier të sigurt sipas tipit të miratuar nga organi tatimor;
- c. kur kontenieri i miratuar si i sigurt, sipas shkronjës (b) të këtij neni, është i vulosur me vulë të numëruar, të një tipi të miratuar nga organi tatimor në vendin e nisjes dhe vula kontrollohet nga dogana në import (kur është e mundur) dhe nga punonjësit e autorizuar të organit tatimor me mbërritjen në magazinën tatimore të miratuar;
- d. kur hapja e kontenierit apo prishja e vulës bëhet në prani të punonjësit të autorizuar nga organi tatimor;
- e. kur të jetë bërë garancia e miratuar për vleftën e plotë të tatimit për ngarkesën përkatëse;
- f. kur plotësohet çdo kusht tjetër i vendosur nga organet tatimore, sipas udhëzimeve të Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.
2. Kur nuk plotësohen kërkesat e pikës (1) të këtij neni, akciza paguhet në përputhje me pikën (2) të nenit 21 të këtij ligji.

KREU VII

SHKELJET, KUNDERVAJTJET DHE SANKSIONET

Neni 40

Shkelja e detyrimit për pajisjen me autorizim akcize

Kur një person prodhon mallra akcize, pa qenë i autorizuar sipas nenit 4 të këtij ligji, i bëhet një vlerësim tatimor sipas nenit 14 të këtij ligji, për akcizën e papaguar mbi sasinë e mallrave të akcizës, të prodhuara para se të zbatohet shkelja dhe ndaj tij merren masat e mëposhtme:

- a. detyrohet të paguajë një gjobë në nivelin F të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji, plus dyfishin e tatimit të pagueshëm për mallrat e akcizës, të prodhuara ose të vlerësuara si të prodhuara nga organet tatimore;
- b. i sekuestrohen lëndët e para, makineritë e pajisje, mjetet ndihmëse, materialet e duhura për prodhimin e mallrave të akcizës dhe të gjitha mallrat e akcizës të gjendura në çfarëdo kohe në vendet, trojet, ndërtesat ose mjediset e tjera. Me mallrat e sekuestruara procedohet sipas legjislacionit në fuqi.
- c. Kur gjoba administrative e vendosur sipas shkronjës “a” të kësaj pike dhe/ose vlerësimi i vendosur sipas nenit 14 të këtij ligji nuk paguhet ose kur shkelja përsëritet, ndaj atij personi bëhet kallëzimi për ndjekje penale.

Neni 41

Shkelja e detyrimit për të kërkuar miratimin e një trualli, ndërtese ose mjedisi tjetër si magazine tatimore

Kur një personi i gjenden mallra akcize në çdo truall, ndërtese ose mjedis tjetër nën kontrollin e tij, por të pamiratuara si magazina tatimore dhe për këto mallra nuk është paguar akciza, i bëhet vlerësimi tatimor, sipas nenit 14 të këtij ligji, për akcizën e papaguar mbi mallrat e gjetura në atë truall, ndërtese ose mjedis tjetër, ose që vlerësohet të jenë larguar nga ky truall, ndërtese ose mjedis tjetër dhe ndaj këtij personi merren masat e mëposhtme:

- a) dënohet me gjobë të nivelit E, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji, plus dyfishin e akcizës së pagueshme për mallrat e akcizës, të gjetura në atë truall, ndërtesë ose mjedis tjetër ose që vlerësohet të jetë larguar nga ky truall, ndërtesë ose mjedis tjetër;
- b) i sekuestrohen të gjitha mallrat e akcizës që gjenden në këtë truall, ndërtesë ose mjedis tjetër, pavarësisht nëse për këto mallra është paguar akciza ose jo. Me mallrat e sekuestruara procedohet sipas legjislacionit në fuqi;
- c) kur gjoba administrative e vendosur sipas sipas shkronjës “a” të kësaj pike dhe/ose vlerësimi i vendosur sipas nenit 14 të këtij ligji nuk paguhet ose kur shkelja përseritet, ndaj atij personi bëhet kallzim për ndjekje penale.

Neni 42

Shkelja e detyrimit për t’u pajisur me autorizim akcize të përfaqësuesve tatimorë

Kur përfaqësuesi tatimor nuk respekton kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, ky i fundit dhe personi që përfaqëson dënohen me gjoba, në përputhje me nenin 40 të këtij ligji.

Neni 43

Shkelja e detyrimeve për mbajtjen e regjistrimeve

Mosmbajtja apo mosruajta e regjistrimeve për periudhën e caktuar ose mosdhënia e regjistrimeve, sipas kërkesës së organeve tatimore, dënohet me gjobë të nivelit D, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji.

Neni 44

Gjobat për fshehjen e qëllimshme të akcizës

Në çdo rast, kur në bazë të dispozitave të këtij ligji vërtetohet se veprimtaria e një personi përbën fshehje të akcizës:

- a. ai është i detyruar ta paguajë akcizën e fshehur;
- b. ai është i detyruar të paguajë gjobë sa dyfishi i akcizës së fshehur ose që konsiderohet e fshehur, për shkak të mosrespektimit të kushteve dhe të rregullave të parashikuara sipas këtij ligji;
- c. atij i sekuestrohen lëndët e para, mallrat e akcizës;
- d. në çdo rast të mosplotësimit të kushteve të shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, personit që ka bërë shkeljen i sekuestrohen magazinat tatimore dhe vendet, tokat, ndërtesat ose mjediset e tjera të tij që janë përdorur për fshehje të akcizës dhe bëhet kallzim për ndjekje penale kur dyshohet se ka elemente të kësaj veprë.

Neni 45

Pengesa dhe bllokimi i veprimtarisë së organeve tatimore

Pengesa dhe bllokimi i punonjësit të autorizuar të organeve tatimore ose personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e detyrave të tyre, për kontrollin e akcizës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një personi tjetër, kur nuk

është vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë të nivelit F, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji.

Neni 46

Kundërshtimi i personit për të kontrolluar automjetet ose mjetet lundruese

Nëse pas kërkesës së punonjësve të autorizuar të organeve tatimore për të ndaluar, personi i ngarkuar për çdo njërin nga automjetet ose anijet e tilla kundërshton të ndalojë ose të lejojë që automjeti ose mjete lundrues të kontrollohet:

- a. detyrohet të paguajë një gjobë të nivelit C, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji;
- b. nuk lejohet të largohet nga automjeti;
- c. bëhet kallzim për ndjekje penale dhe ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ndalimin e automjetit ose mjetit lundrues.

Neni 47

Shkelja e afatit kohor për pagesën e akcizës

Kur personi i autorizuar i akcizës nuk ka paguar shumën e caktuar brenda datës së caktuar, ai është i detyruar të paguajë një gjobë të nivelit B, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, ndryshuar me ligjin nr.9041, datë 27.03.2003, plus interesin e llogaritur në përputhje me ligjin nr.8980, datë 12.12.2002 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 48

Shkelja e afatit kohor për dorëzimin e deklaratës

Kur personi i autorizuar i akcizës nuk dorëzon deklaratën në datën e përcaktuar, në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, ai detyrohet të paguajë një gjobë të nivelit A, të shkallës standarte, sipas nenit 51 të këtij ligji, dhe për të bëhet një vlerësim sipas nenit 14 të këtij ligji.

Neni 49

Shkeljet për mbajtjen, transportin ose shitjen e mallrave të akcizës pa pullë dhe kodet e sigurise

1. Çdo mall akcize, për të cilin kërkohet pajisja me pulla akcize dhe kodet e sigurise, sipas dispozitave të neneve 25 e 27 të këtij ligji, konfiskohet kur:

- a) gjendet në magazinë, ofrohet për shitje apo tregtohet nga persona, përpunues, prodhues, importues të mallrave të akcizës, pa qenë i pajisur me pullë dhe kodet e sigurise, dhe personi që zotëron mallrat e akcizës dënohet në përputhje me dispozitat e

nenit 44 të këtij ligji, si dhe me gjobë të nivelit F të shkallës standarde, sipas nenit 51 të këtij ligji;

b) tregtohet nga persona, që janë subjekt i TVSH-së dhe i tatim-fitimit dhe gjenden pa pulla dhe kodet e sigurise, pavarësisht nga fakti se për to është paguar akciza ose jo dhe tatimpaguesi, që i tregton këto mallra akcize të papajisura me pulla dhe kodet e sigurise, dënohet me gjobë të nivelit F të shkallës standarde, sipas nenit 51 të këtij ligji;

c) tregtohet nga persona, që janë subjekt i ligjit për taksën vendore të biznesit të vogël dhe gjenden pa pulla dhe kodet e sigurise, pavarësisht nga fakti se për to është paguar akciza ose jo, dhe tatimpaguesi, që i tregton këto mallra akcize të papajisura me pulla dhe kodet e sigurise, dënohet me gjobë të nivelit E të shkallës standarde, sipas nenit 51 të këtij ligji.

2. Me mallrat e konfiskuara procedohet nga organet tatimore, duke i shkatërruar ose administruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Shkeljet për ndërhyrjet në pullat e akcizës dhe kodet e sigurise

Vendosja e pullave dhe kodet e sigurise të fallsifikuara ose të manipuluar në mallrat e akcizës ose fallsifikimi apo manipulimi i pullave të akcizës dhe kodet e sigurise ose heqja e tyre për ripërdorimin për të shmangur pagesën e akcizës, ose fallsifikimin apo vjedhjen e pullave të akcizës dhe kodet e sigurise, përbëjnë vepër penale dhe dënohen me gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së tregut të mallrave të akcizës, në të cilat janë vendosur ose synohet të vendoseshin këto pulla dhe kodet e sigurise, dhe me heqje lirie deri në 2 vjet.

Neni 51

Shkalla standarte e gjobave.

Shkalla standarte nënkupton gjobat e vendosura me poshtë:

Shkalla e references	Shuma e penaliteteve, lekë
A	20 000
B	50 000
C	100 000
D	250 000
E	500 000
F	1 000 000
G	2 000 000
H	5 000 000

Neni 52

Apelimet

Proçedurat e apelimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 53

Shfuqizimet

Ligjet nr. 8437, datë 28.12.1998 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, nr 8717, datë 15.12.2000 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkolike” si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, shfuqizohen.

Neni 54

Organet e ngarkuara me zbatimin e këtij ligji

Me zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Financave dhe organet tatimore.

Neni 55

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Financave, në zbatim të këtij ligji, nxjerr udhëzime:
 - a) për mënyrën e prodhimit, ambalazhimit, mbajtjes dhe magazinimit të mallrave të akcizës të prodhuara në vend dhe ambalazhimit, mbajtjen e magazinimit të mallrave të akcizës.
 - b) për të rregulluar dhënien e autorizimeve personave dhe miratimin e trojeve, ndërtesave ose mjediseve të tjera, si dhe për provokimin ose ndryshimin e autoriteteve ose miratimeve;
 - c) për të përcaktuar, sipas ose në përputhje me udhëzimet, se kur fillon dhe përfundon prodhimi i mallrave të akcizës;
 - ç) për të përcaktuar forcën, sasinë, vëllimin ose peshën e mallrave të akcizës për qëllime tatimore;
 - d) për të përcaktuar mënyrën e mbledhjes së akcizës;
 - dh) për të përcaktuar rregullat e kontrollit të përdorimit të lëndëve të para dhe për moslejimin e përdorimit të substancave shtesë, përzjerjen ose veprime të tjera në mallrat e akcizës ose që lidhen me këto mallra;
 - e) për të lejuar, në rrethana të caktuara, zbritjen ose rimbursimin e detyrimit për disa tipa të caktuar të mallrave të akcizës;
 - ë) për të rregulluar transportin e mallrave të akcizës;
 - f) për t'u kërkuar personave të autorizuar të akcizës mbajtjen e regjistrimeve;
 - g) për të përcaktuar mënyrën e prodhimit të pullave të akcizës, personat e duhur, natyrën dhe të dhënat e përmbajtura dhe dispozita të tjera për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave, si dhe tipin e përshkrimit të mallrave të akcizës, për të cilat kërkohet pajisja me pullë;

g/1) për përcaktimin e modaliteteve për zbatimin e pullave fiskale, duke përfshirë, por jo vetëm, prodhimin, pagesën e taksës së akcizës dhe shpenzimet për prodhimin e zbatimit e pullave të akcizës dhe kodin e sigurisë, të personave të autorizuar për të prodhuar dhe zbatuar, dhe karakteristikat e të dhënave që përmbajnë në kodet e sigurisë së pullave të akcizës, si dhe dispozita të tjera, që lidhen me mallrat e akcizës, që duhet t'i aplikohen pullat e akcizës dhe kodet e sigurisë.

gj) për zbatimin e neneve 4, 5, 6, 10, 11, 12, 19, 22, 23, 24, 24/1, 24/2, 25, 26, 27, 28,32, 36, 37, 38 dhe 39 të këtij ligji.

2. Në udhëzimet e Ministrit të Financave parashikohen rregulla normative të posaçme, në varësi të kategorive të personave, trojeve, ndërtesave ose mjediseve të tjera, ose mallra akcize të llojeve dhe përshkrimeve të ndryshme.

Neni 56

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet e tij ligjore më 1 Korrik 2003.

K R Y E T A R I

Servet PELLUMBI

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur nga Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, me Dekret nr.3647, datë 08.01.2003.

Ndryshuar me:

Ligjin Nr. 9041, datë 27.03.2003

Ligjin Nr. 9163, datë 18.12.2003

Ligjin Nr .9269, date 29.07.2004

Ligjin Nr. 9328, datë 06.12.2004

Ligjin Nr. 9546, date 29.05.2006

Ligjin Nr. 9598, date 27.07.2006

Ligjin Nr. 9714, date 16.04.2007

Ligjin Nr. 9765, date 09.07.2007

Ligjin Nr. 9854, date 26.12.2007

Ligjin Nr. 9945, date 26.06.2008

Ligjin Nr. 10067 datë 02.02.2009

F.Zyrtare 103

F.Zyrtare 63

F.Zyrtare 84

F.Zyrtare 54

F.Zyrtare 90

F.Zyrtare 184

F.Zyrtare 114

F. Zyrtare 19 datë 27.02.2009

Ligjin Nr. 10147, datë 28.9.2009 botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 144, dt. 12.10.2009

Ligjin Nr. 10210, dt. 23.12.2009. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 194, dhjetor 2009.

Ligjin nr. 10286, dt. 03.06.2010. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 79, dt. 02. Korrik 2010.

Ligjin 10365, dt. 16.12.2010. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 179, dhjetor 2010.

Ligjin Nr. 10404, dt. 24.3.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 46, date 26.04.2011.

Ligjin Nr. 10456, dt. 21.07.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 107, date 09.08.2011.

SHTOJCA NR. 1 MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË R.SH.

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore
I KAFE		
09 01 1100 09	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	30 lekë/kg
09 012100 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	140 lekë/kg
09 01 9021	Lëkura dhe lëvoret e kafesë, zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
II BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE		
22 03	Birrë e bërë nga malto - nga prodhues vendas e të huaj me sasi deri në 70 000 hektolitra në vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 70 001 deri në 200 000 hektolitra në vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 200 001 deri në 300 000 hektolitra në vit	10 lekë/litri 12 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitra/vit	20 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 300 hektolitra/vit	20 lekë/litri 35 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të	20 lekë/litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatruar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi	
	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000	220 lekë/litri 300 lekë/litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri	100 lekë litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë/litri
III DUHANI DHE NËNPRODUKTET E TIJ DUHAN DHE NËNPRODUKTET E		

24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	70 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
IV	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 11	Naftë virgine	50 lekë/litri
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49 27 10 11 51 27 10 11 59	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol), Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se	37 lekë/litri 50 lekë/litri
27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20
27 10 19 31 deri 27 10 19	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
27 10 19 71 deri 27 10 19	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
27 13 1100 27 13 12	Koks naftë	2 lekë/kg
27 13 20 00	Bitum naftë	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyral; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet të asfaltit dhe të bitumit)	5 lekë/kg
29 0129 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike, përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	37 lekë/kg
34 03 19 91 34 03	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
V	FISHEKZJARRËT	
36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
VI	GOMAT	
40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
VII	PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË	

85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshi ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshi katrorët)	20 lekë/kg
VIII AMBALAZHET		
	AMBALAZHET: Ambalazhet e plastikës Ambalazhet e çelikut	100 lekë/kg 10 lekë/kg 20 lekë/kg
IX LLAMBA INKANDESHENTE		
85 39 22 10	Llambat reflektor	100 lekë/copa
85 39 22 90	Të tjera	100 lekë/copa
85 39 29 92	Më tepër se 100 V	100 lekë/copa
85 39 29 98	Jo më tepër se 100V	100 lekë/copa

SHTOJCA 2/1

Çmimi (duke përjashtuar çdo TVSH dhe çdo takse tjeter apo detyrime pulle te aplikueshme, sipas ligjit shqiptar) per çdo pulle fiskale individuale te prodhuar dhe te shperndare nga koncensionari.

Produkti	Lloji i pulles fiskale	Çmimi per nje mije (ne €, perjashto TVSH-ne dhe taksa te tjera)
Duhan	Pulla e akcizes	€ 20.00
Alkool	Pulla e akcizes	€ 32.00
Birre	Kodi i sigurise/ Pulla e akcizes	€ 22.00

LIGJ
Nr.9975, datë 28.7.2008

PËR TAKSAT KOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton llojet e taksave kombëtare, që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, si dhe detyrimetqëkanë agjentët e taksave kombëtare.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Taksapagues" është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njëren nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. "Taksë" është taksë kombëtare e vendosur me këtë ligj.
3. "Agjent i taksave" është personi, i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e Buxhetit të Shtetit të të ardhurave nga taksat kombëtare.

Neni 3

Llojet e taksave kombëtare

Taksat kombëtare janë:

1. Taksë portuale.

2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49).

3. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

4. Taksa e rentës minerare.

5. Taksa e akteve dhe e pullës.

6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59), për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49) dhe për qymyrin, me krerë tariforë të NKM-së 2701 dhe 2702.

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.

Neni 4*

Niveli i taksave kombëtare

1. Taksa portuale është 1 euro. Kjo taksë paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.

2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 5 lekë për litër deri më 31.12.2011, pas kësaj date taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 7 lekë për litër. Kjo taksë zbatohet si për benzinën dhe gazoilin e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.

3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij ligji, dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. 18 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisve të qeverisjes vendore.

4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte

minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. 25 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Vlera në përqindje e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin mineral, ndryshon sipas paragrafëve të parë e të dytë të pikës 4 të nenit 4 të këtij ligji. Përcaktimi i vlerës së rentës së pasurisë minerare, për të gjitha mineralet, sipas përcaktimeve të ligjit, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit të rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes. Në mungesë të këtij dokumentacioni, organi i ngarkuar nga ky ligj për arkëtimin e taksës së rentës minerare, bën rivlerësimin, mbështetur në metoda alternative.

5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë për litër për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks nafte.

7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas shtojcës nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Agjentët e taksave

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile;

dh) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koxin e naftës e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koxin e naftës të prodhuar në vend, në bazë të sasive të prodhimit.

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

Neni 6

Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit dhe në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Agjentët e taksave janë të detyruar t'i transferojnë taksat e vjela në Buxhetin e Shtetit dhe në llogari të bashkive ose të komunave, sipas nenit 5 të këtij ligji, brenda datës 30 të muajit kur janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave vjetore për herë të parë lind në 6-mujorin e parë, paguhet 100 për qind e taksës, ndërsa kur ky detyrim lind në 6-mujorin e dytë, paguhet 50 për qind e masës së këtyre taksave.

Neni 7

Taksat që vilen nëpërmjet pullës

Taksat kombëtare, që vilen nëpërmjet pullës, janë **taksa vjetore e mjeteve të përdorura** dhe taksa e akteve të gjendjes civile.

Neni 8

Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji dhe transferohen, sipas tarifave të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, në llogaritë e të ardhurave tatimore të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Agjentëve të taksave, për shërbimin që kryejnë, u jepet komisioni përkatës, në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje në bazë të masës së taksave që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore. Masa në përqindje e komisionit është si më poshtë:

a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve) 2 për qind;

b) për taksën e qarkullimit, 0 përqind.

c) për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 5 për qind.

ç) për taksën e akteve dhe të pullës 5 për qind;

d) për taksën e rentës minerare (Royalty) 0 për qind;

dh) për taksën e karbonit, 0 për qind.

3. Komisionet e përfituara përdoren:

a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;

c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Neni 9

Përrjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik, ose do të dalin përrfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përrgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, prokurorisë, etj., për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar;

ç) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përrkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

d) makinat bujqësore.”.

2. Përrjashtohen nga pagimi i taksës së mjeteve të përdorura të transportit, në import dhe nëshitje, autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përrkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private.

3. Përrjashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

Neni 10

Shkeljet dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.
2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Tarifa shërbimi

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:
 - a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
 - b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;
 - c) **tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit;**
 - ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
 - d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);
 - dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;
 - e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
 - ë) **tarifa e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë përcaktohet me reciprocitet.**
 - f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.
2. Të gjitha detyrimet e prapambetura të tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja falen. Procedurat e faljes së tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.
2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.”

Neni 11/1

Përfshirjet nga pagesa e tarifave të shërbimit

1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbrit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, përfshihen nga:
 - a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona

Ligj Nr. 9975, date 28.7.2008

jashtë vendit;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;

c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;

ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.

Neni 12

Shfuqizimet

Ligji nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5862, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 128 datë 04.08.2008

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7072, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Ndryshuar me Ligj Nr.10 065, datë 29.1.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 9 datë 09.02.2009.

Ndryshuar me Ligjin 10 131 dt. 11.5.2009, Fletorja Zyrtare nr. 86. Dt. 12.6.2009

Ndryshuar me Ligj nr. 10145, date 28.9.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 144 dt. 12 tetor 2009.

Ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 73, dt. 29.qershor 2010

LIGJNr.10 458, datë 21.7.2011

***** Ndryshuar me Ligj Nr. 10458, date 21.7.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 107, date 9.08.2011.**

Shtojca Nr.1

KOEFIÇIENTËT SIPAS VJETËRSISË PËR TAKSËN VJETORE TË MJETE TË PËRDORURA

Motomjete, autovetura, automjete per transport te perzier		Të gjitha llojet e tjera		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2011

Ligj Nr. 9975, date 28.7.2008

16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

Shënim: Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,0, ndërsa për motomjetet, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.

SHTOJCA NR.2

PËRQINDJA E RENTËS MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit minerar	Përqindja e rentës minerare
I	Grupi i parë (I)MINERALET METALIKE	
1	Mineralet e argjendit	10
2	Mineralet e arit	10
3	Mineralet e bakrit	6
4	Mineralet e Kromit	6
5	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6
6	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5
7	Mineralet Plumbit	5
8	Mineralet e Zinkut	7

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2011

Ligj Nr. 9975, date 28.7.2008

9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4
II	Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE	
10	Të gjitha mineralet jometalike	4
III	Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET	
11	Qymyret	5
12	Bitumet	5
13	Rërat bituminoze	5
14	Reshpet naftore	5
15	Pirobitumet	6
IV	Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT	
16	Graniti	6
17	Gëlqerorët	5
18	Gabrot	5
19	Bazaltet	4
20	Konglomerate	7
21	Mermeri	7
22	Pllakat e ndërtimit	7
23	Pllagjiogranitet	5
24	Ranoret	7
25	Serpentinitet	5
26	Travertinat	5
27	Traktolitet	5
28	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	5
V	Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR	
29	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10
VI	Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI	
30	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10
31	Grupi i shtatë (VII) NAFTA DHE GAZI	10

Shtojca nr.3

TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

	Masa e taksës (në lekë)
1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
2. Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë për lidhje martesë” në gjuhë të huaj	200 lekë
3. Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë lindjeje” në gjuhë të huaj	200 lekë
4. Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë martesë” në gjuhë të huaj	200 lekë
5. Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
6. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë
7. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
8. Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve	1 000 lekë

SHTOJCA NR.4
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
PESHKIMIT

	Lekë në vit
I. Peshkimi detar (për 1 anije)	
1. Peshkimi detar fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- mbi 410 HP	80 000
3. Peshkimi pellagjik me tratavolante:	
- anije 160-200 HP	20 000
- anije 201-410 HP	30 000
- anije mbi 410 HP	40 000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime:	

- anije 80-200 HP	10 000
- anije 201-410 HP	20 000
- anije mbi 410 HP	30 000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:	
- anije 160-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	60 000
- anije mbi 410 HP	90 000
5. Peshkimi me mjete selektike:	
- anije 40 - 80 HP	15 000
- anije 81-160 HP	25 000
- anije 161-200 HP	40 000
- anije 201-410 HP	50 000
- anije mbi 410 HP	80 000
6. Peshkimi i molusqeve bivalvore (i autorizuar)	60 000
II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:	
1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri në 40HP)	7 000
2. Peshkimi në lagunat bregdetare:	
- në lagunë (1 lundror)	10 000
- në dajlane (1 peshkatar)	12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror)	5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore	

me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar	20 000
III. Peshkimi sportiv në det	
me mjete lundruese (për 1 mjet)	40 000
IV. Akuakultura:	
1. Kultivimi i midhjeve për një impiant	10 000
2. Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë	1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë	10 000

Shënim: Për anijet e huaja që marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë është sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuara nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (Drejtoria e Politikave të Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.

LIGJ
Nr.9632, datë 30.10.2006

PËR
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji janë taksat e bashkive dhe të komunave.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji:

1. Termat e përdorur do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

2. “Tokë bujqësore” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

3. “Zyrë e taksave” është njësi organizative që, me Vendimin e Këshillit të Bashkisë ose komunës, ngarkohet për administrimin e taksave vendore.

4. “Organet tatimore të pushtetit qendror” janë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatim-taksave në rrethe.

5. “Nivel tregues i taksës” është niveli i taksës mbi biznesin e vogël, i parashikuar në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

6. “Arka regjistruese” janë kasat regjistruese elektronike, të detyrueshme për lëshimin e kuponave tatimorë nga biznesi, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe me udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 4

Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë

1. Bashkitë, komunat dhe organet tatimore i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyruës për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për aq sa këto të fundit nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

2. Zyra e taksave të bashkisë apo komunës vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Policia bashkiake ose e komunës mbështet inspektorët e taksave të bashkisë ose komunës në veprimtarinë e tyre, kur gjykohet e nevojshme dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas nenit 5 të këtij ligji.

4. Organet tatimore të pushtetit qendror, për administrimin në tërësi të sistemit tatimor, ndërmarrin edhe veprime vlerësimi dhe kontrolli për çështje që lidhen ose ndikojnë në administrimin e tatimeve ose të taksave kombëtare. Zyrat e taksave të bashkive dhe të komunave njoftojnë dhe mbështesin organet tatimore të pushtetit qendror, kur u kërkohet prej këtyre të fundit.

5. Organet tatimore të pushtetit qendror, me kërkesë të bashkisë ose komunës, mbështesin veprimtarinë e tyre për administrimin e taksave vendore. Palët mund të bashkëpunojnë mbi bazën e mirëkuptimit ose bazuar në një marrëveshje tip të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet bashkive, komunave, ndërmjet bashkive dhe komunave, këtyre të fundit dhe organeve tatimore të pushtetit qendror, për çështje që kanë të bëjnë me kompetencën e juridiksionit mbi taksën vendore, bëhet me mirëkuptim. Në të kundërt, palët i drejtohen gjykatës.

7. Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzime, në zbatim të këtij neni, për sigurimin e uniformitetit minimal e të domosdoshëm të standarteve procedurale e të raportimit të sistemit të taksave vendore.

Neni 5

Rregulla të përbashkëta për taksat vendore

Me përjashtimtë të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë ose i komunës:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me

kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës.

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;

ç) përcakton:

i) detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave;

ii) mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta;

iii) rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake e të komunës, në mbështetje të administrimit të taksave vendore;

iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore;

v) kriteret dhe procedurat e mardhenieve me taksapaguesit, përfshirë te drejten e tyre të ankimit;

vi) mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative.

Neni 6

Përrjashtimi nga taksat

Përrjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta. Përr përrjashtimet nga taksat vendore, të cilat aplikohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushteti vendor do të kompensohet përr efektet financiare nga Buxheti i Shtetit.

Neni 7

Ankimi

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor kundërr vendimit apo veprimit të zyrës së taksave bëhet te kryetari i bashkisë ose komunës, sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak ose komunal, në përrputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundërr vendimit të kryetarit të bashkisë ose komunës.

Neni 8

Të drejtat e tatimpaguesit

Tatimpaguesi kërrkon të drejtat në përrputhje me procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe me këtë ligj.

KREU II TAKSAT VENDORE

Neni 9

Llojet e taksave vendore

Në taksat vendore përrfshihen:

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël;
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përrfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore;
3. Taksa e fjetjes në hotel;

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
6. SHFUQIZOHET
7. Taksa për zënien e hapësirave publike;
8. Taksa e tabelës;
9. Taksa të përkohshme.

KREU III TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Neni 10

Subjektet e tatimit mbi biznesin e vogël

1. “Biznes” është çdo veprimtari ekonomike nga çdo subjekt, që ka për qëllim realizimin e fitimit.
2. “Vendndodhje e biznesit” është çdo dyqan, njësi e veçantë ose vende të tjera të palëvizshme, ku kryhet biznes. Kur nuk ekziston një vend fiks biznesi, vendndodhja e biznesit, që ushtrohet nga nje person fizik, është banesa private e taksapaguesit.
3. Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.
4. E ardhura nga taksa vendore mbi biznesin e vogël i takon asaj njësie të qeverisjes vendore, në territorin e juridiksionit të së cilës gjendet vendndodhja e biznesit.
5. Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Periudha e detyrimit vjetor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit në vazhdim. Nëse veprimtaria e biznesit krijohet ose pushon brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

Neni 11

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël

1. Kategoritë minimale të bazës së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe nivelet treguese të taksës, për çdo kategori, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Detyrimi i taksës për t'u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij,. Kategoritë e biznesit paraqiten në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.
3. Kur një subjekt kryen më shumë se një lloj biznesi, në të njëjtin vend, që përkon me kategori të ndryshme të bazës së taksës, niveli tregues i taksës, në varësi të kategorisë, përcaktohet sipas llojit të veprimtarisë, që ka qarkullim më të madh vjetor. Për përcaktimin e detyrimit fiskal, llojet e tjera të biznesit, që kryhen në këtë vend, vlerësohen të të njëjtit tip dhe qarkullimi llogaritet si shumë e qarkullimeve të të gjitha këtyre bizneseve.
4. Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milion lekësh, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet

këtij ligji. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milion lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milion lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë, përjashtuar rastet e ambulantëve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të njëjtin aneks, që i bashkëlidhet këtij ligji.

5. Këshilli bashkiak ose komunal vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 5 të këtij ligji, **në kufijtë plus 10/minus 30 për qind**, të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse dhe për çdo interval të qarkullimit, në përputhje me udhëzimet përkatëse.

6. Kur këshilli bashkiak ose komunal, për një kategori minimale të bazës së taksës, miraton nënkategori, ai përcakton detyrimisht edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.

7. Bizneseve, objekt i këtij ligji, të cilat, në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në bazë të vendimit nr. 781, date 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kanë detyrimin për instalimin e pajisjeve fiskale dhe kanë bërë pagesën e blerjes së pajisjes së parë fiskale deri në datën 28.2.2011 nga “Shoqëritë e autorizuara sipas kontratës përkatëse”, u rimburohet kjo pagesë deri në shumën 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë. TVSH-ja e pajisjes fiskale është e kreditueshme ndaj TVSH-së së llogaritur për bizneset e vogla të regjistruara në TVSH, si dhe për të gjitha bizneset e vogla që regjistrohen në TVSH deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Rimbursimi kryhet në çastin e pagesës së këstit/këstevepasardhës/pasardhëse të taksës së biznesit të vogël.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit.

7.1. Bizneseve që operojnë në fushën e transportit, përcaktuar në shtojcën 5 të këtij ligji, dhe që kanë detyrimin për t'u pajisur me taksimetër, u rimburohet pagesa e bërë për blerjen e taksimetrit, sipas kontratës përkatëse, deri në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Rimbursimi kryhet në çastin e pagesës së këstit/këstevepasardhës/pasardhëse të taksës së biznesit të vogël.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit.

7.2. Bashkitë dhe komunat kompensohen nga Buxheti i Shtetit për efektet e rimbursimit prej tyre të pajisjeve fiskale.

8. Këshilli bashkiak ose komunal vendos për lehtësimin apo përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për tatimpaguesin, veprimtaria e të cilit, si biznes i vogël, është sëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet, rast pas rasti, nga këshilli i bashkisë ose komunës, me propozimin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 12 Regjistrimi dhe licensimi

1. Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm.
2. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
3. Ndryshimet e fushës së veprimtarisë së tatimpaguesve, subjekte të këtij ligji, deklarohen pranë bashkisë/komunës, brenda territorit të së cilës ushtrojnë veprimtarinë. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin që mbulon çështjet e pushtetit vendor, përcakton me udhëzim procedurat për deklarimin e këtyre ndryshimeve.

Neni 13 Detyrimi për informim

1. SHFUQIZOHET

2. Taksapaguesi ka detyrimin të afishojë dukshëm në vendndodhjen e biznesit certifikatën e regjistrimit. Nëse nuk ka një vendndodhje fikse për veprimtarinë ekonomike, taksapaguesi detyrohet ta paraqesë certifikatën sa herë që i kërkohet nga nëpunësi përgjegjës i bashkisë ose komunës, si dhe nga organet tatimore të pushtetit qendror.

Neni 14

Pagesa

1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

2. Nëse tatimpaguesi në çastin e regjistrimit ka dhënë informacion të pasaktë dhe kur shuma për t'u paguar është më e madhe sesa shuma e paguar, zyra e taksave duhet ta njoftojë tatimpaguesin, i cili paguan detyrimin tatimor shtesë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Kur tatimpaguesi, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit nga zyra e taksave, nuk paguan detyrimin tatimor shtesë, zbatohen sanksionet përkatëse.

3. Kur një biznes mbyllet gjatë vitit dhe vlera e detyrimit tatimor, që duhet të paguajë tatimpaguesi, është më e vogël se tatimi i paguar, diferenca i kthehet tatimpaguesit brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për mbylljen e biznesit. Kthimi i diferencës dhe afati zbatohet edhe në çdo rast, kur vlerësohet nga organi përkatës se detyrimi i tatimpaguesit është më i vogël se ai i paguar efektivisht.

4. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, transferohet në buxhetin e bashkisë ose komunës, ku ka vendndodhje biznesi i taksueshëm.

Neni 15 Mbajtja e regjistrimeve

1. Taksapaguesi detyrohet të mbajë librin e shitjeve (qarkullimit) dhe librin e blerjeve, ku regjistrohen çdo ditë shitjet dhe blerjet ditore. Formati i këtyre librave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

2. Tatimpaguesit, shitës me pakicë të mallrave ose të shërbimeve, të pajisur me pajisje fiskale, lëshojnë kupon tatimor për çdo shitje. Tatimpaguesit e tjerë, që, në bazë të ligjit nr. 9920, date 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në bazë të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nuk janë subjekt i detyrimit për instalimin e pajisjeve fiskale, për çdo shitje të kryer, lëshojnë dëftesë tatimore. Mënyra e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Libri i shitjeve (qarkullimit) dhe fatura e thjeshtë tatimore prodhohen dhe shpërndahen nga organet tatimore, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 16 Verifikimi

Taksapaguesi është i detyruar të paraqesë çdo dokument, të përcaktuar në këtë kre, për detyrimin për pagimin e taksave, kur këto i kërkohen nga inspektori i zyrës së taksave, në juridiksionin e së cilës ushtrohet biznesi, si dhe nga inspektori i organeve tatimore të pushtetit qendror, si dhe t'i lejojë ata të hyjnë në mjediset, ku ushtrohet biznesi, për qëllime verifikimi të të dhënave të regjistrimit dhe për kontrollin e certifikatës së regjistrimit.

Neni 17¹ Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për taksën vendore mbi biznesin e vogël, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa mosafishimi ose mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit dënohet me gjobë 5.000 lekë

Neni 18 Ankimi

1. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën sesi janë vlerësuar detyrimet e tij të taksave, të kërkojë rimbursime, si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi të zyrës së taksave.

2. Çdo ankim paraqitet te kryetari i bashkisë ose komunës brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin administrativ, i cili shqyrton ankimin dhe merr vendimi brenda 30 ditëve nga çasti i depozitimit. Ankimi ndaj këtij vendimi në gjykatë bëhet brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes dijeni për vendimin e mësipërm.

3. Kur shqyrtohet një ankim, subjekti ankimes ka të njëjtat të drejta me zyrën e taksave.

4. Apelimi nuk mund të tërhiqet në rastet kur sillen fakte shtesë, që vërtetojnë se shuma e detyrimit për taksën e vlerësura nuk është e saktë.

Neni 19 Kualifikimi si biznes i vogël

1. Bashkitë dhe komunat, sa herë që vlerësojnë se një biznes nuk përmbush kushtet për t'u kualifikuar si biznes i vogël, kryejnë çregjistrimin e tij dhe njoftojnë organin tatimor të pushtetit qendror përkatës. Që nga ky çast tatimpaguesi dhe veprimtaria e tij vendosen nën juridiksionin e organit tatimor të pushtetit qendror.

2. Organet tatimore të pushtetit qendror mund të kryejnë vetë ose në bashkëpunim me bashkinë dhe komunën verifikimin e përmbushjes së kushteve të kualifikimit të një biznesi si biznes i vogël. Kur ato vërejnë raste të mospërmbushjes së këtyre kushteve, kryejnë regjistrimin e këtij biznesi dhe e kalojnë atë nën juridiksionin e tyre. Organi tatimor i pushtetit qendror njofton menjëherë bashkinë ose komunën përkatëse, e cila kryen çregjistrimin e tatimpaguesit me të marrë këtë njoftim.

3. Kur organet tatimore të pushtetit qendror vlerësojnë se një veprimtari biznesi, e regjistruar si subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, plotëson kushtet për t'u kualifikuar si veprimtari e biznesit të vogël, kryejnë çregjistrimin e saj dhe njoftojnë për këtë qëllim bashkinë ose komunën përkatëse për regjistrimin si veprimtari e biznesit të vogël. Që nga ky çast, taksapaguesi dhe veprimtaria e tij vihen nën juridiksionin e bashkisë ose komunës. Për qëllimet e këtij vlerësimi, përveç kërkesës dhe të dhënave të paraqitura nga vetë taksapaguesi, organet tatimore të pushtetit qendror pranojnë dhe shqyrtojnë edhe informacionet e dhëna ose kërkesat e kryera nga bashkia apo komuna.

4. Ndaj vlerësimeve të organit tatimor të pushtetit qendror apo të bashkisë ose komunës, të kryera sipas pikave të mësipërme të këtij neni, tatimpaguesi mund të ankohet, sipas rastit, në sistemin e administratës tatimore qendrore ose vendore, në përputhje me ligjin „Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe më pas në gjykatë.

KREU IV

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 20 Përcaktimi dhe llojet

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron.

2. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore.

Neni 21

Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

2. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën dhe për taksën mbi tokën bujqësore jepen, përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që I bashklidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

3. Këshilli bashkiak ose komunal vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në anekset 1 e 2, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse. [Ndërsa për tatimpaguesit e biznesit të vogël kufijtë janë plus 10/minus 30 për qind.](#)

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak ose komunal miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshilli bashkiak ose komunal vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;

b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak ose këshilli komunal, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Neni 22

Taksa mbi ndërtesat

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet të këtij ligji. Për çdo kategori minimale të ndërtesave, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nënkategorizime të ndërtesave, që ndodhen brenda territorit që mbulon.

[Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa Brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.](#)

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme.

3. Të ardhurat e realizuara nga taksa mbi ndërtesat i takojnë 100 për qind bashkisë ose komunës, ku realizohet kjo taksë.

4. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- c) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.

Neni 23

Taksa mbi tokën bujqësore

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji.

3. Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufutrore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë ose komunës, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Neni 24

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të komunës njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe komunave për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe komunat për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të komunës, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë ose komunës vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë ose komunës.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo reregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse

dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë apo komunës, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25

Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose komune, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

KREU V TAKSA TË TJERA VENDORE

Neni 26

Taksa e fjetjes në hotel

1. Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë.

3. Niveli i taksës është deri në 5 për qind të çmimit të fjetjes.

4. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë kategori dhe nënkategori për klasifikimin e hoteleve, si dhe të vendosë për nivelin përkatës të taksës, brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia ose komuna me çmimin e fjetjes dhe numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

6. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

7. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Neni 27

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri, që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind të kësaj vlere, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind e saj. "Përjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të

infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar."

2/1. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

3. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

4. Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë ose të komunës, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

5. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një njësie vendore ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një njësie tjetër vendore, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.

Neni 28

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

3. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Neni 29

Përrjashtime nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Neni 30 SHFUQIZOHET

Neni 31 SHFUQIZOHET

Neni 32 Taksa të tjera

1. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal vendos:

a) nivelin e taksës për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi; dhe

b) SHFUQIZOHET

c) bazën dhe nivelin për taksën e tabelës.

2. Në rastin e taksës për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi:

a) taksat llogariten si detyrim mujor i taksapaguesit;

b) baza e taksës shprehet në metër katror sipërfaqe publike të zënë;

c) niveli tregues i taksës jepet në aneksin 6 të këtij ligji;

ç) këshilli i bashkisë ose komunës, në kufijtë plus 10/minus 30 për qind

të nivelit tregues të taksës, mund të caktojë nivele të ndryshme të taksës, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

Neni 32/1 Taksa e tabelës

Kategoritë e bazës së taksës së tabelës dhe niveli i tyre jepen në aneksin nr.7, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Aneksi 7. Taksa e tabelës

Kategoritë	Niveli i taksës
1) Tabelë për qëllime identifikimi: a) Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	120 lekë/vit

b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit
2) Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: a) Për Bashkinë e Tiranës b) Për bashkitë qendër qarku c) Për bashkitë e tjera dhe komunitat	45 000 lekë/m ² /vit deri në sipërfaqen 18 m ² . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m ² paguhet 810 000 lekë/vit. 22 500 lekë/m ² /vit deri në sipërfaqen 18 m ² . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m ² paguhet 405 000 lekë/vit. 13 500 lekë/m ² /vit deri në sipërfaqen 18 m ² . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m ² paguhet 243 000 lekë/vit
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. 1000 lekë/m ² /ditë.	1000 lekë/m ² /ditë

Neni 33

Taksat e përkohshme vendore

Këshilli bashkiak ose komunal, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Masa e taksave me karakter të përkohshëm, së bashku me taksat dhe tarifat e aplikueshme, nuk duhet të kalojnë kufirin plus 10 për qind të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të këtij biznesi.”.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 34¹

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

KREU VII

TARIFAT VENDORE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Neni 35

Tarifat vendore dhe administrimi i tyre

1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent, por në asnjë rast shuma e tarifave vendore, të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël, nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.”.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

Fillimi i ushtrimit të kompetencave

1. Ushtrimi i kompetencave të këtij ligji nga bashkitë, komunat dhe qarqet fillon në datën 1 janar 2007.

2. Organet tatimore të pushtetit qendror, nga njëra anë dhe bashkitë e komunat, nga ana tjetër, bashkëpunojnë për të bërë kalimin e kompetencave për administrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe të të gjithë dokumentacionit përkatës, si dhe për mënyrën e procedimit, brenda vitit kalendarik 2006.

Çdo bashki e komunë kompensohet financiarisht, në përpjestim me koston e ulur të shpenzimeve administrative të administratës tatimore qendrore, për shkak të kalimit të kompetencave të administrimit në pushtetin vendor. Ky kompensim përdoret nga bashkitë e komunat për të përballuar koston administrative shtesë për administrimin e kësaj takse.

Neni 37

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministri i Financave nxjerr aktet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me përgjegjësitë e dhëna, sipas neneve 8 e 9 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 38

Shfuqizime

Ligji nr.7805, datë 16.3.1994 “Për tatimin mbi pasurinë”; paragrafi i dytë i nenit 51 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar; ligji nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; nenet 32/1, 32/2, 32/3, 32/4, 32/5, 35/6, 32/7 dhe 32/8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; ligji nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, i ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera nënligjore, për aq sa bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 39 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2007.

*** Ndryshimet e bëra në nenin 12 dhe 13 të këtij ligji hyjnë në fuqi më 01. shtator 2007.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 5118, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Alfred Moisiu.

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 123 datë 27 nëntor 2006.

* Ndryshuar me ligj nr. 9745 datë 28.05.07; botuar në F.Z. nr. 73, datë 19.06.2007.

* Ndryshuar me ligj nr. 9764, datë 09.07.2007, botuar në fletoren zyrtare nr. 90 datë 21.07.2007

¹ Ndryshuar me Ligj Nr. 9931, datë 09.06.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 102 datë 01.07.2008

*Ndryshuar me Ligj Nr. 10 073, datë 9.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, date 04.03.2009.

*** Ndryshuar me ligj nr. 10117 dt. 23.4.2009, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 62, date 14.5.2009

*** Ndryshuar me ligj nr. 10146 dt.28.9.2009, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 144, date 12.10.2009. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

*** Ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , date 18.11.2010. Ky ndryshim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 166, date 15 dhjetor 2010.

***Ndryshuar me Ligj Nr. 10457, date 21.07.2011. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 107, date 09.08.2011.

ANEKS 1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë minimale të ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër	Të gjitha bashkitë e tjera

		Kavajë Lezhë	
Lekë/m ² në vit			
I. Ndërtesa banimi			
- ndërtuar para 1993-shit	15	10	5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993-shit	30	12	6
II. Ndërtesa të tjera			
- për tregti dhe shërbime	200	150	100
- të tjera	50	30	20
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	200	200	200

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për ndërtesat në zonat urbane (bashkitë), si dhe për ndërtesat në të gjithë zonat (urbane dhe rurale) të seksionit III të tabelës “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike”.

Shënim II: Në zonat rurale (komunat), niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës (përfshirë seksionin III) është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

ANEKS 2

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE
 TË TAKSËS MBI TOKËN BUJQËSORE

1	Klasifikimi sipas rretheve		
	2	3	3
Tiranë	Shkodër	Gjirokastrë	Bulqizë
Durrës	Elbasan	Përmet	Has
Kavajë	Berat	Pogradec	Kukës
Krujë	Korçë	Librazhd	Tropojë
Lezhë	Delvinë	Dibër	Pukë
Lushnjë	Kurbin	Mat	Mirditë
Fier	Peqin	Skrapar	Malësi e Madhe
Vlorë	Kuçovë	Mallakastër	Gramsh
Sarandë		Devoll	Ersekë
		Tepelenë	

Vlera e taksës në lekë/hektar/vit

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës				
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

ANEKS 3

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë e ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m ²			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
II. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për bashkitë.

Shënim II: Të gjitha komunat zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3 të bashkive.

ANEKS 4

TAKSAT VJETORE PËR RREGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË MJETEVE

Nr.	Tipi i mjetit	Taksë regjistrimi (në lekë)
1.	Çiklomotorë	0
2.	Motomjete	600
3.	Automjete: Autoveturë <=4+1 vende, benzinë Autoveturë <=4+1 vende, naftë Autoveturë >4+1 deri <= 8+1 vende, benzinë Autoveturë >4+1 deri <= 8+1 vende, naftë	2 400 2 400 4 800 4 800
4.	Automjet transporti i përzier deri 3t Automjet transport i përzier 3t deri <=3,5t	3 600 3 600
5.	Kaminon: Nga 3,5t – 7,5t Nga 7,5t – 18t Më i madh se 18t	4 800 6 000 8 000
6.	Autobuzë: Nga 8+1 deri <=32+1 vende >32+1 deri <=42+1 vende Mbi 42+1 vende, artikularë	6 000 7 200 8 400
7.	Automjet për përdorim të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
8.	Automjet transport të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
9.	Tërheqës rrugor	6 000
10.	Autokamp	4 800
11.	Rimorkio: <= 750 kg (karrel) shtojcë nga > 750kg deri në <= 1500 kg Nga > 1500 kg deri në <= 7000 kg Më i madh se 7000 kg	3 000 3 000 3 000 4 000
12.	Gjysmë rimorkio: <=7000 kg dhe > 7000 kg	4 000
13.	Makina bujqësore: <= 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 000 3 000 3 600 3 600
14.	Makina teknologjike: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga > 7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
15.	Mjete rrugore të veçanta: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga > 7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000

ANEKS 5

TABELA E TAKSIMIT TË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT TE VOGEL

		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSES						
Nr.	Xhiro/Aktivitet	Deri 2000	2.000 - 3.000	+ 3.000 - 4.000	+ 4.000 - 5.000	+ 5.000 - 6.000	+ 6.000 - 7.000	+7.000 - 8.000
a)	Shitje me pakicë	45	68	83	98	113	128	143
b)	Shitje me shumicë	45	68	83	98	113	128	143
c)	Prodhim	33	55	70	85	100	115	130
d)	Shërbime	25	48	63	78	93	108	123
e)	Profesione të lira	38	60	75	90	105	120	135
f)	Ambulant	8						
KATEGORIA II								
		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSES						
Nr.	Xhiro/Aktivitet	Deri 2000	2.000 - 3.000	+ 3.000 - 4.000	+ 4.000 - 5.000	+ 5.000 - 6.000	+ 6.000 - 7.000	+7.000 - 8.000
a)	Shitje me pakicë	25	48	63	78	93	108	123
b)	Shitje me shumicë	25	48	63	78	93	108	123
c)	Prodhim	23	45	60	75	90	105	120
d)	Shërbime	20	43	58	73	88	103	118
e)	Profesione të lira	30	53	68	83	98	11	128
f)	Ambulant	5						
KATEGORIA III								
		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSES						
Nr.	Xhiro/Aktivitet	Deri 2000	2.000 - 3.000	+ 3.000 - 4.000	+ 4.000 - 5.000	+ 5.000 - 6.000	+ 6.000 - 7.000	+7.000 - 8.000
a)	Shitje me pakicë	23	45	60	75	90	105	120
b)	Shitje me shumicë	23	45	60	75	90	105	120
c)	Prodhim	20	43	48	73	88	103	118
d)	Shërbime	20	43	58	73	88	103	118
e)	Profesione të lira	22	45	60	75	90	105	120
f)	Ambulant	5						
KATEGORIA I, II, III								
		NIVELI TREGUES I TAKSES						
Nr.	Xhiro/Aktivitet							
g)	Transport							
l)	Transport pasagjerësh							

	Automjet deri 5 vende	17.5	-	-	-	-	-	-
	Automjet 6 - 9 vende	35	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10 – 25 vende	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet 26 – 42 vende	45	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 42 vende	48	-	-	-	-	-	-
2)	Transport Mallrash							
	Automjet deri 2 tonë	28	-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 2 – 5 tonë	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 5 – 10 tonë	48	-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 10 – 16 tonë	50	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 16 tonë	75	-	-	-	-	-	-
3)	Transport Ujor							
	Transport detar brenda vendit	55	-	-	-	-	-	-
	Transport në liqene brenda vendit	48	-	-	-	-	-	-
	Varka për shëtitje	15	-	-	-	-	-	-

Klasifikimi:

Në kategorinë I: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Durrësit.

Në kategorinë II: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnje, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë.

Në kategorinë III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në komuna niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit tregues të tij për çdo kategori të rrethit në të cilin ndodhet komuna.

Shënim: Ambulantë konsiderohen vetëm bizneset pa vend fiks që kanë qarkullim jo më të madh se 2 milionë lekë në vit. Nëse vlerësohet se qarkullimi është më i madh ato klasifikohen në një nga kategoritë e tjera të biznesit dhe taksohen sipas asaj kategorie.

ANEKSI 6

NIVELI TREGUES I TAKSES SE ZENIES SE HAPESIRES PUBLIKE

Bashkitë		
Zona 1	Zona 2	Zona 3
Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m ² në muaj		
120	90	60

Shënim: Për komunat, niveli tregues i taksës për çdo zonë të treguar në tabelë është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.